

UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

T E M A

Politikbërja në një shtet multietnik

Rast studimor – Republika e Maqedonisë së veriut

(Periudha 2007 - 2017)

Dorëzuar Universitetit të Europës Juglindore, Shkollës Doktorale

**Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin e Shkencave
Shoqërore Bashkëkohore, për marrjen e gradës shkencore “Doktor Shkence”**

Përgatitur nga BESA KADRIU

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Memet Memeti

Numri i fjalëve: 63. 859

Tetovë,

Qershor , 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË.

Në përgjegjësinë time deklaroj se:

Ky punim është shkruar nga unë - Besa Kadriu dhe se i njëjti, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban qëndrime apo materiale të shkruar nga ndonjë person tjetër. Deklaroj se, studimi është punimi im origjinal. Burimet dhe literatura e shfrytëzuar janë cituar sipas standardeve të kërkuara.

Besa Kadriu

©2019 Të gjitha të drejtat i rezervohen autores

Besa KADRIU

ABSTRAKTI

Punimi shkencor me temë *“Politikbërja në një shtet multietnik, praktika e Maqedonisë së Veriut”*, ka për qëllim që të paraqes disa trajta dhe praktika të një shteti, i cili përveç faktit që akoma është në fazën e shfrytëzimit të kapaciteteve të brendshme për ndërtimin e institucioneve demokratike, njëkohësisht po përballlet me sfidat e kohës të cilat kërkojnë paraqitjen e tij në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, si një shtet me karakter multietnik, drejt një pozicioni të qartë, të orientuar drejt integritetit evropian dhe euroatlantik.

Ndërtimi i raporteve të tjera eurointegruese, janë një sfidë tjetër e kohës, mbështetur në pranimin dhe zbatimin e standardeve europiane të shtetit të qytetarit, elementët e të cilit janë bërë objekt i këtij studimi shkencor.

Komponentët përbërës të sistemit politik në rrugën e konsolidimit të shtetit dhe të shoqërisë demokratike, realizimi i aspiratave të popullsive etnike përbërëse të saj, krijimi i një klime të shëndoshë të gjenerimit të sigurisë së brendshme dhe në rajon, janë një qasje e re e thelbit të studimit, duke synuar përfundime dhe rekomandime të arsyetuara, të argumentuara për një praktikë institucionale politike të suksesshme në të ardhmen e RMV. Si pjesë e procesit të shpërbërjes së ish Jugosllavisë, në raport me republikat e tjera të Koroacisë, Sllovenisë apo dhe shteteve të tjera, RMV ka ecur shumë ngadalë në procesin e reformave dhe ndryshimeve të thella social politike dhe ekonomike, si një vend i dalë nga ish sistemi komunist, duke dhënë një shembull të diskutur krah vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë orientim politik të ngadalshëm, janë të shumtë faktorët etno-politik dhe rrethanat gjeopolitike, të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e plotësimit të standardeve të orientimit euroatlantik dhe në moszhvillimin harmonik të jetës së brendshme social politike të RMV. Mbi këtë situatë të brendshme dhe pozicionit gjeopolitik të RMV, materiali studimor ka si synim të hulumtojë kushtet dhe rrethanat, të gjithë faktorët veprues në politikbërjen e institucioneve qendrore të shtetit, pas përfundimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001 dhe futjes në veprim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Periudha e dekadës së fundit të zhvillimeve politike në RMV, është një hapësirë kohore e mjaftueshme për të analizuar sfidat, arritjet, luhatjet, dështimet në politikbërje, si një qasje e rëndësishme me karakter politik dhe me përfundime interesante për natyrën e një shteti multietnik.

ABSTRACT

The scientific paper on "*Policymaking in a multiethnic state, the practice of Northern Macedonia*", aims to present some forms and practices of a state, which besides the fact that it is still in the phase of utilizing internal capacities for building democratic institutions, at the same time, are facing the challenges of the time, which require its appearance on the domestic and international level as a multiethnic state, towards a clear position, oriented towards European and Euro-Atlantic integration.

The construction of other European integration reports is another challenge of the time, based on the acceptance and application of European standards of the citizen state, the elements of which have become the subject of this scientific study. The constituent components of the political system in the path of consolidating the state and democratic society, the realization of the aspirations of its constituent ethnic populations, the creation of a healthy climate for generating internal and regional security, are a new approach to the essence of study, aiming at reasoned conclusions and recommendations, arguing for a successful institutional political practice in the future of Northern Macedonia.

As part of the process of disintegration of the former Yugoslavia, in relation to other republics of Croatia, Slovenia or other states, Northern Macedonia has moved very slowly in the process of profound social, political and economic reforms and changes, as a country emerged from the former communist system, giving an example discussed elsewhere in the Western Balkans. In this slow political orientation, there are numerous ethno-political factors and geopolitical circumstances that have contributed to delaying the fulfillment of Euro-Atlantic orientation standards and the harmonious underdevelopment of the internal social and political life of North Macedonia. On this internal situation and the geopolitical position of North Macedonia, the study paper aims to explore the conditions and circumstances, all factors contributing to the policy-making of central state institutions, following the end of the 2001 armed conflict and the entry into force of the The Ohrid Agreement. The period of the last decade of political developments in Northern Macedonia is enough time to analyze the challenges, achievements, fluctuations, failures in policymaking, as an important approach of political character and with interesting conclusions about the nature of a multiethnic state.

DEDIKIMI

Këtë studim ia kushtoj përpjekjeve dhe sakrificës njerëzore të brezave të shqiptarëve nën diktaturë, të cilët në kohë të vështira me përpjekjet e tyre, i dhanë mundësi dhe shpresë popullit shqiptar në këtë hapësirë që të mbijetojnë, në kushtet e coptimit të trojeve shqiptare, duke ruajtur me heroizëm gjuhën, traditat, kulturën, simbolet, besimin, për të mbërritur në një kohë tjetër, ku nëpërmjet proceseve të integritit dhe të rrugës paqësore, të bëhen faktor kyç në ardhmërinë e sigurtë të shtetit të RMV.

Njëkohësisht me shumë përkushtim, ia dedikoj familjes time, dy prindërve të mi, dy vëllezërve, mbesës time Anesës dhe dy nipërve, Anuarit dhe Donartit!

FALËNDERIME

Paraqitja e tezës në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave”,

“Politikbërja në një shtet multietnik, praktika e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, referuar dekadës së fundit 2007-2017, u bë e mundur përveç punës time sistematike, njëkohësisht falë mbështetjes së profesorëve bashkëpunues të Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë.

Shpreh falënderim të veçantë për pedagogët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Ky punim pasqyron gjithashtu ndihmën dhe mbështetjen e gjithanshme e të pakursyer të udhëheqësit shkencor, Prof. Dr. Memet Memeti, të cilin e falënderoj.

Falënderoj për kontributin e tyre autoritetet udhëheqëse të pushtetit lokal dhe qendror në RMV, me të cilët kam kontaktuar dhe bashkëpunuar për të marrë opinione mbi politikbërjen në interesin shtetëror dhe publik.

Falënderoj ish ministren për Dialog në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Zonjën Edita Tahiri, autoritetet qeverisëse në Kosovë, për mbështetjen në realizimin e intervistave mbi temën studimore.

Falënderim për kolegët e mi, dekanatin e fakultetit të Shkencave Shoqërore Bashkëkohore, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, të cilët siguruan mbështetje dhe një ndihmë të pakursyer në procesin e përgatitjes së studimit.

Falenderoj familjen time, prindërit, vëllezërit, të cilët mundësuan mbështetjen dhe kushte të favorëshme për të realizuar me sukses temën studimore.

Mbi këto falënderime dhe mirënjohje, kam kuptuar thelbin e ekzistencës humane, e cila sot kërkon debatin etno – politik, kulturor, të mbështetur në vlerat historike, të orientuar me përgjegjësi në realitetin që jetojmë dhe perspektivat e tij.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	i
ABSTRACT	ii
DEDIKIM	iii
FALËNDERIM	iv
PËRMBAJTJA	f. 7
LISTA E SHKURTIMEVE	f. 10
LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKEVE	f. 11
KAPITULLI I I	f. 13
Hyrje. Një qasje gjeopolitike mbi Ballkanin Perëndimor.....	f. 13
I.1. Fusha e kërkimit shkencor dhe problematikat që identifikohen në punimin shkencor...f.	21
I.2. Qëllimi i punimit.....	f. 31
I.3. Objektivat e punimit.....	f. 31
I.4. Pyetjet kërkimore.....	f. 32
I.5. Hipotezat.....	f. 32
I.6. Metodologjia.....	f. 33
I.6.1. Zgjedhja e metodave të përdorura në funksion të temës studimore.....	f. 33
I.6.2. Metodatat kryesore të përdorura në studim.....	f. 35
I.6.3. Kërkimi nëpërmjet testimit.....	f. 35

I.6.4. Analiza e të dhënave ekzistuese.....	f. 36
I.6.5. Puna në fushë.....	f. 37
I.7. Kontributi i punimit kërkimor.....	f. 37
I.8. Kufizimet e punimit kërkimor.....	f. 38
I.8.1. Saktësia e përgjigjeve të intervistave.....	f. 38
I.8.2. Kufizimet për të përdorur gjerësisht punën në fushë.....	f. 38
I.8.3. Vështirësitë e analizës së të dhënave ekzistuese.....	f. 38
I.8.4. Vështirësitë e natyrëshme studimore në një shoqëri multietnike.....	f. 39
I.8.5. Kriza politike.....	f. 39
I.8.6. Ndryshimet e vazhdueshme në reformat ligjore.....	f. 40
I.8.7. Mungesa e të dhënave statistikore nga autoritetet zyrtare të vendit.....	f. 41
KAPITULLI II: Rishikimi i literaturës.....	f. 42
II.1. Teoritë themelore politike në shoqëritë multietnike.....	f. 42
II.2. Nacionalizmi në shoqëritë multietnike.....	f. 43
II.3. Multikulturalizmi.....	f. 52
II.4. Teoria e liberalizmit.....	f. 56
II.5. Egalitarizmi.....	f. 61
KAPITULLI III.....	f. 65
III.1. Konceptet themelore politike, llojet dhe karakteristikat e politikbërjes.....	f. 65
III.2. Aktorët e politikbërjes.....	f. 70
III.3. Fazat e politikbërjes.....	f. 72

KAPITULLI IV: Roli i qytetarit në politikbërje.....	f. 75
IV.1. Roli i qytetarit si element kyç në një proces politik demokratik.....	f. 75
IV.2. Informimi.....	f. 82
IV.3. Konsultimi.....	f. 83
IV.4. Përfshirja e aktorëve të rëndësishëm në procesin e një politike publike.....	f. 84
KAPITULLI V.....	f. 86
V.1. Përfaqësimi etnik dhe pozita e shqiptarëve në RMV.....	f. 86
V.2. Politika regresive në një shoqëri diverse dhe shumëkulturore, pozita e shqiptarëve në RMV.....	f. 95
V.3. Decentralizmi fiskal, praktikat e RMV me element të diskriminimit etnik, rajonet e banuara me shumicë shqiptare.....	f. 111
V.4. Vendet e rajonit – Kosova, përmbushja legjislative e të drejtave të përkatësive joshumicë si detyrim kushtetues, mesazh për RMV.....	f. 117
V.4.1. Gjeneza e diskriminimit etnik në përfaqësimin institucional.....	f. 120
KAPITULLI VI: Shoqëritë multietnike, praktika nga vendet e zhvilluara.....	f. 129
VI.1. RMV përballë praktikave të shoqërive multietnike, sfidat dhe aplikimi i formave bashkëkohore.....	f. 132
VI.2. Analiza descriptive e të dhënave.....	f. 137
VI.3. Popullata dhe kampioni.....	f. 140
VI.4. Intervista.....	f. 145
VI.5. Pyetsori.....	f. 146

KAPITULLI VII.....	f. 167
VII.1. Përfundime.....	f. 167
VII.2. Rekomandime.....	f. 171
BIBLIOGRAFIA DHE WEBLIOGRAFIA.....	f. 174

LISTA E SHKURTESAVE

RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut;
BE	Bashkimi Evropian;
BP	Ballkani Perëndimor;
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim;
MO	Marrëveshja e Ohrit;
NATO	Aleanca Veriatlantike;
RSFJ	Ish-Republika Federative e Jugosllavisë;
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;
QKSM	Qendra Kombëtare për Siguri dhe Mbrojtje;
LDB	Lufta e Dytë Botërore

LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE GRAFIKËVE:

TABELAT

- Tabela nr. 1. Përkatësia etnike e të punësuarve në institucionet shtetërore.
- Tabela nr. 2: Të dhënat e përfaqësimit etnik në institucionet qendrore të RMV.
- Tabela nr. 3: Përfaqësimi etnik në institucionet e nivelit të dytë.
- Tabela nr. 4: Të dhënat e përfaqësimit etnik në sistemin mediatik dhe telekomunikacion.
- Tabela nr. 5: Përfaqësimi etnik në Sekretariatit e Përgjithshëm të qeverisë së RMV.
- Tabela nr. 6: Përfaqësimi etnik në strukturat dytësore të qeverisë së RMV.
- Tabela nr. 7: Përfaqësimi etnik në strukturat ministrore të qeverisë së RMV.
- Tabela nr. 8: Njësitë e pushtetit lokal dhe popullsia në vendet e Ballkanit Perëndimor
- Tabela nr. 9: Vlera e pritshme e lejeve të ndërtimit të lëshuara sipas rajoneve (2010-2015-milion denarë)
- Tabela nr. 10: Të dhënat diskriminuese në financimin e komunave shqiptare.
- Tabela nr. 11: Pasqyra e regjistrimit të popullsisë në MV, 1953-2002.
- Tabela nr. 12: Të dhënat përmbledhëse mbi orientimin strategjik në politikbërje të RMV.

FIGURAT

- Figura nr. 1: Të dhënat moshore të të intervistuarve.
- Figura nr. 2: Të dhënat moshore të të intervistuarve.
- Figura nr. 3: Niveli arsimor i të intervistuarve.
- Figura nr. 4: Përkatësia etnike e të intervistuarve.

- Figura nr. 5: Punësimi i të intervistuarve në organet vendimarrëse të politikës.
- Figura nr. 6: Të dhënat e diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike.
- Figura nr. 7: Të dhënat mbi respektimin e konventave dhe ligjeve ndërkombëtare.
- Figura nr. 8: Të dhënat mbi diversitetin politik si pjesë e kulturës shoqërore.
- Figura nr. 9: Të dhënat mbi mbrojtjen e vlerave të shtetit multietnik në RMV.
- Figura nr. 10: Të dhënat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike të ndryshimit.
- Figura nr. 11: Të dhënat mbi prioritetin strategjik të orientimit të RMV në të ardhmen.
- Figura nr. 12: Të dhënat mbi raportet e shqetit ligjor dhe Prokurorisë Speciale.
- Figura nr. 13: Të dhënat e veprimit të politikave ditore në jetën politiko - sociale në RMV.
- Figura nr. 14: Të dhënat mbi orientimin strategjik të politikbërjes në RMV (NATO-BE)

GRAFIKËT

- Grafiku nr. 1: Të ardhurat e buxhetit bazë dhe transfertave të donacioneve në të ardhurat totale (2014).
- Grafiku nr. 2: Të dhënat statistikore të fëmijëve të lindur sipas përkatësisë etnike.
- Grafiku nr. 3: Të dhënat statistikore të fëmijëve të lindur sipas religjioneve 2017.
- Grafiku nr. 4: Shkalla e raporteve sociale në shoqëri multietnike në RMV.
- Grafiku nr. 5: Niveli i besimit në organet politike vendimarrëse në RMV.
- Grafiku nr. 6: Raportet e përfaqësimit etnik në trupën vendimarrëse të shtetit të MV.
- Grafiku nr. 7: Niveli i optimizimit për suksesin e reformave demokratike në RMV.

KAPITULLI I

*“Ajo që ne nuk duhet të bëjmë, është të mos lejojmë ndjekjen
e një qëndrimi korrekt, sikur synimet janë qartësisht të arritëshme”*

Montgomery

Hyrje

Një qasje gjeopolitike mbi Ballkanin Perëndimor. Historia e Ballkanit ka shqetësuar dhe vazhdon të shqetësojë sot politikën ndërkombëtare. Kjo hapësirë është bërë pikënisje e dy luftimeve botërore. Ballkani është hapësira gjeohistorike e miteve pa mite (*Edhe ku nuk ka pasur, ato janë sajuar*). Psikologjia ballkanase e ka të nevojshme të ç’mësohet nga pjesa mistike e historisë së tij, të cilën kombet dhe popujt në gadishull e kanë përdorur në mënyrë të padrejtë kundër njeri - tjetrit. Ky motiv u ka imponuar atyre të konsumojnë shumë energji mbi kapjen fort pas prurjeve historike, duke shtuar ngarkesa negative në dëm të marrëdhënieve ndërshtetërore, paqes dhe sigurisë rajonale.

Burimi kryesor i krizës ballkanike mbetet nacionalizmi agresiv, i cili ka çuar kombet në rajon drejt agresivitetit të ndërsjelltë, në rrudhosje, kriza e konflikte të përgjakëshme në kufijtë e gjenocideve. Historia është ajo që ka ndodhur, ndërsa politika përfaqëson sot atë që është e dobishme apo e dëmshme në marrëdhëniet ndërshtetërore brenda rajonit. Përplasjet historike kanë krijuar boshllëk kombëtar. Ai sot tenton të mbushet me paradokse të politikës. (*konfliktet politike midis shteteve fqinje në Ballkan për shkak të prurjeve historike janë të dukëshme*) .

Historia kolektive e Ballkanit është e shumfaktorshme. Ajo është e lidhur me kufijtë e largët të kontakteve dhe marrëdhënieve të hershme, në perëndim me Perandorinë Romake, në lindje me Perandorinë Osmane, dhe më tej në kufijtë e kontaktit me popujt sllav, të cilët sot janë bërë pjesë e tij. Ballkani në fizionominë gjithpërfshirëse në opinionin ndërkombëtar, nuk duhet të identifikohet vetëm me kufijtë gjeografikë të tij. Ai sot luhetet midis këtij koncepti dhe kufijve të historisë kolektive. Kjo ka vështirësuar bashkëjetesën dhe favorizon ndërhyrjet brenda tij. Një histori e trazuar mbi të cilën kanë ushtruar ndikimin e tyre Fuqitë e Mëdha të kohës.

Ekulibri i vlerave të marrëdhënieve mes popujve është goditur shumë herët nëpërmjet diktatit, pushtimeve, moskokëçarjes politike dhe indiferencës së kohës. Një përgjegjësi e drejtëpërdrejtë

politike në rrjedhat historike, e fuqive që do të duhet ta zgjidhin sot këtë “*nyje gordiane*” në mes të qytetërimit perëndimor. Zhvillimet e pasluftës së Dytë Botërore dhe shpërbërja e ish bllokut komunist, kanë sjell zhvillime politike interesante. Sot Ballkani është rajoni që ka vënë në provë karrierën politike të demokracisë perëndimore.

Të sunduar nga vetëdija dhe kultura profesionale, pas rënies së komunizmit në Evropën Juglindore, sot politologët dhe analistë të talentuar bëjnë publike skemën e inteligjencies për eksperimentimin kompleks të zonës ballkanike dhe ish bllokut komunist, duke e rivlerësuar e bazuar platformën ideo – politike të përplasjes së dy sistemeve mbi të drejtën krahasuese dhe ndikimin real të kohës. Në historinë ballkanike janë përfshirë figurat më të mëdha të kohës. Me ose pa dashje, analiza e mbështetur në kategorinë filozofike shkak – pasojë, nuk mund të shmang trajtesat mbi mbetjet historike, në thelb me frymë të theksuar nacionaliste.

Një arsye më shumë për të pranuar se, proceset politike në vendet e ish komuniste, veçmas dhe në kompleks, ende nuk i janë nënshtruar analizave serioze me vlerësime të plota mbi reflektimin politik – historik të kohës, për atë se: ***çfarë provuan, çfarë dëshmuar dhe çfarë kanë lënë të dobishme e të dëmshme për kohën që jetojmë.*** Shqetësimi për organizimin apo riorganizimin politik të rajonit problematik, është i dukshëm. Ky konstatim përbën thelbin e studimit, me idenë e përcaktimit dhe pranimin të disa varjanteve optimal, që mund të çojnë në zgjidhje të qëndrueshme dhe të pranueshme nga të gjitha palët në interes të sigurisë rajonale.

Muri i Berlinit fshiu vijën ndarëse lindje – perëndim, por ai krijoi një ndarje të re, atë Evropë – Ballkan. Një situatë që do të kërkonte kohë për të kapëcyer fazat delikate të periudhës kalimtare. Shkak u bë mospranimi i realitetit që mbizotëronte në rajon: ***një hapësirë me kompleksitet historik të njohur, me dhunë sistematike dhe paqëndrueshmëri (luftat e Serbisë në Ballkan), me diversitet kulturor midis kombeve dhe nivele të ulta zhvillimi, në krahasim me vendet e zhvilluara të Evropës.***

Evropa sot bën përpjekje të kryejë veprimtari politike rajonale në interes të së ardhmes. Qëndrimi ndaj Ballkanit është i diskutueshëm në sfondin e integritit me nuanca nacionale. Pavarësisht hapave që janë bërë, duke zgjeruar hapësirat e anëtarësisë në “*shengen*”, kriza politike rajonale është e pranishme. Preferencat politike që shfaqen nga përfaqësuesit tipikë të frymës konservatore të së shkuarës, mbeten shkaqet kryesore që e bëjnë politikën evropiane të matur dhe të kujdesëshme, për të mos pranuar pasojat brenda saj mbi çështjen ballkanike.

Shkaqet mund të jenë të shumta me pretendimin kryesor; “*mosplotësimi i standarteve dhe korrupsioni i skajshëm ballkanik*”, por baza mbështetëse mbetet religjioni kristian. “*Shengeni*” e ka ndarë Ballkanin në dy pjesë. “*Shengeni*” ballkanik nuk ka të bëjë me konceptin e “*lëvizjes së lirë*” të qytetarëve të tij. Ai duhet parë shumë më tej. Shengeni duhet të zërë vend në konceptin politiko - filozofik të forcave të interesuara në zgjidhjen e çështjes “*Ballkan*”.

Bashkimi European mban peshën e përgjegjësisë kryesore të ndryshimit. Mbi konceptimin dhe pranimin e ndryshimeve që kënaqin të gjitha palët, mbështetur në integrimin e interesave ekonomike rajonale, mund të ndodh procesi i pritshëm, por asnjëherë pa mbështetjen dhe ndërhyrjen e politikës amerikane. Është kjo arsyeja që sot ndeshemi edhe me opsione të tilla, të cilat e shikojnë të ardhmen me skepticizëm. “*Kështu Europa e sheh veten të varur midis një të kaluar që ajo kërkon ta kapërcejë dhe një të ardhmeje që ajo nuk e ka përcaktuar ende*”. (Kissinger, Henry, 2015:96). Ndoshta një arsye më shumë për ta kuptuar frenimin evropian për të justifikuar nuancat krejt të ndryshme të jetës politike ballkanike, ku në tre dekada ende shfaqet pa elementët e nevojshëm demokratizues. Por, kanë kaluar 30 vjet! Fobia dhe ngurrimi politik i kontinentit po funksionon në kohë.

Elementët thelbësor të demokracisë në Ballkan ishin në hapat e para, (*jeta parlamentare, liritë dhe të drejtat e individit, pakicat, ekonomia e tregut, shoqëria moderne, mbikqyrja dhe kontrolli i strukturave policore-ushtarake, liria e shtypit, sistemi zgjedhor, mungesa e ndikimit të influencave nga jashtë, vendosja e njeriut në qendër të vëmendjes së shtetit etj*). Standardet e shtetit të qytetarit bën që, “*vija e ndarjes*” të funksiononte. Pas tre dekadash Ballkani përsëri mbetet problematik. Dy luftra e çuan rajonin në kufijtë e shpërthimit. Pritshmëria evropiane detyroi SHBA-të “*të vinin dorë*” në Ballkan, si në rastin e luftës në Bosnje Hercegovinë dhe në Kosovë. Eksperimenti politik ende kërkon kohë të japë rezultatet e pritëshme.

Në thelbin e realitetit ballkanik, ***Sistemet dhe Modeli*** po vazhdojnë të shfaqin brenda vetes kontradikta të diferencuara. Pas një periudhe me shkatërrim ekonomik, kolaps politik, ulje e ngritje tensionesh social - politike, luftra që shkaktuan tragjedi njerëzore, qeveritë e vendeve të Ballkanit në gati tre dekada përjetuan shkallë sigurie të pakët. Ato e kanë pasur monopol sigurinë publike dhe po tentojnë të hyjnë në strukturat euroatlantike, duke hequr dorë prej tij (*monopolit*).

Përballë mbijetesës së “*më të fortit*” dhe përgjegjësisë kolektive, *siguria e tregut të lirë* ka sygjeruar gjetjen e sigurisë tek NATO, mbështetur e bazuar mbi disa shtylla: ***siguria, shteti ligjor dhe demokracia parlamentare, trashëgimia e përbashkët kulturore evropiane*** (nga

Roma, Greqia deri tek Rilindja me vlerat dhe besimet), qytetërimi i përbashkët i shekullit. Përballë gjeopolitikës rajonale u vu teoria e integritetit e Bashkimit Evropian.

Politika (me anë të fazave të saj ciklike e rotative, propagandë dhe demagogji), po përforcon idenë e luksit të demokracisë, që shoqëritë në ndryshim nuk mund ta kenë atë lehtësisht. Në mungesën e *dypolarizimit* të politikës ballkanike, politika evropiane në Ballkan ka rënë në kurthin “*e kutisë*”, duke shtrënguar politikën në rajon me lojën e “*standardeve*”, **pa menduar ndonjëherë seriozisht se, ballkanansit ende nuk kanë arritur të mendojnë dhe arsyetojnë si evropianoperëndimorët. Multipartititeti i skajshëm ka ngushtuar hapësirat e tolerancës.** “Megjithatë, kur popujt pyeten për të bërë sakrificë në emër të “*projektit evropian*”, mund të mos ekzistojë një kuptim i qartë i detyrimeve që rrjedhin prej tij. Atëherë udhëheqësit përballen me vendimin e mospërfilljes së vullnetit të popullit të tyre apo të ndjekjes së tij në kundërshtim me Brukselin”. (Kissinger, Henry, 2015:93). Kjo rrugë e bën të pamundur mbajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm, deri sa të arrihet që vendet e rajonit të respektojnë raportet qeverisje – qytetar dhe të plotësojnë standardet e demokracisë. Ngjarjet tragjike pas viteve 90-të dhe përsëritja e tyre, treguan se qëndrimet politike nuk ishin rezultative.

Pa marrë parasysh plagët e rënda dhe pasojat historike, politika ndërkombëtare në Ballkan synoi të respektoje apo të krijonte shoqëri multietnike, bashkëjetesën, pa vlerësuar më parë dhunën me të cilën janë vendosur kufijtë politikë në rajon. Për këtë shkak, popujve dhe kombeve u është dashur (më saktë rekomanduar) të jetojnë “*në harmoni*” me njëri - tjetrin në një kohë të shkurtër, pa marrë parasysh kohën e gjatë deri në këtë pikëmbërritje. Modeli i shoqërisë “*multietnike*” më parë në Bosnje Hercegovinë dhe në Kosovë (me 94% popullsi shqiptare), parimisht nuk mund të vlerësohej funksional. Në kushtet konkrete toleranca e shqiptarëve në Kosovë është për t’u marrë shembull, por e pamotivuar dhe e pambështetur nga shumica shqiptare.

Në Ballkan mbizotëron psikologjia tipike ballkanike me tipre karakteristike jo të rastësishme. Janë injoruar ndjesitë nacionale, pasojat e dhunës shtetërore dhe politike, kërkesat e popullsisë për shkak të situatës së rëndë ekonomike, duke përdorur formulat e njohura për anëtarësime në strukturat kolektive, pa ndërhyrje efektive. Kjo situatë nuk i ka shërbyer sigurisë në rajon. Krizat mbeten të pranishme brenda tij. Kështu, është pranuar opsioni se, **vlerat e demokracisë varen nga siguria.** Rrugët e ndjekura për forcimin e konceptit *siguri* në rajon, shfaqen me probleme.

Zgjatja në kohë e pranimi ose mospranimi, standardet e dyfishta, diferencimet e pamotivuara, loja servile e pushteteve, presionet pa sanksione, kanë mbjell pakënaqësi. Reagimet e shteteve në segmente të caktuara, tentojnë të bëhen faktor politik në rajon. P.sh. Tolerohen shkeljet flagrante

mbi Kushtetutën në Republikën e Shqipërisë (*vend anëtar i NATO-s*), apo dhe në RMV dhe “komisionerët”, për hir të karrierës politike apo miqësive personale shpesh injorojnë të drejtat qytetare për të qenë në rregull me strategjitë e Brukselit. Faji mbetet në Ballkan. Sipas këtij arsytimi, bërthama ballkanike është orientuar me vështirësi për të ringritur në përmasat rajonale ***fortesën kolektive të bashkëjetesës dhe integritit, e cila anashkalon problemet etnike dhe pasojat që mbart brenda rajoni (!)***.

Në planin shtetëror politika në Ballkan e ka kuptuar që, për të zgjatur mandatet e saj, ajo nuk mund të jetë konsumatore e sigurisë, por gjeneruese e saj. (*mobiliteti i eksperiencave të përbashkëta me përvojat individuale*). Pakti i Stabilitetit (*rajonizimi*) dhe *Marrveshja e Stabilizim – Asocimit (kushtëzimi)*, po shfrytëzohen për avantazhet konkurruese drejt integritit të shpejtë ekonomik, standardeve të të drejtave e lirive të individit, kundër terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, mafies, drejt natyrës së shtetit të qytetarit.

Realiteti i marrëdhënieve të brendshme dhe dypalëshe me dëshirën për t’u bërë pjesë e kësaj forte, kanë kontradiktën mes tyre. Kjo nënkupton se, pavarësisht shpenzimeve të mëdha dhe resurseve të angazhuara evropiane, kriza ballkanike do të konsiderohet e tillë edhe për shumë kohë. Ajo kërkon vëmendje dhe strategji të reja, jo më si deri tani. Çfarë ndodh realisht dhe pse Ballkani merr kaq përparësi në planet e fuqive më të mëdha të botës? Çfarë precedenti botëror gjeneroi “*rasti Kosovë, apo konflikti ushtarak në Maqedoninë e Veriut*”?

Duket disi e pakuptimtë, por këndvështrimi i rrezikut nga individë, institute apo instrumente të ndryshëm, të palegjitimuar si: *FBKSH (Fronti për Bashkimin Kombëtar Shqiptar) Armata Kombëtare Shqiptare, Fronti për Çlirimin e Serbisë, Organizata e Vorio Epirit, Fronti për Çlirimin e Maqedonisë, Organizata terroriste “17 Nëntori”, Organizata ushtarake MAVI etj*), është i diferencuar. Rreziku është ende i pranishëm. A besohet se rreziku kryesor sot për sot në Ballkan është lufta? Konstatimet tërheqin vëmendjen për shumë arsye të tjera. Ballkani ka nevojë ta shtrijë më tej konceptin siguri. Një përmbledhje e këtij koncepti të orienton tek koncepti, ***llojet e sigurisë, politika e sigurisë dhe instrumentet, rreziqet, aktorët e sigurisë, asnjënjësia dhe aleanca. Nuk është fundi i saj anëtarësimi i shteteve në NATO.***

Siguria në mbrojtjen e shtetit, territori, sovranitetit politik, shoqërisë, garancitë në sigurinë ushtarake, sigurinë publike, njerëzore, pra më shkurt, në sigurinë e jetës njerëzore, ende këto element luhaten në marrëdhënie të ndera ndërshtetërore, duke i dhënë oksigjen nacionalizmit tradicional. Vendet ballkanike janë përballur me sfida të brendshme dhe rajonale, të cilat kanë çuar në dy luftra në harkun kohor të një dekade. Në këtë trazim kolektiv nuk ka bërë përjashtim

as Greqia, një vend anëtar i NATO-s dhe i Bashkimit Evropian. Situatat e pasluftës kanë sjell zhvillime, ashtu sikundër dhe pasoja. Aq sa është goditur fryma e nacionalizmit tradicionalist, po aq janë shtuar meritë etnike për shkak të ndryshimeve gjeopolitike në rajon. Sfida ende është e pranishme.

Ballkani po përballët me rreziqe politike, të cilat konsistojnë në *paqëndrueshmërinë e rendit publik, në praninë e strukturave dhe akteve terroriste, në shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut*. E pranishme është tendenca e depërtimit të strukturave terroriste me bazë religjioze. *Me pasojat ekonomike, varfëria është e pranishme*, diferencimet pasurore për shkak të grabitjes së pasurisë kombëtare dhe mosrespektimit të të drejtës së pronës, krijimit të shpejtë të monopoleve me bazë të dyshimtë, veprimit të konkurrencës së pandershme, evazioni fiskal, piraterisë etj.

Ballkani po përballët me *efektet e dhunimit të mjedisit nga njeriu*, ndotje kimike, baktetologjike, bërthamore, tjetërsimi i tokës, ujit, prerja e pyjeve, mungesa e ushqimeve. Ai po përballët *me rreziqe sociale*; konfliktet e raporteve demografike, konfliktet e interesave, mbipopullimi, krimi i organizuar, kontrabanda e drogës, trafiku i qënjeve njerëzore, eimigrimi masiv, sëmundjet ngjitëse virale etj.

Koncepti i sigurisë ecën paralel me politikat dhe vlerën e instrumenteve (*doktrina ushtarake, planet e mbrojtjes, buxheti*), me aktorët e saj (*forca e armatosur, financa, policia, shërbimi i fshehtë*) me ekspertizën civile (*shoqëria civile, OJF, institutet kërkimore - shkencore, media*), me institucionet e tjera të cilësuar, (*shërbimi doganor, shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, policia kufitare, ndjeshmëria e publikut dhe transparencja*). Një mori instrumentesh të provuara në rolin që luajnë në interes të sigurisë.

Çështjet e sigurisë rrisin vëmëndjen dhe ndjeshmërinë politike për gjetjen e modelit për garancinë drejt paqes dhe stabilitetit. Pjesë e këtij stabiliteti duhet të bëhen të gjithë aktorët ballkanikë. Kështu dëshmohet vëmëndja më e plotë ndaj strukturave rajonale të *krimit të organizuar, korrupsionit, mafies, krimit konvencional dhe detyrimi për të analizuar më shumë sesa kaq. Kështu, mendimi logjik fillon i paraprin ngjarjeve dhe fenomeneve*. Një konstatim i thjeshtë, por që ka në mes një mori problemesh, të cilat nëse lihen në dorën e ballkanasve, do të jenë në kufijtë e pamundësisë për të gjetur zgjidhje.

Ata që e kanë shkaktuar krizën shekullore ballkanike, janë ata që duhet ta zgjidhin atë. Rajoni nuk mund të reformohet duke u mbështetur në psikologjinë vrasëse, “*vdekja e njerit është ekzistencë për tjetrin*”. Këtë situatë Bashkimi Evropian e përtyp me vështirësi. Dilema: *të*

mbahet Ballkani në periferi, apo të synohet drejt reformave të thella politiko–sociale dhe ekonomike për ta përfshirë në bashkësi! Me sa duket ka ardhur koha që në rajon të zbatohet një filozofi e re evropiane, e cila të synojë në integrimin e kulturave të kombeve dhe popujve, larg paragjykimëve të deritanishme, në mënyrë që fryma progresiste të triumfojë.

Situata në Ballkan duhet të vihet para alternativës së planifikimit strategjik dhe parashikimit: Ajo që është zhvilluar dhe përsosur është koha. Jetojnë bashkë ndryshimi, eksperimentimi politik dhe konflikti. Të kuptojmë të parat dhe të parandalojmë të dytin. Cilat janë strategjitë, rrugët dhe kush do ta bëjë këtë? Kjo nuk është detyrë e instituteve që herë pas here publikojnë studime mbi çështjet ballkanike. Ky është detyrim institucional i BE-së, që duhet të zgjidhë problemet brenda tij. Brukseli mund dhe duhet të ndryshojë qëndrim. *“Politika e jashtme ka rrezik të kthehet në një nënndarje e politikës së brendshme, në vend të një detyre për formimin e të ardhmes”*. (Kissinger, Henry, 2015:369).

Problemi i rajonit të Ballkanit është mënyra se si rajoni të jetë i qetë. Cila formulë zgjidhjeje vendos sigurinë dhe paqen e qëndrueshme, për një rajon të qetë ku dominojnë nacionalizmat. A mund të arrihet kjo pa praninë e faktorit evropian dhe në veçanti atij amerikan? Në çështjet e konflikteve, përherë më të fituarit kanë dalë Serbia dhe Greqia. Ende dhe sot politika evropiane në dëshirën për zgjidhjen e konflikteve, sytë i hedh nga më të fortët e Ballkanit. Nuk mund të ecet më në këtë rrugë. Luftrat pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, nxorën kontradiktat brenda rajonit dhe midis shteteve, duke e kaluar përgjegjësinë në metropolet perëndimore.

Përvoja historike në rajon ka sjell në fakt një qëndrim politik tipik ballkanik, krejt ndryshe nga ai mentalitet që mbizotëron në një shoqëri të avancuar që i ka kapërcyer me kohë problemet që Ballkani i përjeton sot. Rasti i Kosovës dhe goditja dhe gjunjëzimi i Serbisë, janë një rast unikal ku SHBA-të në emër të paqes, lirisë, kundër luftës, gjenocidit, terrorizmit shtetëror, angazhohen në një koalicion të gjerë me mandat ndërkombëtar dhe vendosin drejtësinë në rajonin më të dhunuar të botës.

Duke përvehtësuar anën pozitive të këtij qëndrimi, opinionin shoqëror në Ballkan është bërë i vetëdijshëm mbi vlerat që ofron sistemi demokratik. Koha ka vërtetuar se ky opinion i ka parë me skepticizëm zgjidhjet nga lartë dhe nuk ka se si të pranojë në këmbim të ndërhyrjeve dhe mbështetjes në shmangien e tragjedi, detyrimin dhe shtrëngesat që imponojnë pritje në pafundësi. Në tre dekada koha ka qenë e mjaftueshme për t'i parë problemet jo më çështje dëshirash, por ndjesi lëvizëse për shkak të pasojave të rënda të trazirave nacionaliste.

Në këtë situatë duhet të dominojë një opion tjetër, *ai i rivendosjes ndaj padrejtësive*. Nuk mund të ecet duke bashkëvepruar hapur apo fshehtas me më të fortët e rajonit, por duhet të pranohet opsioni, *është e drejtë, s'është e drejtë*, kundër padrejtësive historike dhe pasojave. Politika ndërkombëtare e ka të nevojëshme të zgjerojë mendimin rreth çështjeve që janë dhe ende mbeten brenda saj. Nëse pretendohet se kontrollohet gjithçka dhe askush nuk mund të dalë jashtë kontrollit, mund të vazhdohet edhe kështu, por nëse kjo nuk është e sigurtë, atëherë duhet ndryshuar qëndrim mbi bazën e rekurseve të reja politike.

Ndikimet e politikave dhe rekomandimeve jologjike të institucioneve shkencore ballkanike, të cilat frymëzohen nga nacionalizmi dhe më tej godasin nën diktatin e politikave shtetërore, e vështirësojnë procesin e integritetit të rajonit. Retorika dhe patetizmi mbi dëshirën për integritet, me dëshirën e “modernistëve” përballë primitivitetit psikologjik tradicional që pjell dhe ushqejnë politikën përçarëse, të përfaqësuara nga struktura të pandreqëshme që sot drejtojnë qeveritë rajonale, nuk mund t'i rezistojnë ndikimeve të forta të frymës së nacionalizmit në Ballkan. Patriotizmi është streha e fundit e tyre, për të manipuluar opinionin shoqëror dhe në një farë mënyre ja kanë arritur.

Konstatimi kërkon shpjegim dhe është bërë objekt specifik i këtij studimi. Koha sipas një “*vijë sjelljeje*” të rekomanduar nga SHBA-të dhe BE-ja për shtetet e Ballkanit, është e shkurtër. Ajo nuk mjafton për të parë rezultatet e ndryshimit të situatës gjeopolitike dhe psiko - sociale të popujve të rajonit, por ka qenë e mjaftueshme për të ndërtuar marrëdhënie të drejta me frymë demokratike me leadershipin politik të këtyre vendeve. Prej mendësive të vjetra, paralelisht në këtë kohë janë evidencuar provokime të rënda midis shteteve, që kanë çuar drejt krizave politike me pasojë në përkeqësimin e marrëdhënies ndërshtetërore.

Fatkeqësisht, në këtë skenar ballkanik janë përfshirë pa mëdyshje shtete anëtare të BE-së dhe të NATO-s, si në rastin e Greqisë. Koha ballkanike do të vazhdojë të shpenzohet pa kriter për shkak të nacionalizmit ballkanik (*deri nacionalizmit agresiv*) dhe paragjykitimit fetar. Nuk bën përjashtim politika greke nga ky konstatim. Mbi këtë opion, ato që duhet t'i nënshtrohen më tepër vëmendjes së politikës ndërkombëtare, janë aktorët kryesorë ballkanikë, specifikë për problemet e mbartura të karakterit etnik; Serbia, Greqia, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Kosova dhe Bosnje Hercegovina.

Problemi mund të shikohet thjeshtë duke respektuar dy mënyra, *ose të pranohet ky realitet gjeopolitik ose në kushte të tjera, palët të ulen dhe të rishikojnë pasojat që ka lënë historia në rajon*. Një ide e hedhur kohë më parë, por që sot mund të marrë ngjyrimet e një plani amerikano

– evropian (*me pëlqimin rus*), për t'i paraprirë ngjarjeve në interes të paqes dhe stabilitetit në rajon.

I.1. Fusha e kërkimit shkencor dhe problematikat që identifikon punimi

Në kapitullin e parë mbi natyrën e hulumtimeve të kësaj fushe, studiuesit e huaj një vend të rëndësishëm i kushtojnë rolit të qeverisë, si një pjesë e pushtetit, pa të cilën procesi i politikbërjes nuk mund të realizohet. Në këtë kontekst që në fillës të materialit, theksohet se përgjatë trajtimit të kësaj teze, do të shqyrtohet rasti i një vendi në zhvillim siç është RMV, pas vitit 2001. Është koha e daljes në skenë e aktit për ndryshime kushtetuese, e njohur si Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe një sërë detyrimesh ligjore dhe marrëveshje politike të tjera, të cilat do të lindin si nevojë e zhvillimit të proceseve politike në RMV.

Edhe pse në pikëpamje juridike dhe politike apo edhe ato të fushës së nxitjes së reformave të përgjithshme arrijtjet rezultojnë në ndryshime shumë të vogla, duhet pranuar fakti që këto ndryshime janë edhe më pak të evidentuara në krahasim me atë që duhej bërë. Sipas mënyrës së analizës politike dhe sociale, e gjykuar në një vështrim kritik, materiali studimor orientohet në një fazë pak më të vonshme të këtij procesi, duke iu përmbajtur periudhës së viteve 2007 – 2017. Në këtë periudhë analizohet me theks të veçantë pozita e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, trajtimi i rolit të tyre si faktor i rëndësishëm shtetformues me karakter politiko - social, ekonomik dhe juridik, të lidhur njëkohësisht edhe me faktorë të tjerë, të cilët kanë ndikim të fuqishëm në procesin e ndërlikuar të politikbërjes.

Në këtë vështrim, faktorët politikë, ekonomikë dhe social zënë vendin kyç në studim, duke u zgjeruar kështu në rrjedhën apo gjenezën e problemit, në karakterin multietnik të vendit, që shpesh herë ka qenë edhe faktori nxitës i problemeve ndëretnike me ndikime në sigurinë shtetërore, aq më tepër në pozitën e popullsisë shqiptare, e cila në rolin dhe ndikimin e saj në politikbërje me përfaqësuesit e saj në institucionet shtetërore e publike, si përfaqësues në koalicione në qeverisjen e vendit, nuk është përfaqësuar në nivelet e duhura të përgjegjësiive politike në interes të qytetarëve të saj. Roli minimal i përfaqësuesve të popullsisë shqiptare në politikbërjen e shtetit, rast pas rasti ka ndikuar në diktatin e palës tjetër për mosrespektimin e të drejtave njerzore në kufijtë e diskriminimit etnik.

Hulumtimet në çështjet e Administrimit Publik, do të nxjerrin në sipërfaqe edhe një paradigmë tjetër, atë të anës politike të administrimit publik, duke vënë në dukje ndikimin e skajshëm të administratës shtetërore në praktikën politike të institucioneve në Maqedoninë Veriore. Kjo

përvojë me dukuri negative, është kritikuar ashpër nga raportet periodike të aktorëve relevant të Bashkimit Evropian. Në këtë aspekt në studim parashtrohen edhe rrethana të tjera, të cilat kanë pasur ndikime të rëndësishme në procesin e politikbërjes shtetërore.

Duke iu referuar pjesëve të trajtuara në kapitujt e materialit studimor, në shtrimin e tyre me detaje, paraqesim çështjet dhe nënçështjet si më poshtë:

Kapitulli i II i këtij punimi shkencor, i ndarë në korniza bazike, përmbajtja i referohet trajtimit të lëndës dhe detyrimeve të tjera të pikave në vijim si: lista e tabelave, grafikëve, shkurtimeve që janë një pjesë e rëndësishme e punimit shkencor, si pjesë plotësuese sipas standardeve të parashtruara në punimet doktorale.

Në kapitullin e dytë ndalemi kryesisht në qasjet teorike me bazë shkencore, të cilat janë të rëndësishme për natyrën analitike të studimit të kësaj teme. Në kuadër të saj analizojmë teorinë që përkon me procesin e politikbërjes, duke iu referuar me theks të veçantë praktikës në shoqëritë multietnike, respektivisht opinionet dhe studimet, të cilat janë rezultat i teorive të shkencave politike që përkojnë me realitetin në Maqedoninë Veriore.

Edhe pse studimi fokusohet në tendencat kritike të një politike problematike në këtë periudhë, duke pasur parasysh shumë ngjarje që kanë tronditur opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, ai sjell një realitet politik dhe social të ndjeshëm, që ka shkaktuar herë pas herë kriza politike në RMV. Në material vërtetohet edhe një herë që konceptet teorike mbi politikbërjen gjenë zbatim në rastin e situatës komplekse në RMV, duke veçuar në shkaqet bazike reflektimin e frymës nacionaliste, e dominuar në përfaqësues tipikë të institucioneve shtetërore e publike, me ndikime negative mbi popullsitë e tjera, veçanërisht atë shqiptare. Teoria mbi nacionalizmin gjen një trajtim të veçantë specifik në këtë kapitull, duke sjell argumente mbi pasojat që ajo ka shkarkuar në stabilitetin politik dhe social të vendit.

Sipas disa studiuesve përvoja që njohin popujt e Evropës dhe në botë, në raport me ndikimet e kësaj teorie shpeshherë është përkufizuar: *“Ashtu siç ka evoluar procesi i zhvillimit shoqëror të një vendi, në një apo aspekt tjetër janë shfaqur dhe zhvilluar edhe teoritë politike të cilat kanë gjetur hapësirë në një apo formë tjetër në rrjetin shoqëror”*. Si pasojë e këtyre ndryshimeve dhe zbatimit të koncepteve politike, të pasojave të luftimeve të mëdha të zhvilluara në epokave të ndryshme në historinë e njerëzimit, fati i shumë popujve nuk ka qenë i njëjtë. Kongresi i Vjenës ndërtoi hartën e re të Evropës. Ai ndau, copëtoi e ndryshoi kufijtë e Evropës, sipas interesave të shteteve fituese (*Angli, Rusi, Austri, Prusi*) dhe nuk mori parasysh të drejtat e popujve për

vetëvendosje. Mbeten të copëtuara shtetet gjermane e italiane dhe shumë popuj nuk u lejuan të krijonin shtetet e tyre kombëtare. Shumë popuj të vegjël mbeten nën sundimin e perandorive të mëdha, si ajo e Austro-Hungarisë, Rosisë, Turqisë etj.

Në këtë periudhë u zhvilluan ndjenjat kombëtare (*nacionale*), të cilat çuan në shpërthimin e lëvizjeve për liri, pavarësi e bashkim kombëtar. Vendimet e padrejta të Kongresit të Vjenës, krijuan tek shtetet e Europës "*problemin kombëtar*", i cili u orientua në zgjidhjen e dy detyrimeve të mëdha: Bashkimin kombëtar dhe hartimin e mëtejshëm të politikës së kohës. Kjo lëvizje u zhvillua nga populli italian e gjerman dhe çoi në krijimin e shtetit të bashkuar të Italisë dhe Prusisë. Popujt e nënshtuar luftuan për liri, për krijimin e shteteve të tyre të pavarura. Lëvizje të tilla shpërthyen në Perandorinë e Austro-Hungareze, Rusi e Turqi etj. (Gjini, Shkurt, 2017).

Periudha e luftërave për liri, pavarësi e bashkim kombëtar u quajt Epoka e Nacionalizmit. Popujt që u përfshinë në këtë luftë kanë heronjtë e tyre. Në historinë e popullit shqiptar kjo epokë u përfshi në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare. Dy luftat Botërore e ndryshuan shumë hartën politike të Europës. Në praktikën politiko - historike të Maqedonisë së Veriut, pas shkëputjes nga ish Jugosllavia, ndoq një politikbërje e orientuar nën frymën nacionaliste, duke dhunuar vlerat e popujve dhe pakicave të tjera etnike brenda saj.

Popullsia më e diskriminuar dhe e goditur nga strukturat shtetërore psej vitit 1990 ishte popullsia shqiptare. Dhuna dhe represioni politik me motive etnike i ushtruar në më shumë se një dekaë, nxitën reagimin e popullsisë shqiptare, duke e çuar vendin në konfliktin e armatosur të vitit 2001. Edhe periudha në dekadën në vijim pas marrëveshjes Kornizë të Ohrit u shqërua më kriza politike dhe ngjarje tronditëse, të cilat dhanë ndikim të fuqishëm në politikbërjen e shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pasojat u reflektuan shpesh në kufij shpërthimesh dhe reagimesh politike me pasoja për sigurinë shtetërore e rajonale. Situata në dekadën që trajtojmë në materialin studimor, solli një qasje të re politike në veprimtarinë politike, e cila nuk ushqente aspak rendin, sigurinë dhe një politikbërje të suksesshme.

Brenda një shteti dykombësh dhe me pakica të tjera, skema politike solli një qasje interesante. Edhe pse me programe politike të kundërta, për hir të pushtetit, partitë politike shqiptare dhe maqedone kaluan në hallkat e pushtetit me koalicione, duke konturuar në palën shqiptare pozitë – opozitë dhe po të njëjtën natyrë edhe në palën maqedone. Një skemë politike që nuk përputhej me interesat kombëtare, por thjeshtë me inetersa të pushtetit për të ruajtur kompaktësinë

shtetërore prej tendencave të federalizimit apo më keq, të ndarjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo skemë politike zbatohet edhe sot. Diskriminimi sistematik i shqiptarëve iu nënshtrua dhunës verbale e shtetërore të shtetit dhe pushtetit, duke mbajtur në këmbë një shtet problematik për Ballkanin dhe Europën. Fryma e nacionalizmit ekstrem u bë pengesa kryesore për futjen e vendit në rrugën e reformave demokratike dhe respektimin e të drejtave njerëzore. Politikbërja me probleme shfaq disa karakteristika të tjera, të cilat i shkarkuan pasojat mbi qytetarët edhe në planin social ekonomik, kulturor e arsimor, duke zgjeruar hendekun e bashkëjetesës.

Kësaj teorie i bashkëngjitet më pas **multikulturalizmi**; si pjesë e strukturës politike dhe sociale, e cila në vijimësi trajton disa element bazik të shoqërive që kanë përvoja të kësaj natyre, për shkak të përbërjes së tyre multietnike. Tiparet dalluese dhe studiuesit që merren më këtë fushë teorike, do të zënë pjesën kryesore të këtij kapitulli, duke mos u distancuar nga elementet kyçe që e lidhin natyrën e qasjes teorike me temën e studimit. Në përcaktimin më të saktë të këtij nocioni politiko-kulturor po i referohemi përkufizimit teorik: *“Multikulturalizmi që duhet të konsiderohet si forca e katërt në këshillim, duke konsideruar atë në bazë të teorive filozofike të Biheviorizmit, Psikoanalizës dhe Psikologjisë humaniste”* (Pedersen, 1991).

Brenda këtij konteksti, qëllimi në kapitull orientohet drejt kuptimit më të saktë të nocionit kulturë. Kulturën do ta vlerësojmë si një mënyrë jetese të një grupi të njerëzve, apo ndryshe një model që transmetohet historikisht, i kuptimit të mishëruar në simbole, një sistem i trashëguar i koncepteve të shprehura në formë simbolike, me anë të së cilës njerëzit komunikojnë, përjetësojnë dhe zhvillojnë njohuritë në lidhje me qëndrimet ndaj jetës.

Ish-vendet socialiste të Evropës Qendrore dhe Lindore, në periudhat kalimtare prej vitit 1980 e në vazhdim i ka kapur një valë e vërtetë e shndërrimeve masive demokratike e politike, për të cilat zakonisht përdoret nocioni *“Revolucioni pluralist”*. Pa një presion demokratik nga poshtë dhe pa një refuzim të dëgjueshmërisë së masave, rënia e regjimeve politike nuk do të kishte qenë as aq shpejt, as aq paqësore.

Ngritja e masave nuk i ka kursyer as vendet e shumta të botës së tretë. Nën presionin demokratik të masave kanë përfunduar diktatura të shumta ushtarake në Amerikën Latine. Në Afrikën Jugore para vrullit të shumicës së popullatës me ngjyrë, definitivisht ka rënë regjimi i **aparthejdit**. Ndërkaq, as turri i masave nuk ka gjithmonë cilësi pozitive. Në disa vende të Azisë dhe Afrikës,

një pjesë e masave është e përfshirë me një influencë të madhe të religjionit; çka jep një bazë sociale në dukurinë e fundamentalizmit fetar (*karakteristikë kjo e disa vendeve islamike*).

Në disa vende të Perëndimit një pjesë e pakënaqësisë së masave kanalizohet edhe në drejtim të grupacioneve ekstreme politike, më pas të promovuara në formacione politike të së djathtës ekstreme, të cilët me tendencat e tyre nacionaliste, arrijnë gradualisht të përfitojnë një përkrahje të gjerë dhe të papritur në trupin elektoral (*shembulli i Lepen në Francë*).

Veçoria që trajtohet në këtë kapitull, është shqetësimi prej platformave politike në bazë të së cilës mund të arrihen rezultatet e tilla. Në thelbin e këtyre platformave shfaqen tendenca dhe qëndrime të hapura neofashiste, në pikëpamje të mohimit të të drejtave të qytetarëve të huaj emigrantë, veçanërisht të punëtorëve në punët e rëndomta dhe të qëndrimit ndaj pakicave kombëtare. “*Ndonëse shumica e atyre shoqërive e kanë shpallur multikulturalizmin si vlerë të lartë me efekte pozitive shumëdimensionale në interes të bashkëjetesës, në jetën praktike mund të vërehen tendencat, ku të drejtat e pakicave shoqërore të profileve të ndryshme, të vihen në pikëpyetje*” (Gashaj, 2018).

Në çështje të tjera që janë të përfshira në trajtimin studimor në kapitullin e dytë, janë paraparë edhe qasjet teorike mbi **Teorinë e Liberalizmit**. Duke e konsideruar pjesën e fundit të punimit si një udhëzues dhe dhënie elementesh, të cilat çojnë drejt një frymë orientimi për vendin dhe politikbërjen, është konsideruar e arsyeshme me të njëjtin kujdes edhe çështja e vendosjes së një fryme të re më liberale, në kontekstin e përvojave të reja të cilat janë të pritëshme dhe mund të krijohen në praktikën e vendit tonë. Për më tepër se kaq, liberalizmi si qasje teorike bashkëkohore paraqet:

“Një ideologji politike apo botëkuptim i themeluar mbi idetë e lirisë dhe barazisë, ku liberalët përqafojnë një rrjetë të gjerë të pikëpamjeve në varësi të të kuptuarit e këtyre dy parimeve. Por, në përgjithësi liberalët mbështesin ide të tilla si Konstitucionalizmi, Demokracia liberale zgjedhje të lira, të drejtat e njeriut dhe të ushtruarit e lirë dhe të fesë.

Mendimtari liberal klasik John Locke, i cili shpesh kritikohet për krijimin e liberalizmit si një traditë e veçantë filozofike që e zhvilloi konceptin e të drejtave natyrore dhe kontratës sociale për të argumentuar se sundimi i ligjit duhet të zëvendësojë absolutizmin në qeveri” (Baliqi, 2018).

Një qasje tjetër teorike shkencore që përkon me aspektin e elementeve përbërës të kësaj teme është **egalitarizmi**. Në kontekstin e sqarimit shkencor që i dedikohet kësaj pjese, në mes tjerash thuhet: burimi i parë i së keqes është pabarazia e njerëzve; nga pabarazia ka ardhur pasuria. Nga pasuria kanë ardhur luksi dhe dembelia, nga luksi kanë rrjedhur artet e bukura dhe nga dembelia ka lindur shkenca me këtë terminologji. Këtë çështje bukur e sqaron Rusoi, ku më këtë rast ai vë në përballje natyrën dhe kulturën. Si një koncept që u afirmua dhe sublimua, merita u takon

studiuesve francezë, të cilët fjalën “Egalite” e sqaruan me një definicion shumë konkret ku, *(etimologjikisht ky term rrjedh nga gjuha frënge “egalite” që do të thotë i barabartë)*, që nga Revolucionit Francez i vitit 1789 ai njihet si term internacional.

Nga koha e revolucionit Borgjez Francez, atë e proklamuan si një pikëpamje sipas të cilës, njerëzit janë ose duhet të jenë të barabartë. Për ta kuptuar si duhet barazinë shoqërore, është e nevojshme të kuptojmë të kundërtën e saj, që do të thotë; pabarazitë shoqërore janë si burim i së keqes dhe lindjes së shumë konflikteve dhe luftërave mes popujve dhe kombeve. Sipas Akademikut Fehmi Agani:

“Rusoi niset nga teoria e dy fazave të njeriut, të gjendjes natyrore dhe të gjendjes shoqërore të tij. Ishte ky një supozim që nis nga antika, por që u elaborua veçanërisht nga Hobsi, sipas të cilit, shoqërisë njerëzore i paraprinë një gjendje natyrore ku nuk ka marrëdhënie, zakon, institucione shoqërore, por secili individ manifeston natyrën e vetë, kurse shoqëria u krijua më vonë, me marrëveshje midis njerëzve” (Agani, Fehmi. 2002:168).

Rusoi nuk flet për shoqërinë si një dijetar që vëzhgon nga larg në një mënyrë të paanshme për epokën e tij, por ai e denoncon atë. Padia e tij morale dhe shoqërore nuk kërkon aftësinë e asnjë autoriteti apo institucioni: as nga kisha e as nga shkenca, e as nga rendi i vendosur. Në këtë kontekst mund të parafrazojmë se, Rusoi kërkon për veten dhe njëherazi për çdo individ tjetër, si bartës i vlerave morale themelore, të drejtën për të venë në diskutim kohën, në të cilën ai jeton, vlerat e saj, rendin politik e shoqëror.

“Kundërshtia themelore që qëndron në bazë të kritikës së tij, është ajo midis qenies dhe dukjes; Ajo kryqëzohet me një tjetër, atë midis njeriut dhe natyrës dhe njeriut për njeriun” (Paskal, Ory:79-80). Rusoi e sublimoi gjendjen natyrore për të kritikuar shoqërinë ekzistuese dhe për të nxjerrë në pah dobësitë shoqërore të kohës. Ky trajtim teorik në këtë kapitull i shërben kuptimit të thelbit filozofik të elementeve që veprojnë brenda nacionalizmit dhe se si ato i kundërvihen barazisë, jetës dhe të ardhmes.

Kapitulli III i studimit i referohet kryesisht sqarimit apo qasjes teorike të koncepteve themelore dhe llojit të politikave, të cilat në rastin e hulumtimeve sipas këtij studimi teorik, janë të përcaktuara dhe kanë vlerën dhe rëndësinë e veçantë, në raport me nocionin anëtar. Kjo pjesë ka tendencë të sqarojë elementët përbërës, ndarjet që funksionojnë mes tyre, ka për qëllim që t’i jepet një trajtim më i detajuar. Kjo shtron nevojën e konsolidimit të një opinionimi më të qartë për arsyen se, ne duhet të dimë përse e bëjmë një gjë të tillë, një veprim politik që quhet politikbërje dhe që shquhet me disa element apo tipare të veçanta.

Vetë fakti që po i përmbahemi një procesi politik, apo politikbërjes si proces, është dashur të sqarohen dhe të analizohen në detaje këto element. Në mënyrë metodike, është e nevojshme domosdoshmërisht të njihen në esencë problemet e politikbërjes dhe fazat nëpër të cilat kalon çdo pjesë integrale e saj, për të qenë në gjendje në mënyrë analitike dhe në veprimtarinë praktike të evitojmë problematikat e caktuara, të cilat janë pjesë përberëse në procesin e politikbërjes.

Kjo pjesë evidenton por edhe jep rrugët për thyerjen e disa barrierave të cilat karakterizohen nga natyra nxitëse apo dhe penguese në politikbërjen e mirë apo të keqe. Këto janë fazat e anëtarës, pra një element që studiuesit e ndajnë në disa etapa në formën e ndikimit dhe të realizimit më praktik. Kjo mënyrë është trajtuar në detaje në një rrugë metodike studimore shkencore, e cila mund të gjej gjithmonë zbatimin e saj praktik dhe në çfarëdo lloj mase veprimi në realitetin politik të vendit. Konceptet bazë, aktorët veprues dhe fazat e veprimit, në vetëvete përbëjnë një metodologji studimi, për të sjell një qasje të re në kuptimin dhe zbatimin e politikbërjes në kushtet e një shteti multi-etnik.

Kapitulli IV në tërësinë e tij ndan dhe analizon një koncept shumë më madhor, i cili në thelb dhe përmbajtje i referohet rolit të qytetarit, si një element kyç në një proces politik dhe në një shoqëri demokratike. *“Zhvillimi i mendimit realist mund të shihet si një sërë përpunimesh, ndryshimesh, cilësimesh dhe zgjerimesh të argumenteve bazë”*. (Michael W. DOYLE, 2012:71). Kjo është shkolla teorike e realizmit klasik që duhet të shoqërojë politikbërjen në raportet, *“qeverisje e mire – interesa publike – qytetar”*.

Të vetëdijshëm që qytetarët janë aktorë shumë të rëndësishëm në procesin e mirëfilltë të politikbërjes së gjithanshme të proceseve të zhvillimit të një vendi, në studim, fillimisht në radhitjen shkakësore të problematikës është gjykuar se, qytetarët e vendit duhet të kenë rolin kyç në jetën social politike dhe të mos anashkalojnë momentet e vendimmarrjeve, të cilat janë shumë të rëndësishme në jetën publike. Pra, çdo qytetar ka të drejtën që të jetë pjesë e angazhimit dhe të sjelljes së vendimeve me karakter publik, qoftë në formë të këshillave organizative apo të elementëve joqeveritarë, duke e filluar këtë angazhim që nga nivelet më të ulëta të pushtetit, e deri në përfaqësimin e mendimit të tyre në qeverisjen e lartë shtetërore.

Ky element meriton të shihet dhe të analizohet me syrin kritik, veçanërisht në pjesëmarrjen qytetare në pushtetin qendror. Ajo duhet të realizohet përmes mekanizmave demokratik, të cilët mund të ndikojnë në drejtim të çuarjes përpara të procesit të demokratizimit të pushtetit, rreth një çështje që duhet të krijojë mundësi për vendimmarrje të pranueshme me karakter publik në shërbim të interesit të gjithmbarshëm qytetar. Një politikë e mirëfilltë e mbështetur dhe e

zhvilluar si një iniciativë qytetare dhe që përfshin shumë aktorë brenda saj, është një nga elementet bazë për një proces të demokratizuar dhe të mirëfilltë të politikës publike.

Sipas Traktatit të Amsterdimit të vitit 1999 në nenin 5 dhe 49 theksohet, “Çdo shtet evropian që respekton parimet e lirisë, të demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe të shtetit ligjor, mund të aplikojë për t’u bërë anëtar i Bashkimit Evropian” (AGGESTAM, Lisbeth, 2012:522). Trajtimi i problemit në RMV sipas këtyre kriterëve, ballafaqimi me to në kontekstin kompleks të politikbërjes, jep rekoamdime të vlefshme për ndikime pozitive në reformimin e thellë të shumë elementëve të tjerë të qeverisjes dhe të politikbërjes në interesin qytetar dhe në tërësi të vlerave demokratike të një shoqërie të civilizuar.

Në kuadër të këtij procesi, në këtë kapitull i është kushtuar vëmendje trajtimit më të detajuar të disa elementëve të tjerë të rëndësishëm, të cilët më poshtë janë të përfshirë edhe në brendinë e pyetësorit të intervistave me aktorë të ndryshëm politik dhe qytetar. Çështjet e funksionimit të transparencës në vendimmarrje, të informimit publik apo dhe të konsultimit politik, të ballafaquara me kriteret dhe standardet e BE-së, janë disa element studimorë që sjellin më afër realitetin në angazhimin e jo vetëm të qytetarëve, por ato janë një detyrim më shumë për subjektet politike dhe për institucionet shtetërore. Ata janë të obliguar të jenë në afër mendimit qytetar dhe të respektojnë aspektin llogaridhënës, për të justifikuar në çdo rast besimin e tyre.

Tërheqja e vëmendjes në këtë çështje, dhe futja e problematikës në thelbin e intervistave, analiza e mëposhtëme e opinioneve, janë njëherazi edhe një kritikë e drejtëpëdrejtë për situatën aktuale politike në RMV, pasi mungesat e respektimit të këtyre elementëve, vazhdojnë në nxisin dhe të ngarkojnë me peshën e përgjegjësisë krizën e besimit të qytetarëve ndaj politikës dhe politikbërjes.

Kapitulli V analizon në mënyrë të krahasuar sipas ngjajshmërive praktikat e shteteve multietnike, me disa element specifikë që i karakterizojnë ato, si shoqëri dhe si vende me vlera e kultura të ndryshme, të cilat padyshim mund të shërbejnë edhe si një model i një praktike të mirë drejt një qeverisje të mirë, të nxitjes së proceseve të zhvillimit dhe të jetës demokratike, siç është e nevojshme në një shtet si RMV.

Në kuadër të analizës dhe krahasimit, janë marrë në konsideratë qasjet normative të njërit nga vendet e rajonit, në Republikën e Kosovës. Brenda kësaj praktike theksohet aspekti i përmbushjes normativave në aktin më të lartë juridiko-kushtetues, në të cilën me ligj garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të cilat janë elementi bazë rreth konceptit demokratik të

funksionimit të një shoqërie që jep garanci ligjore, në kushtet e bashkëjetesës etnike, të kulturave të ndryshme, traditës, besimit, simboleve etj.

Rasti i vënies në funksion deri kushtetues i kërkesave të Pakos Antishari në Republikën e Kosovës, është një përvojë 20 vjeçare, e cila ka dhënë disa qasje të reja, edhe në kushtet e një multietniciteti të nxitur nga kushtet dhe kërkesat e kohës. *(Në një Kosovë ku jetojnë 95% shqiptarë dhe vetëm 5% pakica të tjera etnike)*. Përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në kushte të tilla, pozitiviteti dhe vullneti politik i palëve për të ndërtuar urat e komunikimit dhe të bashkëjetesës, janë një përvojë e mirë edhe për politikbërjen në RMV me përbërje të theksuar multietnike.

Në mbështetje të këtij opsiioni, në brendinë e kapitullit në 5 nënçështje të detajuara, janë trajtuar edhe disa shembuj, praktika e përvoja të disa shteteve të Evropës, të mbështetura në rekomandimet dhe standardet që ofron anëtarësimi i tyre në Bashkimin Europian. (BE). Mënyra se si në shoqëritë e civilizuar realizohen këto marrëdhënie, se si respektohen ligjet, veçanërisht në garantimin e lirive dhe të drejtave njerëzore, është shembulli më i mirë për institucionet shtetërore maqedonase, drejt një shoqërie demokratike në zhvillim.

Kapitulli VI: Një pjesë të rëndësishme e studimit zë analiza empirike e problematikës që shtron praktika e multietnicitetit; qasjet e reja që ofrohen nga realiteti në RMV nëpërmjet detajeve dhe elementëve veprues në jetën e përditëshme, duke u bërë pjesë e një pyetsori që është realizuar përmes intervistimit të individëve të pranishëm në politikbërje në nivel të lartë, pjesmarrës në institucionet qëndrore e lokale, në shoqërinë civile dhe të tjerë, të cilët janë përzgjedhur nga pothuajse të gjitha etnitë që jetojnë në shtetin maqedonas.

Vlerësimi në këtë kapitull i përmbajtjes së pyetjeve dhe ndërtimi i tyre në mënyrë të tillë, duke rritur ngarkesën vlerore të problemeve, ka sjell përgjigje shumë interesante, të cilat të shprehura në përqindje dhe variable, sjellin qasje të reja për politikbërjen në RMV, si shtet multietnik.

Ky kapitull është shoqëruar me një numer të konsiderueshëm tabelash, figurash dhe variablesh *(gjithësejt 33)*, të cilat plotësojnë një nga pjesët më kryesore dhe më të prekshme të studimit. Shfrytëzimi i të dhënave statistikore, edhe pse jo fort të mjaftueshme për arsye të ndryshme, kanë dhënë mundësinë për rekomandime efektive ndryshimesh për jetën politike e sociale të vendit. Shtrydhja e këtyre të dhënave është bërë me kujdes, duke iu përmbajtur parimeve në shkencat politike, të ndërthurur edhe më shfaqjet e një psikologjie dominuese që ndikon veçanërisht mbi popullsinë shqiptare në këtë shtet.

Analiza e të dhënave statistikore që kanë të bëjnë me raportet etnike të përfaqësimit në institucionet shtetërore dhe të dhëna të tjera, vërtetojnë saktësinë e punës në terren, duke sjell në vëmendje edhe të gjithë llojet e pengesave të hasura për shkak të paragjyimeve politike dhe etnike, mungesës së besimit në veprimtarinë studimore dhe konfliktit të interesit të individëve të përfshirë në intervista.

Shkak kryesor i vështirësive janë të lidhura edhe me kohën, me ngjarjet e ndodhura në këtë dekadë, më uljet dhe ngritjet e tensioneve politike në vend, qëndrimin e faktorëve politik të brendshëm me ndikim, si dhe të faktorit politik ndërkombëtar, të cilat përbënë një sfidë më vete në plotësimin lëndor të studimit shkencor.

Kapitulli VII: Pjesa e fundit të këtij hulumtimi shkencor është e përqendruar më shumë tek disa detaje që i referohen pjesës së përfundimeve të punimit apo konkluzave, të cilat kanë dalë si rezultat i trajtimit në përbërjen e strukturës së përgjithshme, të ndërtuar mbi një bazë logjike sipas parimeve të shkencave politike.

Rekomandimet janë pjesa më e rëndësishme e këtij kapitulli, duke plotësuar një detyrim me disiplinë shkencore, të cilat mbështesin qëndrimet e ekuilibruara dhe të harmonizuara, jashtë ndikimeve dhe preferencave etnike. Rekomandime të tilla i shërbejnë përmirësimit të situatës politike dhe metodologjisë së politikbërjes për ta çuar procesin e demokratizimit të vendit më përpara.

Vlera e përfundimeve dhe rekomandimeve merr kahje praktike, pasi ato janë si deduksion i analizave të kryera mbi një realitet konkret, në një shtet konkret, në një legjislacion veprues dhe në kontakte me individë, të cilët janë pjesë e përballjes me pasojat e sistemit politik diskriminues, por edhe pjesë e proceseve të ndryshimit drejt një shoqërie demokratike të konsoliduar. Pasqyra e bibliografisë ku është mbështetur studimi, është një tregues i seriozitetit të hulumtimit teorik dhe lëndor, që plotëson së fundmi tërë paraqitjen e plotë të studimit shkencor, ***“Politikbërja në një shtet multietnik, praktika e Republikës së Maqedonisë së Veriut”***.

I.2. Qëllimi i punimit

Ky punim ka për qëllim të evidentojë rëndësinë e transparencës dhe nevojën e domosdoshme të demokratizimit të institucioneve vendore e qendrore, aktorëve të politikbërjes dhe pushtetit ekzekutiv, të cilët janë në rolin e kreatorëve të politikave publike. Në vijimësi, të evidentojë

vlerat e rolit të qytetarëve në procesin e politikbërjes, ku padyshim ata janë një faktor kyç në veprimtarinë e një shteti demokratik. Për më tepër, studimi ka për qëllim që të analizojë trajtesën e barabartë në baza etnike gjatë procesit të vendimmarrjes prej organeve administrative dhe institucioneve publike, të legjitimuar për të marrë vendime me karakter publik.

Te evidentojë përfshirjen e pjesëmarrësve në proceset vendimmarrëse në baza etnike, duke e vënë atë edhe si një detyrim i diktuar nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, pas konfliktit të vitit 2001, të detyrimeve të tjera të cilat kanë qenë pjesë e rekomandimeve permanente nga Komisioni Evropian për RMV. Po ashtu, qëllimi i hulumtimit është që të rishikojë në periudha afatshkurtër dhe afatgjatë proceset vendimmarrëse dhe të jap opinion për gjendjen reale të zhvillimeve deri në ditët e sotme.

Për të arritur në përfundim të analizave, studimi është fokusuar tek hulumtimi në teren dhe opinionet nga aktorë real, pjesëmarrës të procesit të politikbërjes në praktikën politiko-juridike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

I.3. Objektivat e punimit

- Të analizohet zhvillimi i procesit të politikbërjes në nivel qendror dhe lokal në Maqedoninë Veriore;
- Të identifikohet ndikimi i etnisë maqedone në nivelin e diskriminimit ndaj qytetarëve të tjerë në Maqedoninë Veriore.
- Të sjell disa përvoja praktike, të cilat janë pjesë e realitetit të një procesi politik që zhvillohet në kuadër të orientimeve të shtetit dhe të shoqërisë drejt aspiratave të anëtarësimit në strukturat veriatlantike dhe në Bashkimin Evropian.

Drejtimit e pyetjeve kërkimore:

Variabla e varur: Politikbërja;

Variblat e pavarura: Transparenca;

Aksesi i grupeve etnike në politikbërje;

Variabla e varur: Politikat publike;

Variblat e pavarur: Aksesi i grupeve etnike në politikbërje;

Politikat dhe shërbimet publike.

I.4. Pyetje kërkimore

Mbështetur në hipotezën kryesore dhe hipoteza të tjera, studimi është orientuar në përgjigjet e argumentuara të disa pyetjeve kërkimore:

- Si realizohet sinergia në pjesëmarrjen e shqiptarëve në qeverisjen vendore dhe qendrore dhe sa ndikon ajo në politikbërjen qendrore në RMV?
- Çfarë pasojash ka krijuar mungesa e kohezionit politik të shqiptarëve në politikat e zhvillimit dhe politikat publike (*në favor të shqiptarëve*) në RMV?
- Cilat janë pasojat e pjesëmarrjes së pabarabartë në politikbërjes dhe krijimit të shpërndarjes së pasurisë dhe shërbimeve publike?

I.5. Hipotezat

Hipoteza 1 – Të vërtetohet mbi argumente në vlera historike përfaqësimi i pabarabartë i shqiptarëve në qeverisjen vendore dhe qendrore dhe sa ky raport ka ndikuar në politikbërjen diskriminuese ndaj tyre në RMV.

Hipoteza 2 - Mungesa e kohezionit politik të partive shqiptare, vazhdon të mbetet një nga faktorët kryesor të përfaqësimit të pabarabartë që sjell politikbërje diskriminuese ndaj qytetarëve shqiptarë në RMV.

Hipoteza 3 – Të vërtetohet që, mungesa e kohezionit politik dhe e përfaqësimit të pabarabartë, kufizojnë mundësitë e potencialeve reale politike dhe elektorale, duke thelluar më tej pabarazinë mbi shqiptarët në rishpërndarjen e pasurisë dhe të financave të shërbimeve publike në RMV.

I.6. Metodologjia

I.6.1. Zgjedhja e metodave të përdorura në funksion të temës së studimit

Metoda është gjuha e metodologjisë. Rruga që jep më shumë rezultat konfiguron metodologjinë më produktive në zbatimin e programeve politike. Programimi në fushën e politikbërjes si një udhëheqje për veprim, koncepton metodat dhe metodologjinë më të arrirë. Nëse metodologjia, metoda dhe stili janë diçka që sjellin produktivitetin, atëherë kemi kuptuar thelbin filozofik të politikbërjes në një shtet multi-etnik. Hegel e pranonte filozofinë në fushën e mendimit, por nevoja e kohës e solli që ky koncept të futej në rrugën e ndryshimit, që mendimi i revolucionarizuar të arrinte ndryshonte botën dhe jetën e njeriut.

Kjo mënyrë të menduari vlen për fushën politiko – juridike të politikbërjes. Ndërthurja metodologjike është realizuar pa anashkaluar ngjajshmërinë dhe dallimet midis politikbërjes në nivelet qendrore e lokale. Synimi në studim përjashton mundësinë e “*humbjes*” së problemit kryesor brenda hullive të trajtimit teorik të “*metodologjisë studimore shkencore në rritjen cilësore të politikbërjes*”.

Parashtrimi në studim i disa tipologjive të formave të reja mbi mënyrën e shfaqjes dhe të veprimit të fenomenit të multi-etnicitetit dhe politikbërjes, të vërtetimit të hipotezave të shtruara, mbi natyrën që shfaq praktika politike në RMV në dekadën që analizojmë, është zhvilluar të thellësi, duke mos përdorur shkurtesa. Në terminologjinë e përdorur, është tentuar të shkruhet pastër gjuha letrare shqipe, pa huazime fjalësh të huaja.

Punimi përqendrohet në trajtimet sqaruese teorike dhe praktike të proceseve të reformimit të politikbërjes sipas praktikave të një shteti multi-etnik, bazuar në rastin e Republikës së Maqedonisë Veriore, duke përfshirë këtu sferat e ndryshme të proceseve të integritit, procedurat politike, sociale dhe juridike për të hapur bisedimet me strukturat e Bashkimit Evropian BE-së, në formatimin e koncepteve bashkëkohore që do të duhet të përfshijnë shoqërinë dhe shtetin në këtë proces.

Domosdoshmërinë e përkrahjes së strukturave vendore drejt ndryshimeve pozitive të pritëshme, qartësimin e të gjithë orientimeve dhe vrejtimeve të publikuara ndaj politikbërjes në RMV, duke synuar reformimin e aktorëve përgjegjës të politikbërjes apo politikave publike.

Mënyrën e tejkalimit apo të transferimit të kompetencave që do t'i nevojiten garantimit të pavarësisë së pushteti vendor, në një situatë relativisht normale, të planifikuar dhe të mbështetur mbi kriteret dhe standardet ndërkombëtare.

Vend i posaçëm në tezën kryesore i kushtohet fazës kërkimore mbi problematikat e pushtetit aktual, që me vështirësi pranon të deklarojë me transparencë fërkimet që lindin si rezultat i

veprimet akut të pushteteve partiake, të cilat shpesh mbështeten në koncidencën e zotërimit të pushteteve, duke e kaluar sistematikisht pushtetin qendror dhe lokal nga një subjekt politik tek tjetri. Mangësitë e personelit të pakualifikuar dhe të thirrur me synime të paracaktuara për të marrë përgjegjësi institucionale e profesionale, neglizhenca ndaj kapriçove në mospërputhjen e qëndrimeve politike, të cilat shpesh ngrenë barriera të pakapërcyeshme mes palëve, kundër konsensusit politik dhe duke shkarkuar pasojat kundër interesave të qytetarëve në sferat publike.

Njëkohësisht punimi studimor do të shërbejë edhe si paraqitje e modelit të përshpejtimit të reformave të thella institucionale në interes të politikbërjes, për vendosjen e formave të reja të vizionit dhe administrimit të proceseve politike, duke u mbështetur dhe përshtatur me nivelin e standardeve të Evropës dhe botës së civilizuar. Çështjet e shtrura paraprakisht në këtë material marrin në konsideratë të gjithë raportet periodike të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)-së, të realizuara brenda periudhës 2007-2017. Në këtë përmbledhje përfshihen: Raportet periodike të Freedom House, USAID, dhe zyrës së Avokatit të popullit në RMV; Raportet e Këshillit Evropian dedikuar zhvillimeve të fundi nga periudha kohore, 2007-2017; Analizat e Institutit Evropian për Politikbërje me seli në Shkup etj.

Gjithashtu, janë shfrytëzuar debatet dhe analizat që janë zhvilluar në RMV nga analistët dhe hulumtuesit më në zë në fushën politike, ekonomike dhe sociale në trajtimin e praktikave të ditës dhe ato periodike, (*konsultat mediatike apo TV opinionet*); Disa të dhëna nga studimet praktike tek autoritetet e pushtetit lokal dhe atij qendror në Maqedoni, (*gjatë periudhës, 2015-2016*) etj.

Në referencat mbështetëse veç të tjerash, janë qëmtuar me kujdes format më të arrira të praktikave e përvojave të ndryshme politiko – juridike e psikologjike mbi politikbërjen në kushtete e shtetit multi-etnik. Janë përdorur me kujdes përpunimi i mjaftueshëm, për të sjell materialin e krahasuar me përfundime sistematike dhe të zbatueshme. Kjo është arrirë mbi metodën përshkruese, empirike, analitike, historiko - juridike dhe normative, të cilat në përfundime përgjithësuese kanë sjell vlera interesante dhe intriguese.

Mbi vlerësimin relativ të konstatimeve përgjithësuese dhe përfundimeve kuptohet që, thelbi në studim ka të bëjë me shpjegimin, mundësinë dhe pamundësinë, fuqinë dhe pafuqinë institucionale për të miradministruar të gjitha kapacitetet studimore dhe praktike që zotëron shteti dhe shoqëria, sipas një metodologjie politike shkencore, duke përfaqësuar brenda tyre vullnetin për t'i kapëcyer vijat frenuese dhe diskriminuese.

I.6.2. Metodat kryesore të përdorura

Mbi rëndësinë teorike dhe praktike të vërtetimit të hipotezës kryesore në studim, synimi *qëndron në faktet konkrete, të bazuara në punën kërkimore - shkencore edhe të studiuesve të tjerë shqiptarë, mbi bazën e analizës dhe mbështetjes në fushën politiko-juridike, drejt standardizimit të sistemit politik dhe të përsosjes së politikbërjes në drejtimin e shoqërisë dhe të shtetit në një popullsi multietnike, duke marrë në analizë zhvillimet konkrete në krahasuesmëri me përvojat e vendeve të tjera*. Kjo metodë e sjell problemin pranë realitetit, se si fenomeni vepron dhe duhet të veproj më tej në të ardhmen, për të mos lënë hapësira boshe dhe asnjë mundësi që pushteti qëndror dhe ai vendor të shkelin parimet e shtetit ligjor të së drejtës.

Trajtimi i fenomenit nuk është kufizuar brenda kuadrit të kornizave doktrinare dhe praktikave ekzistuese, por ai është shtrirë e zhvilluar në hapësira alternative, të cilat japin mundësi më të shumta të reformimit institucional, jo vetëm të akteve politike e juridike që normojnë veprimtarinë e politikbërjes, por dhe kërkesave euroatlantike në rritje, të cilat ushtrojnë presionin e tyre mbi institucionet qëndrore në RMV. Metodatat kryesore të përdorura në këtë punim shkencor janë: i) Kërkimi nëpërmjet testimit; ii) Analiza e të dhënave ekzistuese; iii) Analiza krahasuese iv) Puna në fushë.

I.6.3. Kërkimi nëpërmjet testimit

Kërkimi nëpërmjet testimit është realizuar kryesisht përmes përdorimit të pyetësorëve, si instrumenti kryesor i kësaj metode. Mbështetja në përvojat e standartizuara ndërkombëtare, jep mundësi për të vepruar në dimensionin e mjedisit shqiptar, duke i respektuar ato institucionalisht, pse jo si rrjedhojë e shkëmbimit të përvojave dhe vendosjes ligjore të urave të bashkëpunimit ndëretnik. Studimi mbështetet në të dhënat e grumbulluara nëpërmjet një pyetësoi të realizuar me nëpunës veçanërisht të sektorit publik, të punësuar në sektorin qeveritar, që përfshin një numër të konsiderueshëm individësh, deri në 300.

Intervistat janë realizuar kryesisht nëpërmjet komunikimit elektronik. Të dhënat e siguruar janë analizuar në mënyrë analitike dhe mbi bazën e tyre, janë hartuar tabelat me të dhënat kryesore, sipas pyetjeve dhe çështjeve përkatëse. Intervista janë realizuar gjithashtu me autoritete shtetërore jashtë vendit, siç është rasti i Ministres për Dialog në Qeverinë e Kosovës, për një opinion në ngjajshmëri, që ka të bëjë me respektimin e të drejtave të etniteteve në praktikën e Republikës së Kosovës.

Studimi mbështetet në intervistat me aktorë të skenës politike nga vendet e rajonit, sidomos nga Republika e Kosovës, duke e konsideruar këtë vend me një të kaluar pak a shumë të ngjashme

me përvojën në RMV. Lidhur me këtë aspekt, nga përvojat e reja të cilat lindën në shtetin e ri të Kosovës, fill pas përfundimit të luftës, u dhanë shembuj të praktikave të reja, të cilat u krijuan në praktikën e politikbërjes në këtë shtet, dhe për të cilën sot ka disa aspekte që lidhin me modelin e ri të funksionimit në një shtet me një shoqëri multietnike, të bazuar në vlerat e standardeve demokratike.

I.6.4. Analiza e të dhënave ekzistuese

Kjo metodë konsiston në analizën e të dhënave të mëposhtme:

- i) Raportet periodike të autoriteteve evropiane, të cilat i adresohen Qeverisë dhe Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në drejtim të reformimit të çështjeve themelore për funksionimin e shtetit ligjor të së drejtës dhe vendosjen e standardeve brenda kornizave të një sistemi politiko – juridik të pranuar;
- ii) Informacione mbi opinionet dhe debatet që i referohen procesit të politikbërjes në këtë vend;
- iii) Analizës së burimeve mbi qëndrimet kritike të studiuesve, rreth analizës së politikbërjes në RMV.

Analiza e të dhënave realizohet duke u mbështetur në krahasimin me disa parametra bazik, në kuadër të të cilit funksionojnë disa shtete brenda Bashkimit Evropian (*BE*), si shtete me shoqëri multietnike, në formën e organizimit të shteteve me një model të tillë multietnik, duke u ndaluar në të kaluarën e tyre historiko-politike, bazuar në vlerat dhe civilizimin e lashtë të lidhur me traditën e manifestimit të vlerave të demokracisë dhe elementëve të tjerë, që përkojnë jo vetëm me standardet e funksionimit të një shteti modern, por edhe me ato që konsiderohen si pjesë e një sistemi të bazuar në vlera fundamentale të demokracisë.

I.6.5. Puna në fushë

Puna në fushë është realizuar nëpërmjet kontakteve me qytetarët dhe vendimmarrësit e politikbërjes në mjedise të ndryshme: institucione, agjenci, njësi vendore, organizata politike, organizata të shoqërisë civile etj. Kontaktet e drejtpërdrejta me këto grupe njerëzish, kanë mundësuar grumbullimin, përpunimin dhe analizën e përjetimeve të tyre, mbi problematikat që parashtrihen dhe analizohen në këtë studim.

I.7. Kontributi i punimit kërkimor

Jetojmë në rrethanat e një shoqërie, ku globalizimi si proces është një sfidë, me të cilën çdo shoqëri ballafaqohet sot. Ky hulumtim trajton përmbushjen e standardeve që duhet ndjekur për të arritur një status më të preferuar në mesin dhe modelin e vendeve të civilizuar të botës dhe shoqërive të zhvilluara në përgjithësi, duke marrë në konsideratë po ashtu faktin që, vendi ka aspirata dhe më të mëdha, anëtarësimin në strukturat euroatlantike.

Punimi mund të kenë një ndikim në ngritjen e mentalitetit të protagonistëve politikë dhe ngritjes së vetëdijes tek qytetarët në vendin dhe rolin e politikbërjes, para së gjithash në rrethanat e shoqërisë së cilës i referohemi. Ai mund të jetë një kontribut në sferën e shkencave politike, që do të shërbejë si një hulumtim bazë i kësaj fushe për studime edhe më të thelluara në të ardhmen në bazën e teksteve universitare, në pjesën praktike për studentët.

Duke synuar të jemi pjesë e rëndësishme e një situatë apo përvoje, e cila kërkon serizisht një ndërhyrje imediate në procesin e reformimit të mënyrës së realizimit politik në praktikën e politikbërjes në RMV, kontributi i studimit shkencor, ka për qëllim që të përqëndrohet tek pikat kyçe, të cilat e devijojnë procesin e mirëfilltë të një politike që do të rezultonte si një shembull i mirë për shtete e rajonit në Ballkanin Perëndimor. I theksojmë këto pika referimi, sepse ato i përkasin një situatë reale, vepruese dhe me ndikime gjeopolitike në rajon, probleme këto që ende sot shfaqen në debatet publike dhe janë bërë shqetësim real për qytetarët dhe faktorin ndërkombëtar, duke dhënë ndikime në vendimmarrjen e faktorit politikbërës në RMV.

I.8. Kufizimet e punimit kërkimor

I.8.1. Saktësia e përgjigjeve të intervistave

Saktësia e përgjigjeve të intervistave nuk ka qenë në çdo rast e garantuar, për shkak se tema është shumë e ndjeshme dhe të intervistuarit edhe kanë hezitur të shprehen lirisht për të gjitha çështjet.

I.8.2. Kufizimet për të përdorur gjerësisht punën në fushë

Kufizimet e studimit për të përdorur gjerësisht punën në fushë, për shkak të lidhjes së vëzhgimit dhe kontakteve në institucione, jo gjithmonë kanë qenë të mundura. Vetë fakti që angazhimi direkt në aktivitete politike ka ndikuar në paragjykimet që paraqiteshin në raste të realizimit të kontakteve me aktorë të politikës, duke e justifikuar atë me bindjen se mos ndoshta të dhënat dhe mendimet merren padrejtësisht për qëllime e përfitime politike.

Vështirësia tjetër ka të bëjë me bindjen e aktorëve që ishin pjesë e institucioneve të politikbërëse, pavarësisht se synimi dhe orvatjet kanë qenë krejtësisht me qëllime studimore shkencore, për të

nxjerrë dukuritë negative të funksionimit të politikbërjes në vend. Sado që identifikimi i hulumtuesit arsyetohet me faktin që, prania dhe angazhimi i tij kanë qenë pjesë e planifikimit shkencor të një institucioni të lartë arsimor publiko-privat, sërish ishin rrethana të kohës që e vështirësuan punën në fushë.

Këto vështirësi u hasën edhe në zgjatjen e realizimit të punimit shkencor, sepse ky studim është i lidhur ngushtë me realitetin e prekshëm që po përjetohet sot në RMV. Duke qenë pjesë e procesit për të studiuar më thellësisht këto dukuri, u bë e mundur që ky studim të spikatë ato element që janë pjesë shumë e ndjeshme e shoqërisë shqiptare dhe popullsisë që jeton në RMV, mbi pozitat reale që ajo përjeton në jetën social-politike në këtë shtet.

I.8.3. Vështirësitë e analizës së të dhënave ekzistuese

Analiza e të dhënave ekzistuese vështirësohet nga që ato prekin kryesisht problematikat më delikate të zhvillimit dhe të qeverisjes në RMV, ku përherë fokusohet vëmendja në analizën konkrete të problematikave multietnike dhe pjesëmarrjes së tyre në mbështetje të të drejtave njerëzore, fshehjen e të dhënave kundër krimit ekonomik, ekologjik, kompjuterik dhe të dhënave të tjera që kanë të bëjnë me statistikat qendrore të shtetit.

Brenda këtij procesi këto të dhëna sot në RMV janë të rrezikuara edhe nga ndërhyrjet pirate kompjuterike në sistem, për fshirjen e të dhënave, apo dhe manipulimin e tyre. Të dhënat ekzistuese, nga praktika rezultojnë si monopol vetëm i individëve dhe organeve të besueshme, të cilët me fanatizëm ruajnë “autoritetin” e shtetit. Një vështirësi më shumë në sigurimin e të dhënave në interes të studimit.

I.8.4. Vështirësitë e natyrshme studimore në një shoqëri multietnike

Prania me një klimë të acaruar midis popullsisë me etni të ndryshme ka krijuar vatra tensioni, konflikte etno-fetare, përplasje të kulturave, diskriminime financiare, mungesë të vullnetit politik dhe kundërshti masive, duke prodhuar me shumicë imazhe negative, nacionalizma dhe përplasje etnike me paranoja shkatërruese. Pleksja e problematikave multietnike me problematikat e qeverisjes, politikbërjes dhe të zhvillimit, është një tjetër rrethanë që e vështirëson punën e studiuesit për realizimin e këtij studimi.

Prania e diversitetit, ndonjëherë konfliktual, që gjeneron politika jo të drejta, pakënaqësitë, nxitja e frymës nacionaliste, pabarazia gjinore, uurejtja, racizmi, përplasja e besimeve, dhuna e ushtruar në mënyrë institucionale ndaj gjuhës, traditës, simboleve, mjellin një klimë mosbesimi me

hapësira ndarëse, të cilat bëjnë barriera dhe pengesa kryesore, vështirësisht të kapërcyeshme edhe kur është fjala për një studim shkencor të situatës me motive pozitive.

I.8.5. Kriza politike

Në përvojën politike, lëvizjet sociale me objektiva të paracaktuar të kërkesave për model ekonomik dhe rimodelim të demokracisë, kanë prezantuar kërkesa dhe një mënyrë të menduar ndryshe nga pushteti dhe qeverisja. Brenda një kornize të tillë autoriteti politik fillon të reagojë me një paqëndrueshmëri evolutive të moralit. Këtu fillon krisja dhe ndarja.

“Jepuni qytetarëve mundësinë për të marrë vendime, kjo nuk është çështje demokracie, por edhe dinjiteti”. (Abazi, Bashkim. 2013:124). Modeli i demokracisë moderne është një derivat i një kompromisi historik midis pushtetit oligarkik, financiar dhe atij politik. Shpesh në kundërshtim me thelbin e demokracisë, përfaqësimi i pushtetit është aspekti i kundërt i saj. Çdo veprim dhe qëndrim në marrjen apo lëshimin e pushtetit, nuk është i përjashtuar nga protestat, ankimumet, kritikën dhe deri tek kundërshtimet e dhunëshme.

Mendimi politik i sunduar nga konfliktet emocionale apo të interesave të aktorëve kryesore politikë, e çon shoqërinë dhe shtetin në krizë politike.

“Konfliktet kanë ndodhur jo vetëm midis shoqërive që nuk e kuptojnë njëra tjetrën, por edhe midis atyre që e kuptojnë njëra tjetrën fare mirë.atje ku vlerat, ideat apo objektivat strategjikë janë në kontradiktë të thella, ekspozimi dhe lidhja me rastet mund t'i ndezin konfliktet aq sa dhe mund t'i zbusin”. (Kissinger, Henry, 2015:96)

Një situatë e tillë është e pranishme edhe sot në RMV. Në një kohë relativisht të gjatë në tre dekada, palët në konflikt politik e kanë kuptuar mirë njëra tjetrën, por ndasitë dhe mospajtimet janë dhe mbeten në mënyrë të njëanëshme, për të mos lëshuar hapësirë në të drejtat kombëtare. Është kjo arsyeja që në vitin 2001 shqiptarët iu drejtuan rrugës së luftës. Një zgjidhje e gabuar, por e detyruar për të evidentuar në opinionin ndërkombëtar praninë e një shteti dykombësh.

Kjo situatë komplekse me vazhdimësi deri në ditët e sotme kërkon studimin më të thelluar. Politika në RMV, ka të nevojshme rekomandime mbi studime shkencore të gjendjes. Ndryshimi në jetën social politike dhe ekonomike të këtij vendi është baraz; ekzistencë. Mes etnive shqiptare dhe maqedonase duhet të krijohet “zona liberale e paqes”, e cila do të jap efekte në politikën e brendshme dhe të jashtme të shtetit. (Michael W. DOYLE, 2012:94). Puna për realizimin e studimit përkon me një realitet kohor dhe esencial të tillë, i cili i referohet situatës reale të jetës politike dhe institucionale, duke rrezikuar shmangien nga standardet e funksionimit normal të shtetit.

I.8.6. Ndryshimet e vazhdueshme në reformat ligjore

Pushteti politik shfaq prirjen e interesit të dobishëm (*ndonjëherë dhe të kundërt*) të grupit social dhe politik që përcakton qartë vizionin për të ardhmen, pranifikon dhe zbaton drejt ligjet e progresit social ekonomik të shoqërisë. Kundër kësaj paradigme politike, qeverisja në RMV nuk rrezulton të rreshtohet ndër qeverisjet e mira, për shkak të zvarritjeve të ndryshimeve të thella juridiko – kushtetuese dhe ligjore, drejt shtetit të së drejtës.

Të përfshirë në këtë kaos të ndryshimeve të vazhdueshme në reformat ligjore të sistemit të Drejtësisë, kontakti institucional ishte një tjetër vështirësi dhe rrethanë jofavorizuese në plotësimin e kërkesave të tezës së studimit. Kjo situatë vështirësoi përpunimin e saj në proces. Shpeshësia e ndryshimeve në kohë relativisht të pafavorëshme, vështirësoi përpjekjet për të vlerësuar zbatimin e tyre në praktikë. Institucionet publike në rrethanat aktuale, në kuadër të të cilave zhvillohet procesi politik në RMV, kanë hezituar në komunikim me opinionin publik, sidomos kur flitet për rastet kur është i nevojshëm komunikimi i afërt dhe transparent me përfaqësuesit legjitim të institucioneve dhe vendeve të punës në administratën shtetërore.

I.8.7. Mungesa e të dhënave statistikore nga autoritetet relevante zyrtare të vendit

Në Maqedoninë Veriore, ashtu si dhe në shumicën e shteteve të cilat janë në proces të reformimit dhe të zhvillimit, ka një mungesë të theksuar të të dhënave nga agjensitë statistikore, të cilat përpilojnë dhe rifreskojnë të dhënat rreth studimit të dukurive të ndryshme që ndodhin apo zhvillohen në shoqëri; si në aspektin ekonomik, politik dhe atë social. Ka më shumë se dy dekada që nuk është bërë regjistrimi i popullsisë, edhe pse në pikëpamje ligjore vendi është i obliguar që me përfundimin e një dekade ta bëjë këtë.

Dështimi i radhës i mosregjistrimit të popullsisë, shfaq hapur krizën politike të pushtetit të drejtuar nga VMRO-DPMNE dhe BDI, frika e të cilit u shfaq më së shumti në rezultatet që mund të ndryshonin ndjeshëm numrin e popullsisë shqiptare në RMV. Çështja e numrit të popullsisë edhe sot është një nga shqetësimet kryesore të qarqeve nacionaliste maqedonase, të cilët pretendojnë që, RMV është shtet vetëm i maqedonëve.

Mosevidentimi apo dhe mungesa e transparencës mbi statistikën e ndryshme, janë një hije në politikën shtetërore, sepse brenda tyre fshihen tendencat dhe aktet e diskriminimit etnik. Në këtë aspekt, shfaqet edhe një dukuri tjetër; kokëfortësia e autoriteteve për të mos dhënë apo për të mos bërë publike të dhëna të ndryshme statistikore, të cilat janë shprehje e drejtëpërdrejtë e sukseseve apo e dështimeve të shtetit dhe pushtetit.

Mbi këto koncepte frenuese dhe fobike, në praktikën e institucioneve gjërat lëvizin me një temp shumë të ngadalshëm. Për hirë të këtyre rrethanave, hulumtimi shkencor merr për bazë edhe disa statistika dhe të dhëna, të cilat janë nga Freedom House, GINI, dhe autoritete të besueshme, të cilat periodikisht në formën e raporteve statistikore kanë hartuar dhe publikuar të dhëna nën autorësinë e përfaqësuesve të huaj që operojnë në Maqedoninë Veriore, si aktorë apolitik, respektivisht organizata joqeveritare, të dhënat e të cilave janë shumë më të besueshme dhe që përkojnë me realitetin objektiv.

KAPITULLI II: Rishikimi i literaturës

II.1. Teoritë themelore politike në shoqëritë multietnike

Në aspektin e qasjes shkencore të teorive bashkëkohore politike, të cilat mund të merren në konsideratë dhe të shërbejnë brenda kornizave të këtij punimi shkencor, janë bërë përpjekje që të veçojmë ato teori, qasja e të cilave korrespondon me realitetin e shoqërisë sonë, respektivisht e atyre elementeve për të cilat ky punim shkencor ka nevojë të mbështesë qëndrimet e bazuara në teori. *“Në kërkim të vlerave njerëzore, shprehja e parimeve të rëndësishme qështë hapi i parë, kurse pastaj ato duhen përçuar nëpër paqartësitë e brendshme dhe kontradiktat e të gjitha çështjeve njerëzore, gjë që është detyrë e politikës”*. (Kissinger, Henry, 2015:367). Nisur nga kjo pjesë e rëndësishme, që i referohet qasjes shkencore, po fokusohemi gjithashtu tek mendimet e studiuesve të tjerë:

“Qëllimi kryesor i teorisë politike është të kuptojë politikën dhe shoqërinë, duke përdorur disa të dhëna kryesisht të marra nga filozofia, sociologjia, psikologjia. Rëndësia e teorisë politike është t'u japë njerëzve një orientim kuptimplotë dhe racional për të kuptuar se si po ndodh në politikë dhe në shoqëri. Duke përdorur disa teori politike është më se e mundur të kuptojmë marrëdhëniet më të thella dhe thelbësore midis gjërave, zhvillimeve dhe ngjarjeve. Por është e rëndësishme të theksohet se teoritë politike nuk përdorin vetëm marrëdhënien shkak-pasojë për të kuptuar këto raporte, duke thënë se ato përmirësojnë disa mendime kritike dhe sugjerime ndaj politikës aktive. Në lidhje me këto perspektiva, statusi në shoqëri është shumë i ngjashëm me filozofinë. Pra, nuk ka vetëm një teori politike, ka një shumëllojshmëri të teorive që u takojnë teoricienëve të ndryshëm.” (Gökdağ, 2016).

Teoria politike është e rëndësishme, sepse ajo arrin të çlirojë nga skllavëria njerëzit, duke mishëruar në logjikë të pastër dhe të arsyetuar, se të drejtat njerëzore janë të patjetërsueshme, që askush nuk ka të drejtë të shkelë lirinë themelore të njerëzve. *“Rendi nuk duhet të ketë përparësi ndaj lirisë. Por afirmimi i lirisë duhet të ngrihet nga një atmosferë e përgjithshme të një strategji”*. (Kissinger, Henry, 2015:367). Për herë të parë në histori, teoria politike u siguron qenieve humane kthjellimin prej trillimeve arbitrare të një autoriteti, duke e ngritur atë në nivel strategjik; Njerëzit mund të ndihen të sigurt që prosperiteti i sotëm do të vazhdojë edhe nesër! Me të drejtë, në këtë rast, disa studiues arsyetojnë me të vetmin qëllim dhe shembull praktik, duke thënë se:

Qeveria cakton telefonin tuaj. Ju e kundërshtoni atë, sepse e drejta juaj e patjetërsueshme ndaj privatësisë është shkelur. Imagjinoni nëse nuk keni një pretendim për këtë të drejtë. Imagjinoni nëse qeveria mund t'ju shkelë dhe ju nuk mund të kërkonin ndonjë të drejtë më të lartë të patjetërsueshme mbi qeverinë për të mbrojtur veten. Kjo ishte teoria që trajtonte praktikën se si ishte populli i botës që jetonte para teorisë politike. (Kakutani, 2016).

Një teori është një mjet në shërbim të inteligjencies për të kuptuar realitetin që i përket një disipline shkencore apo administrative. Një teori është thelbësore për një disiplinë sepse ajo shpjegon metodikën e të kuptuarit dhe trajtimit të gjërave:

- Kuptimin e lëndës;
- Ekzistenca, mbijetesa dhe njohja e saj si disiplinë autonome;
- Zhvillimi i teknikave dhe metodave të studimit;
- Vlerësimi i njohurive ekzistuese dhe mundësitë për zgjerimin e mëtejshëm të tij;
- Gjetjen e fushave të reja të hulumtimit.

Mund të thuhet se në Shkenca Politike, si një disiplinë e shumëfaktorshme dhe shumëdimensionale, nuk ka një teori të gjerë politike sesa një të tillë. Ajo ka vetëm një teori moderne në rritje, e cila është ende e pjekur. (Ghosh, 2017). Nacionalizmi është një teori e legjitimitetit politik, i cili kërkon që kufijtë etnikë të mos kufizohen në ato politike. Kjo rrjedh se një njësi politike territoriale, mund të bëhet etnikisht homogjene vetëm nëse ajo vret, përjashton ose asimilon të gjithë me etni dhe shtetësi tjetër. Detyra e teorisë politike është të vendosë ekuilibrer në politikbërje.

Bindjet kulturore në të dy pjesët kryesore të Maqedonisë së Veriut janë homogjene, shqiptare dhe maqedonase. Komunikimi ndërkulturor dhe kapërcimi i barrierave ndarëse, është një nga faktorët kryesor të uljes së frymës së nacionalitetit. *“Ekuilibri midis legjitimitetit dhe fuqisë është jashtëzakonisht kompleks; sa më e vogël të jetë hapësira gjeografike ku zbatohet ai dhe sa më koherente të jetë bindjet kulturore brenda tij, aq më e lehtë është të arrihet një konsensus i realizueshëm”*. (Kissinger, Henry, 2015:10). Diskutimi i shtetit mund të fillojë me përkufizimin e tij të famshëm të Max Weber, si agjenci brenda shoqërisë që mban monopolin e dhunës legjitime.

Monopoli i edukimit legjitim është tani më i rëndësishëm, më i qëndrueshëm, sesa monopoli i dhunës legjitime.

II.2. Nacionalizmi në shoqërinë multietnike

Nacionalizmi është në thelb, imponimi i përgjithshëm i një kulture të lartë në shoqëri, ku më parë kulturat e ulëta kishin marrë jetën e shumicës dhe në disa raste tërësinë e popullsisë. Kjo do të thotë se, përhapja e përgjithshme e idiomave të mbikëqyrura nga shkolla, të ndërmjetësuar nga shkolla, mbeten të kodifikuara për kërkesat e komunikimit të arsyeshëm burokratik dhe teknik. Për më tepër se kaq, sistemi botëror modern përbëhet nga shtetet kombëtare. Për këtë arsye, mosmarrëveshjet etnike dhe nacionaliste janë mjaft të rëndësishme për t'u trajtuar.

Mosmarrëveshjet rreth saj, krijojnë kërcënim për jetën njerëzore dhe shtetin, kundër unitetit kombëtar dhe integritetit të tij territorial.

Sot, në të gjithë botën jeta e miliarda njerëzve vuan nga dhuna dhe diskriminimi prej racizmit, fundamentalizmit fetar, diskriminimit etnik dhe kulturor. Në këtë studim do të analizojmë bazat e nacionalizmit, si pretekst për lindjen e konflikteve ndëretnike dhe do të përpiqemi të japim një vizion të ri rreth problemit të konfliktit etnik. Është krijimi i një shoqërie anonime dhe jopersonale, me individë të atomizuar të ndërsjelltë, të mbajtur së bashku mbi të gjitha nga një kulturë e përbashkët e këtij lloji, në vend të një strukture të mëparshme komplekse të grupeve lokale, të mbështetura nga kulturat popullore të riprodhuara në nivel lokal dhe idiosinkratik nga vetë mikro-grupet.

Studiues të shumtë i japin dimensione dhe sqarime kuptimplota çështjes në nacionalizmit, si një aspekt i teorive dhe praktikës politike. Në të gjithë botën, konfliktet nacionaliste dhe etnike po krijojnë shumë më tepër kaos nga dita në ditë. Sidomos, pas Luftës së Ftohtë numrat e konflikteve të armatosura vazhdojnë të rriten, dhe shumica e tyre janë të lidhura me racizmin, fenë fundamentaliste, ndikimin etnik dhe kulturor. Në fillim të vitit 1993, kanë ndodhur 48 luftra etnike në mbarë botën, kurse në ish Bashkimin Sovjetik janë shfaqur 164 *“mëtime territoriale – etnike, e konflikte lidhur me kufijtë”*, prej të cilave 30 janë shoqëruar me ndonjë formë të konfliktit të armatosur, si në rastin e fundit me Ukrainën.

Parimi i parë është me i rëndësishëm sepse thekson se, çdo individ ka të drejtë të barabartë në liritë themelore p.sh. Rawls beson se prona private, gjërat personale një shtëpi etj, përbëjnë një liri themelore, gjithashtu një të drejtë absolute të pakufizuar mbi pronën private. Nuk janë si liria themelore, por ato janë të patjetërsueshme. Asnjë qeveri nuk mund t'i ndryshojë, shkelë apo t'i konfiskojë ato nga individët.

Parimi i dytë i barazisë është komponent i drejtësisë, si paanësi për krijimin e drejtësisë, si shpërndarëse mbi pabarazitë sociale dhe ekonomike, që duhet të organizohen në mënyrë që ato të jenë *së pari*: për të mirën më të madhe të personave më pak të avancuar dhe *së dyti*: të bashkangjitura me zyra dhe në pozita të hapura për të gjithë, nën kushtet e barazisë së mundësive.

Dworkin ka dhënë gjithashtu kontribut të rëndësishëm në atë që quhet ndonjëherë debat mbi barazinë e çdokujt! Në librin e tij “*Virtuty i sovranit*”, ai mbështet në një teori që e quan “*barazia e burimeve*”. Kjo teori kombinon dy ide kryesore. Përgjithësisht *e para* është se qeniet janë përgjegjëse për zgjedhjet e jetës që ata bëjnë dhe *e dyta*, është se dhuntitë natyrore të inteligjencës dhe talentit janë moralisht arbitrare dhe nuk duhet të ndikojnë në shpërndarjen e burimeve në shoqëri. (Baliqi, 2017).

Ndarja mes sjelljes egalitarene, qëndrimet aktuale dhe shqetësimet shprehëse, zbatohen në rastet kur vendndodhja e barazisë relacionale merret të jetë marrëdhënia midis institucioneve dhe qytetarëve. Llogaria e Thomas Pogge përqendrohet në atë, se si institucionet i trajtojnë qytetarët. Gjithnjë sipas tij apo siç vëren ai, “*një shoqëri ose një shtet liberal duhet të trajtojë të gjithë qytetarët e saj në mënyrë të barabartë në aspektin e ndihmës dhe pengesave*” (Pogge 2004: 147). Ndërsa, llogaria e Schemmel në mënyrë të ngjashme, e konsideron se si institucionet trajtojnë qytetarët, ai gjithashtu mendon për barazinë relacionale, për sa i përket qëndrimeve që institucionet shprehin ndaj individëve (Schemmel 2012).

Studiues të ndryshëm, çështjen e barazisë në spektrin e qeverisjes apo politikbërjes, respektivisht të përgjegjësiqve që kanë për një trajtim të barabartë, qeveritë e shteteve të ndryshme i japin dhe e studiojnë në mënyrat nga më të ndryshmet. Theks të veçantë në drejtim të shpenzimeve dhe sferës racionale të shfrytëzimit të mjeteve publike, e bën një studim praktik, sipas Stiglicit dhe të tjerëve studiues.

Rol të veçantë në këtë këndvështrim duhet të ketë liderhipi i shoqërive, që kanë nevojë për një dimension më të real të parimit egalitar, të cilin duhet ta kenë si parim me prioritet në punën e tyre të përditshme, apo në përvojën e tyre të zakonshme. Sipas studiuesve egalitar, udhëheqësit – drejtues janë shpesh me diapazon më të gjerë, më të fortë, ose shfaqin sjellje më dominuese sesa bashkëmoshatarët e tyre, qoftë në shoqëri demokratike në shkallë të gjerë (Lord et al. 1986; Stulp et al. 2013), ose shoqërive të vogla si vende në proces të zhvillimit (Maybury-Leëis 1967) dhe vendeve që janë në një proces të mangët të civilizimit, (Werner 1982), ku lufta ishte një rrugë tradicionale drejt udhëheqjes. Sidoqoftë, udhëheqësit vizionar ose fizikisht të fortë, nuk janë të

zgjedhur domosdoshmërisht për dominimin e tyre fizik në vetëvete, veçanërisht në shoqëritë e barabarta, egalitare, ku sjellja autoritare çon në çensurë, largim ose madje përmbarim. (Boehm 1999).

Në shoqëritë më të barabarta, udhëheqësit që janë fizikisht dominues në aspektin e vizionit ose forcës, mund të jenë të dëshiruar, sepse ato përmirësojnë bashkëpunimin. Mbizotërimi fizik mund të zvogëlojë përpjekjet e kërkuara nga drejtuesit, për të tërhequr vëmendjen e përbashkët të anëtarëve të grupit, ose të koordinojë dënimin e defektorëve me më pak rrezik për hakmarrje dhe me efikasitet më të madh. (Von Rueden dhe Gurven 2012).

Sado që konteksti apo qasja teorike e kësaj mënyre trajtimi jep hapësirë për të menduar në mënyrë të ndryshme, që në fakt nënkupton trajtimin e barabartë të të qenurit pjesë e një shoqërie multietnike. Trajtim dhe barazi në aspektin juridik, politik dhe ekonomik edhe pse shembuj dhe sqarime apo qasjet shkencore, mund të jenë nga më të ndryshmet. E rëndësishme është të trajtojmë në esencë se, në fakt kujt i beson më tepër kjo qasje shkencore, gjithnjë duke u bazuar në shembujt e ndryshëm, prej të cilëve mund të nxjerrim argumente shumë të besueshme, të cilat mund të inkorporohen në mesin e shoqërive me nevojë të madhe të trajtimit të barabartë shoqëror.

Fillimisht egalitarizmi duhet të gjejë përkrahje nga aktorët politik, si gjenerues të vendimeve, për t'u zgjeruar më pas kjo qasje e barabartë në dimensione të gjera të shoqërisë, më pas në ato rajonale dhe trajtime egalitare të sferave të krijimeve të raporteve egalitare ndërshtetërore-ndërkombëtare, e pse jo në ato globale.

Përmasat e shoqërive që janë në proces të zhvillimit si kjo që funksionon në Maqedoninë e Veriut, do të duhet të paktën të kishin parasysh disa nga parimet themelore të qasjes teorike egalitare në procesin e politikbërjes, ku raporti ndëretnik shqiptaro - maqedonas do të ishte në një kahe dhe nivel shumë më të avancuar se ky që është sot.

KAPITULLI III

III.1. Konceptet themelore politike, llojet dhe karakteristikat e politikbërjes

Përpara se të trajtojmë çështje, të cilat i referohen një procesi praktik apo politikbërjes në një vend me karakter multietnik, ashtu siç është ky studim i orientuar, shumë më e arsyeshme është që në radhë të parë, të njohim trajtimin shkencor apo aspektin teorik dhe konceptin terminologjik, që i referohet kësaj tematike.

Janë të shumtë autorët dhe studiuesit, sidomos ata të huaj, që i qasen problemit rreth një çështje të njohur si **politikbërje**. Edhe pse në gjuhën shqipe nuk ka term tjetër më të përshtatshëm sesa ky që njeh terminologjia e huaj (*angleze*), **policymaking**, në gjuhën maqedone si term përdoret **politika**, në atë gjermane, **politik**, *në gjuhën frënge, l'élaboration des politiques* dhe në gjuhët skandinave përdoret si term , **politikkutforming** etj.

Sido që ky koncept politik apo term i shkencave politike, sqarohet në forma dhe kuptime të ndryshme, në fjalorin e Kembrixhit, kuptimi i tij më i gjerë është si vijon: “*anëtar i departamentit të qeverisë, legjislativit ose organizatës e cila është përgjegjëse për të vendosur rregulla, ligje*” etj. (Nga dokumenti origj. *Одлука за Методологијата за стратешко планирање и подготвување на Годишната програма за работа на Владата усвоена на 50-тата седница на Владата на Република Македонија одржана на 22.09.2003*)

Pra, nga ky këndvështrim nënkuptohet se procesi i politikbërjes është i lidhur ngushtë me aktet apo aktivitetet, të cilat ndërmerren nga aktorët e interesit publik, duke marrë në konsideratë interesin e qytetarit dhe menaxhimin e mjeteve të nevojshme që janë në arkën e buxhetit të shtetit.

Në këtë rast, njëri nga aktorët më të spikatur në këtë proces, pa mëdyshje është qeveria apo varësisht nga sistemi dhe forma e qeverisjes, organi i pushtetit shtetëror tek i cili është i koncentruar fuqia politike, ku në fakt në të shumtën e rasteve, praktika ka dëshmuar se promotor i realizimit të politikave publike është pushteti ekzekutiv, apo qeveria.

Nga praktikat më të shpeshta, sisteme më dominante në botë, kur flitet për procesin e politikbërjes dhe roleve e veçanta të organeve të pushtetit shtetëror, një rëndësi të jashtëzakonshme i kushtojnë qeverisë, duke e pasur në konsideratë faktin se, qeveria është një prej institucioneve bazë për marrjen e vendimeve dhe udhëheqjen me fondet publike. Siç po trajtohet teorikisht problemi, fakti që janë studiues apo hulumtues të huaj, sidomos ata të cilët e

njohin në esencë çështjen e termit politikbërje; në këto raste njihen edhe sqarime nga më të ndryshmet.

Fillimisht, do të ndalemi në disa segmente, të cilat janë qasje teorike nga njëri prej hulumtuesve më në zë në sferën e politikbërjes, studiues me ndikim, si kanadezi, Franc Carden, i cili në veprën e tij *“Knowledge to policy”*, në mes tjerash në studimin e tij ai thekson:

“Asnjë faktor i vetëm më i fuqishëm nuk mund të ndikojë në rrjedhën e zhvillimit të një vendi sesa cilësia e qeverisjes së tij. Aty ku qeverisja është e hapur, e përgjegjshme dhe efektive dhe ku politika publike promovon inovacionin dhe barazi në një ekonomi të gjallë, zhvillimi është më me gjasa të ju shërbej interesave të popullit. Informimi i qeverisjes së mirë e përshkruan këtë urgjente” (Carden, 2009:).

Qeveria, si një nga autoritetet apo mekanizëm i aktorëve ndikues qeverisës, me të drejtë studiuesit dhe hulumtimet paraprakisht veçojnë që, aktet e mëtejme nga të cilat varet i tërë procesi i politikbërjes, duhet të ndikohen edhe më shumë nga hulumtimet shkencore, të cilat duhet të merren si bazë nga një koncept shumë i rëndësishëm për vendimet e së ardhmes që qeveria ndërmerr.

Të gjitha arritjet në rrugën e hulumtimeve shkencore, janë pjesë e pandikuar nga rrethana të politikës ditore dhe të lidhura ngushtë me realitetin objektiv të praktikës së një vendi. Kë këto kushte, gjithnjë ato e më tepër duhet marrë në konsideratë për të çuar përpara procesin e një politikbërje cilësore. Siç është theksuar këtu, ky është një problem, sepse gjithnjë e më pak sugjerimet shkencore mbeten pjesë e implementimit praktik të një politikbërje të mirëfilltë.

Në kohën e sotme kjo është pjesë e përvojës së shpeshtë, por dhe e pasojave të kësaj pjese që pak i afrohet për t'i marrë në konsideratë hulumtimet shkencore; si arsye e vetme ka mundësi që të jetë fakti se:

Tendenca që të jetë një mungesë e komunikimit ndërmjet studiuesve dhe hartuesve të politikave me politikbërësit janë jo gjithmonë të informuar në lidhje me hulumtime të vazhdueshme dhe hulumtuesit shpesh nuk kanë njohuri për të parashtruar pyetje politike që ata do të duhet të bëjnë hulumtimet e tyre më të rëndësishme.

Për të shënuar disa çështje të tjera të rëndësishme në sferën e hulumtimeve shkencore, kontributet e tjera janë po aq të rëndësishme sa edhe ato të cilat janë theksuar më sipër. Kjo vlen të theksohet edhe sipas hulumtimeve të Radclif House and Warwick UK University, ku nga stusimi përcaktohen disa hapa të rëndësishëm në sferën e ndërtimit të një praktike pak më të qartë në çështjen e parimeve, në bazë të të cilave politikbërja si proces duhet të bazohet në ndërtimin dhe zbatimin e saj.

Janë disa pika ku hulumtimi në fjalë veçohen si pjesë e domosdoshme për një politikbërje efikase. Ato njihen si dinamikat e konceptimit të hulumtimit të politikave publike:

- Problemi mund të përkufizohet si një çështje e mallrave publike, tek i cili ka një përkufizim joadekuat të hulumtimeve përkatëse të politikave;
- Problemi mund të përkufizohet si një mungesë e qasjes tek të dhënat e hulumtimit shkencor; Analiza në mes hulumtuesve e politikbërësve dhe rekomandimet për përmirësimin e qasjeve dhe përhapjen e njohurive më poshtë;
- Mungesë dhe dobësi në kuptimin e politikave të studiuesve në drejtim të procesit të politikës nga aktorët e politikbërjes. Tejkalmi i hulumtimeve shkencore nga studiuesit në procesin e politikbërjes, tregon rëndësinë për të ndërtuar metodologji për vlerësimin e hulumtimeve shkencore.
- Mungesa e vazhdueshme e komunikimit në mes studiuesve, stimulon më shumë mungesën e aplikimit të strategjive të mirëfillta nga studiuesit, një pasojë kjo që në të kundërt parandalon vënien e urave të komunikimit në mes dy shtyllave të rëndësishme të politikbërjes.
- Problemi mund të definohet si ç'kyçje shoqërore e studiuesve në vendimmarrje dhe avancim i studimeve apo hulumtimeve të tyre, duke bërë të mundur kështu një zbatim më pak efektiv dhe të dëmtuar; Fokusi duhet të jetë i përqendruar në analizën dhe pjesëmarrjen e niveleve më rurale deri tek inkurajimi i rrugëve burokratike. Duke e njohur kështu në praktikë edhe si term *“Të kuptuarit publik të shkencës”*.
- Padija e politikanëve në raport me politikat kërkimore përkatëse, ose paaftësia e burokratëve për të arritur të kuptojnë hulumtimet shkencore apo t'i marrin në konsideratë ato, pjesëmarrja në seminare dhe konferenca shkencore, mund të sjell emërimin e tyre si specialist në komisione qeveritare;
- Problemi mund të përkufizohet si një mungesë e qasjes tek të dhënat e hulumtimit shkencor; që nënkupton analizat mes hulumtuesve dhe politikbërësve, rekomandimet për përmirësimin e qasjeve qeverisëse dhe përhapjen e njohurive më poshtë;

Është në natyrën e studiuesve të përcaktojnë se cila mund të jetë përkrahja ndaj aktorëve të qeverisjes për t'i mbështetur ata, sepse një mekanizëm më fleksibël rreth aspiratave që ata përcaktojnë për të dhënë sugjerimet e duhura rreth organizimit të pushtetit shtetëror, duhet të jetë

i paanshëm, duhet të jetë me argumente shumë bindëse dhe të mirëpërcaktuara si dhe të ketë një element përmbajtësor, që nuk do të ishte i ngjashëm me një pjesë të një strukture politike si pjesë e pushtetit.

Ndërlidhja e qasjes praktike deri tek aktorët e vendimmarrjes, mund të ketë një element shumë pozitiv për t'i dhënë një shpresë strukturave qeverisëse se aspekti i qëndrimeve shkencore dhe ndërlidhja me sferën praktike, mund të ndihmojë në ecjen e përmirësimit dhe menaxhimit me koncepte më profesionale në modelin e qeverisjes.

Sado që dilemat janë shumë të mëdha në drejtim të formës së bashkëveprimit të parimeve shkencore dhe implementimit të tyre, sidomos nëse bëhet një përzgjedhje e mirëfilltë e politikave, të cilat jo vetëm do të plotësojnë nevojat imanente të kohës, duke marrë në konsideratë rrethanat e një shteti, siç po ndodh në praktikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi çështjen e përfaqësimit të shoqërisë multietnike dhe përfshirjes së barabartë në procesin e politikbërjes.

Në pasqyrimin e aktiviteteve të realizuara deri tani, ka pak qasje të praktikave dhe hulumtimeve shkencore që koordinohen me aktorët e skenës së një strukture politike, për të implementuar rregullat e një trajtimi shkencor me ndikime pozitive në qasjen praktike.

Në këtë kontekst; për politikën e karakterit publik dhe zbatimin praktik të tyre, institucionet publike dhe organet përgjegjëse janë të dedikuara t'iu bashkëngjisin disa trajtave normative dhe akteve, të cilat do të bëjnë të mundur zbatimin korrekt dhe dhënien e detyrimeve në formë të kompetencave, definimit të tyre me trajta ligjore dhe akte administrative, duke ndikuar kështu tek nëpunësit dhe administrata shtetërore. Të tilla tendenca janë të njohura në hartimin e planeve dhe ushëzimeve që janë përpiluar nga pushteti ekzekutiv në praktikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku në mes tjerash njohim disa aspekte, të cilat dallohen si pjesë e rregullores së punës së organit qeveritar, duke qenë të vetëdijshëm se ky organ ka kompetencat themelore në drejtim të propozim – krijimit, apo të zbatimit praktik të politikave me ndikime publike.

Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore (RM), në mes tjerash në trajtat e punës që përkufizohen në drejtim të politikbërjes, thekson disa element të rëndësishme, të cilat do të doja t'i trajtojmë këtu me këtë rast:

Metodologjia e planifikimit strategjik dhe përgatitja e programës vjetore të punës së qeverisë, e definon procesin e verifikimit të prioriteteve strategjike të saj dhe siguron që të jenë ndarë mjete

adekuate për realizimin e prioriteteve strategjike, përmes procesit buxhetor të ndërlidhura me programën vjetore të punës së qeverisë.

Metodologjia e analizës dhe koordinimi i politikave, verifikon kapitujt kyç për krijimin e politikave dhe hapave në mëtejshme të çdo faze të krijimit të tyre.

Në aspektin e mëtejshmë të përmbajtjeve të tilla të dokumentuara në formë të akteve dhe përmbledhjeve udhëzuese, tani janë një varg i standardizuar dhe i konsideruar si pjesë e punës dhe përditshmërisë së procesit të qeverisjes dhe politikbërjes në RMV, sado që në kontekstin e kushteve praktike; ky volum shumë parimor dhe me qasje shumë ndikuese, lë shumë hapësirë për të dhënë një vlerësim të kundërt me atë që është shkruar.

Janë të njohura po ashtu dhe numërimi i të shtatë pikave me ndikime që njeh procesi i krijimit të politikave publike, që kërkon mbi të gjitha që qeveria në këtë proces të marrë në konsideratë këto hapa:

- Vlerësimin e nevojës për krijimin e politikave dhe tendencën e patjetërsueshme për të ndërmarrë hapa nga qeveria;
- Vlerësimin e zgjidhjeve të mundshme (*mundësive*);
- Vlerësimin e ndikimit dhe përlllogaritjen e harxhimeve për çdo zgjidhje të mundshme;
- Vlerësimin dhe përmirësimin e zgjedhjeve të mundshme;
- Zgjedhja e një alternative më të mirë dhe finalizimi i atij propozimi;
- Prezantimi i alternativës së zgjedhur, argumentimi dhe informimi;
- Sigurimi i zbatimit, ndjekja dhe vlerësimi i rezultateve.

Këto janë argumente të cilat në pikëpamje të ndërthurjes së rregullave të shkruara, zënë vend në një model të ri të vlerësimit të parimeve bazë të funksionimit të mirëfilltë, drejt një mirëqeverisje dhe formatit funksional qeverisës, i cili bazohet në element shumë të sofistikuar, shoqëri dhe vlerat e mirëfillta të demokracisë, të cilat janë të pranishme në vende të zhvilluara të Evropës dhe botës përgjithësisht.

Të bindur që këto element, sido që pamja qeverisëse herë më pak dhe herë më shumë do t'i vendosin në agjendat e planeve të tyre strategjike, sërish ato len hapësirë për të hasur herë - herë bindje dhe koncepte nga më të ndryshmet; sa është e vështirë dhe jo e lehtë që konceptet

themelore të një politikbërje të mirëfilltë të gjejnë vend në zbatimin praktik të një vendi në proces zhvillimi permanent dhe sa ai ndjek paraqitjen e sfidave të kohës drejt proceseve, të cilat janë pjesë e hapave të integriteteve evropiane.

III.2. Aktorët e politikbërjes

“Unë mendoj se njerëzit e përfshirë në politikë bëjnë aktorë të mirë. Veprimi dhe politika të dyja përfshijnë mashtrimin e njerëzve. Njerëzit pëlqejnë të mashtrohen nga aktorët. Kur të shkoni drejt asaj, ata ndoshta duan të mashtrohen nga politikanët edhe më shumë. Një aktor i aftë do t'ju bëjë të mendoni, por një politikan i zoti do t'ju bëjë kurrë të mos mendoni” Donna Brazile

Politika dhe politikbërja janë ato që një qeveri i thotë dhe njëkohësisht i realizon rreth problemeve të evidentuara të shoqërisë. Hartimi i politikave jep të kuptohet, se si qeveria vendos se çfarë do të bëhet për problemet madhore të shoqërisë. Politikbërja është një proces ndërveprimi midis autoriteteve qeveritare dhe joqeveritare; politika është rezultat i këtij ndërveprimi.

Në pjesën e përfshirjes jetike të procesit të politikbërjes, shpesh herë shtrohen dilemat dhe pyetjet se, kush janë aktorë të cilët përfshihen në këtë proces. Të tilla situata mund të gjejmë nga qasje dhe këndvështrime të ndryshme shkencore, të cilat detajojnë shumë çështje që i referohen një procesi të njohur si politikbërje dhe tek i cili përfshihen aktorë të rëndësishëm të interesit publik apo të pushtetit. Pyetjet e kësaj natyre që mund të lindin u drejtohen këtyre elementëve:

Kush përfshihet gjatë përgatitjes së një politike me karakter publik?

Parlamenti, i cili më vonë u bë baza institucionale për krijimin e një ligji kombëtar.

Presidenti dhe/ose Kryeministri: Në kontekstin e një sistemi politik demokratik, Presidenti ose Kryeministri janë individ të cilët shërbejnë si drejtues të organit ekzekutiv në vend.

Agjensitë Qeveritare: Përfaqësohen nga zyrtarët e qeverisë, të cilët janë të përfshirë në hartimin e politikave gjatë dekadës së fundit. Ndonjëherë propozohen agjenci të reja qeveritare, të paracaktuara për të përmirësuar ose lehtësuar mangësitë në legjislacionin ekzistues.

Grupet e interesit: Të veçantë janë koalicionet e njerëzve dhe organizatave të lidhura së bashku nga besimet e përbashkëta në vendimet e politikave. Duke punuar së bashku, këto grupe kanë aftësinë dhe fuqinë për të informuar dhe ndikuar në zhvillimin e politikës, nëpërmjet korrespondencave me ligjvënësit dhe stafet e tyre. Ndërsa shpesh mendojmë vetëm për anën

negative të grupeve të interesit të veçantë, ato gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në mbajtjen e informatave të politikanëve.

Procesi i politikave përfshin një seri të ndërlikuar të proceseve më të vogla. Në mënyrë të veçantë, kjo përfshin formulimin, zbatimin dhe vlerësimin. Si pasojë e ndërlikimeve të përfshira, aktorë të veçantë vendimtarë që luajnë rol në procesin e hartimit të politikave, (Anderson, 1979), i kategorizoi aktorët vendimtarë në procesin e bërjes së politikave në dy grupime: politikbërësit zyrtarë dhe jozyrtarë.

Dy kategoritë e pjesëmarrësve janë të përfshirë në një mënyrë ose në tjetrën, në politikë dhe në proces dhe ato janë vendimtare dhe me ndikim në nën - proceset e inicimit të politikave, zgjedhjeve, formulimit, zbatimin dhe vlerësimin. (Popola, 2016).

Shkencëtarët: veçanërisht ata që lidhen me çështjet e energjisë dhe mjedisit, komuniteti shkencor ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikës. Shkencëtarët dhe studiuesit janë thirrur të dëshmojnë në seancat e Kongresit lidhur me faturat e energjisë. Për sfidat mjedisore dhe energjetike, ligjvënësit duhet të mbështeten në komunitetin shkencor, për t'u dhënë atyre bazën për të cilën legjislacioni duhet të ekzistojë.

Në lidhje me politikën energjetike në mënyrë specifike, këtu janë vetëm disa nga çështjet në të cilat komuniteti shkencor i ofron mendimet e tyre ekspertëve tek politikbërësit: nivelet e pranueshme për kriteret e ndotësve të prodhuar gjatë nxjerrjes, përpunimit dhe djegies të lëndëve djegëse fosile, sasinë e rezervave të lëndës djegëse në dispozicion për nxjerrjen nivelet e sigurta të dyoksidit të karbonit dhe përqëndrimet e tjera të gazrave në atmosferë, pasojat e mundshme të një klime ngrohëse për shkak të përqendrimeve të gazrave në rritje rreziqet që lidhen me nxjerrjen e lëndëve djegëse, si fosile dhe çështjet që lidhen me infrastrukturën e nevojshme për teknologjitë e reja energjetike.

Qytetarët: Ata kanë një rol të rëndësishëm si aktorë në politikbërje. Është e rëndësishme jo vetëm që të jenë të informuar rreth çështjeve që ndikojnë në jetën e tyre, por që t'i shprehin preferencat për politikat e tyre ndaj zyrtarëve të zgjedhur. Politikanët duan të qëndrojnë në detyrë, dhe kjo do të thotë mbajtjen e zgjedhësve të tyre të lumtur. Të jesh një qytetar proaktiv dhe i angazhuar. Udhëheqja juaj duhet të dijë se po i kushton vëmendje dhe keni ide se si dhe çfarë duhet bërë. (Brandyy, 2018).

III.3. Fazat e politikbërjes

Në literaturën bashkëkohore janë të njohura fazat apo etapat e ndryshme, të cilat sot aplikohen në procesin e vendimmarrjes politike. Nuk ka dyshim se në këtë drejtim rolin kryesor e kanë institucionet e vendit dhe sistemi politik i aplikuar. Në studimet e kohës së fundit njihen aspekte dhe metoda të ndryshme shumë të avancuara profesionale, të cilat i vijnë në shërbim institucioneve drejtuese vendore për ta ndihmuar këtë proces.

Por, paraprakisht në kuadër të këtyre institucioneve, janë të angazhuar stafe të drejtimit administrativ, të cilët janë pjesë e domosdoshme e procesit të marrjes së vendimeve dhe dedikimit të objektivave programore të paracaktuara. Një proces i tillë sigurisht që kërkon një profesionalizëm, të mbështetur në vlera të mirëfillta të një edukate dhe përgatitje politike për t'i shërbyer interesit publik.

Kështu aspiratat dhe objektivat politkë e kanë të nevojëshme të administrohen sipas një strategjie në shërbim të objektivave dhe programeve të strukturuar vendimmarrëse. Në hartimin e politikave me ineteresa publike parashtrihen drejtimet kryesore, të cilat po i paraqesim në formën e pyetjeve:

- Cili është vizioni i aktorëve të politikbërjes?
- Kush janë aksionerët kryesorë në politikbërje?
- Çfarë rezultatesh kërkojnë aktorët e tjerë në bashkëpërgjegjësi (aksionerët)?
- Çfarë mekanizma, sistemi i zhvillimit dhe ndryshimeve sugjeron politika mbi vizionin?
- Cili është qëllimi i kësaj iniciative dhe çfarë përgatitje bëhen për t'i realizuar objektivat?
- Cilat janë parakushtet dhe kriteret bazë të cilat garantojnë suksesin?
- Çfarë jemi duke arritur në këtë metodologji suksemi?
- Kush duhet të marrë pjesë në projekt dhe çfarë kërkohet nga të tjerët si pjesë integrale e tij?
- Sa madhore janë këto vendimmarrje dhe silat janë pasojat e anashkalimeve programore dhe objektivave?
- Çfarë burimesh mbështetëse dhe të perspektivës janë në dispozicion të vendimmarrësve?

- Çfarë supozimesh parashtrohen dhe cilat janë kufizimet ligjore në vendimmarje?
- Cilat janë barrierat që kufizojnë suksesin?
- Cilat janë pasojat e mundshme dhe efektet anësore të synimeve drejt suksesit?
- Cilët janë faktorët që veprojnë në disavantazh të suksesit dhe çfarë problemesh shkaktojnë ato?
- Cili është probabiliteti i mundshëm i ndikimit të rreziqeve që kufizojnë suksesin?
- Çfarë duhet të bëjmë për të reduktuar mundësitë e ndikimeve negative?
- Çfarë marrëveshjesh të paparashikuara kemi nevojë në perspektivë?
- Çfarë është plani strategjik i realizimit të programit, objektivave dhe arritjes së suksesit?

Parashtrimi i këtyre pyetjeve, nuk janë gjë tjetër veçse një metodologji në fushën profesionale, të cilën studiues të ndryshëm e parashohin në mundësinë e veprimit në fushën e politikbërjes si proces. Nuk do ta vlerësojm si diçka shumë të rëndësishme radhitjen e tyre. Ndoshta për veçori të tjera edhe arsyet e përbashkëta të përvojave që ndajnë situatën në Maqedoninë e Veriut prej përvojës në Irlandën e Veriut apo edhe vende të tjera në kuadër të UE-së, në raport me konfliktet që shfaqen brenda shoqërisë, strategjia e veprimit ka specifikat e veta.

Në këtë kontekst, është me vlerë të përmenden disa çështje të aspekteve përmbajtjesore të planifikimit, apo fazave nëpër të cilat kalon krijimi i një politike, strategjie dhe planifikimi me karakter publik. Qeveritë fillimisht duhet të kenë një dokument bazë për hartimin e politikave, siç mund të jetë; Strategjia e qeverisë, tek e cila mbështet veprimtaria mbi bazën e propozimeve me prioritet në krijimin e politikave aktive, të cilat do të jenë shumë të rëndësishme në fushën e politikbërjes me karakter publik, që do të plotësojë në perspektivë nevojat e qytetarëve. (*Iniciativa kosovare për stabilitet, 2014*). Identifikimi i problemeve është pika fillestare në këtë proces. Ajo është platforma bazike që plotëson ciklin e masave dhe parashikimeve. Për të arritur një politikë të suksesshme publike, problemi duhet të përcaktohet qartë dhe të kuptohet në nga vendimmarrësit në shkallën e duhur.

Në shumë mënyra, ajo që përshkruhet në këtë paragraf si formulim i politikave, mund të jetë në të vërtetë diagrami ciklik, që përfaqëson një evolucion në mendim, se si mund të zbatohet një ide apo disa zgjidhje të problemeve që trajtohen, në mënyrë të pranueshme shoqërore dhe të pëlqyeshme nga ana politike prej qytetarëve.

Pjesa më e madhe e asaj që ne do të shqyrtojmë në këtë trajtesë, përqëndrohet rreth legjislacionit federal të SHBA, prandaj formulimi dhe adoptimi i politikave përfshijnë punë përsëritëse nga të dy Dhomat e Kongresit. Miratimi i politikës si një formalitet i rëndësishëm, arrin të përfaqësojë angazhimin e një entiteti qeverisës, për të zbatuar parimet bazë të politikave.

Ashtu si formulimi i politikave, zbatimi i tyre është gjithashtu një proces përsëritës dhe mund të përfshijë shumë palë të interesuara në të gjitha agjencitë dhe organet qeverisëse. Zbatimi i suksesshëm i një politike, do të varet jo vetëm nga aktorët që janë përgjegjës për zbatimin e saj, por edhe për mënyrën e hartimit gjatë fazës së identifikimit të problemeve dhe formulimit të politikave.

Vlerësimi i politikave është një ushtrim i rëndësishëm i ndërtimit të perspektivës, për të vlerësuar sukseset dhe dështimet e politikës, që do të informojë zhvillimin e politikave pasuese. Vlerësimi për nga natyra e tij, mund të jetë ose sasior ose cilësor, duke adresuar progresin drejt qëllimeve të prekshme, si dhe rezultatet e synuara dhe të padëshiruara sociale, ekonomike dhe mjedisore si rezultat i zbatimit të politikës. (Robbinon, 2018).

Këto dhe një sërë fazash, por me një nënndarje të një natyre shumë të përafërt, janë qasjet teorike të cilat njeh shkenca e studimet në këtë fushë. Sigurisht, që janë edhe një sërë formash të tjera, të cilat në konceptin e përgjithshëm të procesit të politikbërjes dhe fazave në bazë të të cilave kalon çdo proces i njohur si politikbërje, japin një pasqyrë reale, pa të cilën nuk mund të konsiderohet roli apo pesha që ka një proces politik.

KAPITULLI IV: Roli i qytetarit në politikbërje

IV.1. Roli i qytetarit, element kyç në procesin politik dhe demokratik

“Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë legjitime. Gjithkush ka të drejtë të barabartë për qasje në shërbimet publike në vendin e tij. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë” (Neni 21: Deklarata Universale për të drejtat e njeriut).

Të vetëdijshëm se demokracia e një vendi që ndërtohet në bazë të një shoqërie multietnike, me pjesëmarrje aktive të qytetarëve në jetën politike, realizohet përmes një forme të drejtpërdrejtë, apo edhe në mënyrë indirekte.

Në pjesën e parë të ndërtimit të rolit që ka shteti demokratik dhe roli i qytetarit në ndërtimin e kësaj forme të demokracisë, ku në mënyrë permanente ai e ndërton atë, është situata kur qytetarët i afrohen problemit me pjesëmarrje aktive, duke e njohur dhe pranuar formën e sistemit politik të vendit dhe u mundësohet ndikimi drejtpërdrejt në proceset vendimmarrëse të cilat janë të lidhura ngushtë me jetën e tyre në pikëpamje politike, ekonomike dhe sociale. Në këtë kontekst, roli i qytetarit është i një rëndësie të jashtëzakonshme.

Në rastin e dytë, është situata kur qytetarët janë të përfaqësuar realisht pranë institucioneve zbatuese shtetërore, të cilat përcjellin interesin e qytetarëve tek autoritetet e pushtetit të lartë shtetëror. Studiuesit këtë e trajtojnë si formë të demokracisë përmes përfaqësuesve në rastin e parë dhe në rastin e mësipërm, kemi ushtrimin e demokracisë së drejtpërdrejtë. Në rrethanat e koncepteve teorike, kuptimi i demokracisë mbetet një vlerë unike me të gjitha virtytet e saj, si element kyç për një shoqëri dhe shtet demokratik.

Studiuesit demokracinë e kuptojnë si tërësi vlerash demokratike, që nuk paraqesin një sistem ideal, pa kundërthënie, por një sistem që mundëson kushtet reale për pjesëmarrjen sa më të gjerë të njerëzve në ushtrimin e punëve publike dhe ndërtimin e politikave publike, që synojnë krijimin e një mirëqenie të përgjithshme.

Demokracia është sistem i qeverisjes që buron nga populli, funksionon me popullin dhe për popullin (Abraham Lincoln). Ky përkufizim i idealit bazohet në idenë e sovranitetit popullor, i cili siguron qeverisjen e drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet organeve përfaqësuese të popullit.

Ky koncept edhe pse përfaqëson konceptin burimor, nuk shpreh realitetin shoqëror i cili është përplot kundërthënie, konflikte interesash dhe pluralitetet e diversitetet shoqëror. Demokracia në

fakt nënkupton sistemin që përmbledh tërësinë e vlerave qytetëruese, të cilat sigurojnë mirëqenien individuale dhe publike, krijimin dhe funksionimin e politikave publike nga qytetarët përmes institucioneve demokratike.

Në doktrinat bashkëkohore politike, dominojnë qasjet realiste për demokracinë, të cilat lenë anash parimin e “*sovrانيتit popullor*” dhe në epiqendër vendosin qytetarin, emancipimin politik të tij dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në ndërtimin e politikave publike dhe zgjedhjen e organeve përfaqësuese.

Për të vijuar më tej, ndërveprimi mes rolit të qytetarit në zhvillimin dhe pjesëmarrjen demokratike brenda një shteti, brenda hulumtimeve shkencore të cilat i qasen kësaj problematike, dallojnë atributet themelore të funksionimit të demokracisë, të cilat veçojnë sistemin dhe rendin demokratik që presupozon ekzistimin dhe sigurimin e parakushteve, të cilat mundësojnë zhvillimin e marrëdhënieve demokratike. Atributet themelore të demokracisë janë:

- Sovraniteti popullor;
- Qeverisja e së drejtës, përkatësisht shteti ligjor;
- Ndarja dhe kufizimi i pushtetit shtetëror;
- Zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe pluraliste;
- Sigurimi dhe garantimi i të drejtave të qytetarëve;
- Pluralizmi politik dhe ekonomik;
- Përgjegjësia politike;
- Procedura demokratike e marrje së vendimeve;
- Kultura, transparencë dhe tolerancë politike.

Brenda vlerave të këtij sistemi të funksionimit të demokracisë, si pjesë e veçantë dhe si një faktor shumë i rëndësishëm, është pjesëmarrja e shoqërisë civile, e cila ka të bëjë me disa karakteristika të lidhura ngushtë me tiparet dhe konceptin themelor që ngërthen në vetëevetë shoqëria civile. Ky koncept nënkupton strukturat jo shtetërore dhe jo qeveritare, të cilat reflektojnë mendimin e lirë dhe të pavarur të qytetarëve, si dhe artikullimin programor të interesave të tyre në mënyrë të lirë.

Shoqëria civile në radhë të parë mbrohet individin, lirinë dhe të drejtën e tij, që jashtë strukturave politike të artikulojë interesat e grupeve të qytetarëve dhe në rrugë institucionale të angazhohen për realizimin e tyre. Por, cilat janë nivelet e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në jetën aktive dhe zhvillimit të demokracisë së një vendi?

Sipas një klasifikimi, të cilin e realizon edhe studimi i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), tre janë nivelet e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me sektorin civil apo për qytetarët. Sot, në rrethanat e pozitës aktuale që Maqedonia Veriore që njihet si një periudhë e zbatimit të procesit të rëndësishëm të reformave, ato janë futur në rrugën e aktiviteteve politike të realizuara paraprakisht, duke vlerësuar faktin se ato po përpiqen të japin një pasqyrë të domosdoshme për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e përhershme të qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme, të cilat janë të lidhura ngushtë me sferën e interesit publik.

Qytetari në një demokraci të avancuar, ka rolin kyç, por edhe ndikues në pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e jetës politike në një vend. Të shumta janë opinionet e studiuesve dhe aktorëve politik në këtë fushë, të cilët sugjerojnë se: Dominimi në një masë të theksuar i qeverisë në një vend, nuk është forma adekuate dhe e përshtatshme për një vend, por përkundrazi janë dhe shumë aktorë të rëndësishëm, që e bëjnë vitale apo që e jetësojnë zhvillimin e jetës politike në një vend.

Në RMV, ashtu si dhe në praktikën e shumicës së vendeve që janë në thellimin e proceseve të mëtejshme demokratike, nuk është e mjaftueshme që proceset e reformimit të vendit të mbeten vetëm brenda strukturave institucionale. Për këtë, procesin e ndërtimit të mëtejshëm të përmasave dhe zhvillimit të aktiviteteve për ndërtimin e kësaj shoqërie dhe shtetit në përgjithësi, në rrethanat bashkëkohore, këtë e stimulojnë më shumë pjesëmarrja e sektorit civil në politikbërje.

Sado që në fillimet e para të proceseve të reformave, gjërat nuk mund të shkonin aq lehtë sepse brenda shoqërisë si pasojë e sistemit të kaluar nuk ekziston sektori privat, periudha e monizmit nuk e favorizonte këtë sektor, duke i dhënë theks të veçantë atij publik, distancoi një përvojë që sot më shumë se kurrë zë vend në praktikën ndërkombëtare. Në të kundërt, nëse këto në procese do të angazhoheshin edhe qytetarët, ky do të ishte mekanizmi kyç për të çuar përpara modelin e shtetit demokratik të së drejtës. Në një shoqëri të tillë, prania e autoriteteve që do të realizonin kritikën ndaj pushtetit dhe funksionimit të tij në mbrojtje të interesave publike të qytetarëve, ka qenë e kufizuar.

Teoria dhe praktika e administratës publike dhe pjesa e ekspertëve të specializuar të politikave publike, janë gjithnjë e më të shqetësuar për mungësën e vendosjes së rolit të qytetarit në qendër të konsideratave të politikbërësve, jo vetëm si objekt, por edhe si agent. Qëllimi është të zhvillohen politika dhe shërbime të projektimit që i përgjigjen nevojave të individëve dhe janë të rëndësishme për rrethanat e tyre. Konceptet e tilla "*bashkë-krijim*" dhe "*bashkë-prodhim*", kanë dal për të përshkruar këtë ndjekje sistematike të bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, komuniteteve dhe qytetarëve të thjeshtë.

Në një rast dhe shembull praktik, raporti i qeverisë australiane Përpara Game-it - projekti 2010 për reformën e Shërbimit Publik Australian në mes tjerash veçon; Një qasje e tillë e respekton parimin themelor të një shteti demokratik - se fuqia duhet të ushtrohet përmes dhe të banojë me qytetarët e saj. (Game-it - projekti 2010). Në shumë vende në demokraci, pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e politikave dhe projektimit të shërbimeve, është debatuar shumë, por rrallë mund të realizohet sipas këtyre kërkesave. Mbi këtë përvojë, ka pasur arritje të dukshme, veçanërisht në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, duke sjell në vëmendje një literaturë të gjerë publike mbi politikën që mbështen në bashkëpunimin gjithëpërfshirës.

Angazhimi i vërtetë në "*bashkëprodhimin*" e politikave dhe shërbimeve publike, kërkon transformime të mëdha në kulturën e përgjithëshme dhe operacionet profesionale të agjencive qeveritare. Ajo kërkon nga shërbyesit publik aftësi të reja si mundësues, negociatorë dhe bashkëpunëtorë. Ajo kërkon nga qytetarët një orientim të emancipuar për të mirën publike, një vullnet për t'u angazhuar në mënyrë aktive, dhe aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në përmirësimin e diskutimeve për interesat e tyre.

Këto janë kërkesa të larta, veçanërisht nëse qytetarët janë të çliruar nga paragjykimet dhe interesat e ngushta dhe grupe të caktuara brenda popullsisë janë të respektuar. Veçanërisht, angazhimi efektiv nga një shërbim publik qendror i qytetarëve, kërkon vullnet dhe mbështetje politike për decentralizimin e vërtetë të pushtetit dhe të vendimmarrjes në frontin e nëpunësve dhe profesionistëve publik, të qytetarëve dhe palëve të interesit me të cilët ata angazhohen.

Ministrat dhe krerët e agjencive kanë një përgjegjësi të madhe drejtuese. (Holmes, 2011). Ka shumë shembuj të komunave, rretheve shkollore dhe grupeve qytetare që "*promovojnë*" pozicionet e tyre të paracaktuara nën maskën e "*angazhimit publik*", por ngjarjet aktuale dhe bisedat e fundit me liderët lokal në Kaliforni tregojnë se po lëvizim në një periudhë unike në qeverisjen komunale - një në të cilën zyrtarët në distriktin e qytetit dhe të shkollës rreth shtetit po angazhojnë proaktivisht banorët e tyre në politikbërje. Shumica e arsyeve të ofruara për këtë

ndryshim përshtaten në tre tema kryesore. E para është teknologjike. Rritja e internetit si mjet komunikimi dhe hulumtimi ka ndryshuar plotësisht marrëdhënien midis udhëheqësve tanë politikë dhe qytetarëve. Në librin e tij më të shitur "*Këtu vjen gjithkush*", autori, Clay Shirky, deklaron:

"Ne jemi duke jetuar në mes të rritjes më të madhe të aftësive shprehëse në historinë e racës njerëzore. Ka qenë ndonjëherë e mundur në të kaluarën. " Përmes këtij sistemi, çdo qytetar ka një qasje dhe mund të transmetojë çështjet e tij ose saj tek qeveria lokale ose sistemi shkollor. Nëpërmjet faqeve të rrjeteve sociale si Facebook, MySpace dhe të tjerët, qytetarët po organizohen më lehtë se kurrë më parë.

Nëpërmjet fushatave të email-it, qytetarët mund t'u dërgojnë zyrtarëve lokal me qindra (*madje edhe me mijëra*) mesazhe. Ndërsa këto mund të jenë pasuri e jashtëzakonshme për qytetarët për të shprehur mendimin e tyre, platforma të tilla nuk janë transparente dhe mund të mos jenë të përfaqësuar.

Në një sfidë ende pa përgjigje për themeluesit e kombit tonë, përkufizimi i "*fraksioneve*", është duke u ndryshuar rrënjësisht. E shkuar është koha kur natyra përfaqësuese e një organizate, mund të përcaktohet nëpërmjet anëtarësisë së saj ose përfaqësuesve të saj të mbledhur. Përfshirja në procese të këtilla e njerëzve, të cilët kanë dhënë kontribute me një numër të madh, do të verifikohet dhe vlerësohet nga masa (Devenporte Institute, 2018).

Trajtimi i përvojës qytetare të jetës amerikane është një shembull, që nënkupton një praktikë më të avancuar të një shteti që ka një nivel të lartë të demokratizimit të mirëfilltë të shoqërisë, ku domosdoshmërisht qytetarët kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën publike dhe vendimet e rëndësishme për jetën dhe përditshmërinë e tyre.

Duke iu referuar përvojave të studiuesve dhe referimit të raporteve periodike të autoriteteve me ndikim, në bazë të një raporti të Bankës Botërore, termi "*shoqëri civile* ", i referohen një grupi të gjerë organizatash joqeveritare, vullnetare dhe jofitimprurëse të prezentuara në jetën publike dhe që kryejnë një gamë të gjerë aktiviteteve për të shtuar vlerat dhe për të përmbushur interesat e anëtarëve të tyre dhe më gjerë, bazuar në parime etike, kulturore, politike, shkencore, fetare apo filantropike (World Bank Review, 2016).

Në përvojën e RMV, ky format strukturor dhe kjo procedurë janë të rregulluara me bazë ligjore dhe norma juridike. Këtu bën pjesë edhe miratimi i ligjit "*Për Shoqata dhe Fondazione*". Në përmbajtjen e aktiviteteve të iniciativave që realizohen nga shoqatat, ato marrin përsipër sugjerimet që duhen dhënë autoriteteve të pushtetit shtetëror rreth krijimit të politikave me karakter publik.

Sugjerimet që marrin formën e kapaciteteve të organizuara jashtë strukturave qeveritare, shpesh herë janë një model pozitiv, të cilin jo çdo herë merret në konsideratë nga autoritetet e qeverisjes apo aktorët me ndikim në sferën e politikbërjes. Në shumicën e rasteve, porositë që dalin prej prioritetëve të autoriteteve joqeveritare, ato mbështeten në konsensusin e subjekteve politike të prioritetëve të integritetit në Unionin Evropian:

Disa prej tyre: Potencialet integruese të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në plan të parë; Sundimi i së drejtës dhe barazia e plotë e çdo subjekti përpara ligjit; Parlament të fortë dhe qeveri të përgjegjshme; Administratë profesionale për anëtarësim në Unionin Evropian; Politikë e zhvillimit kombëtar dhe politikë sociale në harmoni me politikat e BE; Shfrytëzimin e fondeve paraprake në përkrahje të zhvillimit të politikave sociale; Kultura dhe dialogu me BE dhe bashkëpunimi rajonal etj.

Këto janë disa nga prioritetet, të cilat radhiten si pjesë e detyrimeve që dalin nga autoritete jashtë strukturave qeverisëse, por në formë të shoqatave të cilat venë në plan të parë anëtarësim e RMV në BE. Në vijimësi pretendohet që këto pika bashkëpunimi të jenë elementët kryesorë të autoriteteve të politikave të brendshme e të jashtme. Sido që flitet për këto forma të rekomanduese, në shtetin maqedonas nuk ka përvoja pozitive, ndosnjëhere edhe kundërshtuese nga përfaqësues tipikë të autoritetit shtetëror, të cilët shpesh abuzojnë me to. Kjo është praktika e jetës së qytetarëve në RMV.

Në diskutimet e fundit dhe në format e hulumtimeve të instituteve që merren me çështje të zhvillimit dhe të demokracive të vendeve në zhvillim, sipas hulumtimeve të Transparency International, del qartë fakti se përveç kontaktit me pushtetin lokal, qytetarët e RMV rrallë tentojnë që në mënyrë individuale, të zgjedhin problemet nëpërmjet kontaktit me institucionet.

Në periudhën që nga viti 2012 deri në vitin 2016, për zgjidhjen e problemeve shoqërore, sipas raporteve zyrtare të hulumtimeve të bëra po nga këto qendra, mesatarisht ata kontaktojnë 1 në 5 qytetar. Me deputetët kontaktojnë më pak se 10% e qytetarëve, ndërsa me përfaqësuesit qeveritar, gjegjësisht ministra, mesatarisht kontaktojnë më pak se 5% e të gjithë qytetarëve. Me interes është të theksohet se për zgjidhje të problemeve të caktuara shoqërore, ka më shumë mundësi që qytetarët të kontaktojnë me përfaqësues të partive politike sesa përfaqësuesit e zgjedhur.

Nga aspekti i aktiviteteve, në periudhën që nga viti 2012 deri në vitin 2014, vlerat më pozitive paraqiten në pjesëmarrjen dhe kontaktet për diskutime publike për problemet lokale. Pjesëmarrja

mesatare në këto aktivitete arrin në 16,3% e qytetarëve. Në vitin 2015 dhe 2016 përqindja e qytetarëve që pohuan se kanë marrë pjesë në protesta, demonstrata publike dhe mbledhje publike është më e lartë, deri në 20,9% e të anketuarve në vitin 2015 dhe rreth 17,7% në vitin 2016.

Këto rezultate janë reflektim konsistent i ngjarjeve shoqërore në dy vitet e kaluara, kur në RMV ndodhën protesta masive brenda vendit. Pjesëmarrja në protesta që shfaqnin shenja armiqësore, vulgaritet (*protesta dhe nënshkrim i peticioneve*) përjetuan rritje të dukshme në vitin 2015, kur në mënyrë konstatohet rënia e pjesëmarrjes në protesta dhe vendosja e kontakt – procesit nëpërmjet komunikimit me institucionet publike, (*Pushteti lokal, deputetët dhe përfaqësuesit e qeverisë*), apo partitë politike dhe pjesëmarrja në aktivitetet konstruktive, i cili i referohet angazhimit në diskutime grupe apo publike, apo me dorëzimin e propozimeve dhe ankesave deri tek institucionet publike (Civil engagement review, 2016).

Të gjitha këto, flasin për pamjen aktuale me të cilin shoqëritë në zhvillim si në shtetin maqedonas, janë të njohura me këtë praktikë. Sipas analizave të realizuara në këtë periudhë, në komunitet shfaqen tendenca të tilla, të cilat shprehin dëshirën qytetare për të marrë pjesë aktive në ndryshimin e gjendjes politike, sociale dhe ekonomike përmes formave dhe inismave të kësaj natyre, që flasin qartë për procesin e marrjes në dorë të akteve në jetën publike nga ana e qytetarëve.

Duke iu përmbajtur temës së politikbërjes, do të ishte në interes të shkëpusim pjesë nga anketa që ka realizuar Transparency Internacional në RMV, rreth çështjes se, “*a janë të interesuar qytetarët të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në vendin ku bëjnë pjesë*”? sipas rezultateve, rezulton që; dëshira për inkuadrim në vendimet që miratohen në pushtetin lokal është e madhe dhe ajo rezulton tek kategoria e personave që kanë nivel të shkollimit të lartë, kurse pjesa tjetër diktohet nga dilema mbi pasigurinë për t’u marrë në konsideratë çështjet për të cilat duhet të vendoset. Mbi shprehjen e vullnetit për përfshirje më të madhe, në periudhën nga 2012 në 2016, statistikat nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.

Analizat socio-demografike ***tregojnë se tek më të arsimuarit kanë më shumë mundësi për të shprehur një preference për përfshirje më të madhe, në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha vitet e studimit.*** Kështu, nga anketimet në vitin 2016, 79,72% e qytetarëve me arsim të lartë, u shprehën për një përfshirje më të madhe, ndërsa 65.32% e qytetarëve me arsim të mesëm shprehën po të njëjtën dëshirë. Vetëm 55.47% e qytetarëve të tjerë shprehën po këtë dëshirë. Këto të dhëna mund të ndikonin që përmes formave të organizimit publik dhe nxitjes së qytetarëve, t’i bëjnë ata të organizohen të pjesëmarrjen e tyre më të gjerë në jetën publike.

IV.2. Informimi

Me informimin do të kuptojmë një marrëdhënie të njëanshme, me anë të së cilës qeveria prodhon dhe shpërndan informacion të vlefshëm për t'u përdorur nga qytetarët. Këtu përfshihet akses i "pasiv" në informacion, si rrjedhojë e kërkesës së qytetarëve, ashtu edhe masat "aktive" të qeverisë për të shpërndarë informacion tek qytetarët. (Edes. W. Bart. 2008).

Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve, ky aspekt i përcaktuar parimor i njohur si Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve, ka për qëllim të shërbejë *si model* për përdorimin e pjesëmarrjes së qytetarëve; *si qasje* që kontribuon që pushtetet lokale të jenë më efektive në angazhimin e qytetarëve; *si hapësirë* për qytetarët që ata të japin kontributin e tyre dhe të bëjnë nisma nga baza në nivel lokal që do të çonte në shtimin e vullnetarizmit dhe qytetarisë së mirë; *si model partneriteti* që krijon konceptin lokal të pjesëmarrjes së qytetarëve, që mund të përdoret për të kombinuar përpjekjet e përbashkëta të pushtetit lokal dhe qytetarëve për arritjen e qëllimeve të tyre të përbashkëta.

Strategjia e politikbërjes është një proces zhvillimi edhe i strategjisë për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve, proces i cili kërkon:

- Ekipin kryesor të përkushtuar: që ka njohuri si për kontekstin lokal ashtu edhe për zhvillim të planit të veprimit; i cili do të paraqesë kornizën kohore, aktivitetet dhe personat përgjegjës për zbatimin e atyre aktiviteteve.
- Plani i veprimit do t'i mundësojë ekipit që ta masë përparimin e tij dhe ta mbajë përqëndrimin në detyrat e rëndësishme. Njohuri të gjendjes aktuale: që të dihen praktikatat aktuale të informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në nivel lokal.
- Dokumentimi i praktikave të tilla mund të arrihet përmes bërjes së analizave SWOT, përmes hulumtimit të të dhënave në dispozicion apo intervistave dhe anketave me qytetarët/grupet tjera. (Strategji për informim, komunikim për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, 2016.2018).

IV.3. Konsultimi

Në marrëdhënien e dyanshme në të cilën qytetarët ofrojnë sugjerime për qeverinë, si mund të ndodh dhe të zhvillohet kjo praktikë? Ajo bazohet në një përcaktim paraprak nga qeveria mbi çështjen për të cilën kërkohen, pikëpamjet apo sugjerimet e qytetarëve dhe kërkon ofrim informacioni.

Është procesi i një marrëdhënie të bazuar në partneritetin me qeverinë, në të cilën qytetarët angazhohen aktivisht në proceset politikbërëse. Kjo ua njeh qytetarëve rolin për të dhënë mendime mbi politikën dhe hartimin e dialogut për këto politika, megjithëse përgjegjësia për formulim apo vendim final të politikës i mbetet qeverisë. Ky raport sot, ngritët në nivel ekspertësh dhe rrolin kyç në këtë proces e marrin këshilltarët.

Kjo praktikë ndodh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të zhvilluara në Evropë, ku si vende më traditë institucionale, ata kanë hedhur hapa serioz drejt krijimit të një institucioni në nivel ekspertësh, të cilët konsultohen gjithnjë për të marrë në duar apo për t'i marrë në konsideratë praktikën më të mirë, qeveritë e shteteve, por me një orientim ekspertësh.

Gjithnjë duke u bazuar në nivel të analizave dhe qasjes së ekspertëve, konsulenti i politikave publike është një ekspert i politikës publike dhe evokimit në emër të organizatës së tyre. Konsulenti i politikave publike mund të punojë ose për një agjenci qeveritare ose organizatë jofitimprurëse. Ato veprojnë si një ndërlidhje ndërmjet publikut, zyrtarëve të zgjedhur, vullnetarëve, partnerëve të komunitetit, avokatëve dhe organizimit të tyre. Konsulenti i politikave publike do të punojë si një nga organizatorët kryesorë për iniciativat e politikave publike dhe iniciativat për shtrirjen e komunitetit.

Si pjesë e përgjegjësisë së tyre udhëheqëse organizative, ata do të duhet të mbajnë krah për krah me legjislacionin në pritje që ndikon në programet dhe mandatet e agjencisë së tyre. Ata do të pritët të kryejnë kërkime në lidhje me programet e agjencive të tyre dhe ndikimin e saj në komunitet. Ata pritët të punojnë në ruajtjen dhe zgjerimin e partneriteteve të tyre strategjike në qeveri, në komunitet dhe në organizata relevante. Ata gjithashtu do të trajnojnë dhe mbikëqyrin praktikantët dhe vullnetarët brenda degës së politikës publike të agjencisë së tyre.

IV.4. Përfshirja e aktorëve të rëndësishëm në procesin e një politike publike

Janë të shumta sugjerimet të cilat i dedikohen një procesi të njohur si politikbërje dhe përfshirjes së aktorëve të rëndësishëm, që do të stimulonin vendime të mirëfillta dhe me interes madhor mbi veprimtarinë publike. Në mes të tjerash këto porosi nënkuptojnë disa aktivitete, ku me rëndësi shfaqet pjesëmarrja në takime të komunitetit dhe avokimi në emër të agjencisë së tyre. Vëmendja do të fokusohet në:

- Monitorimin e ligjeve në pritje, që kanë të bëjnë me organizimin e tyre.

- Formimin e aleancave strategjike me komunitetin përkatës dhe agjencitë jofitimprurëse.
- Konsulenti i politikave publike punon si person kryesor në një organizatë, për të formësuar politikat publike rreth organizatave të tyre të deklaruara.

Kjo mënyrë synon të jetë në vëmendjen kryesore në një komunitet të caktuar, ose për shkaqe të tilla si, mungësa e strehimit apo mjedisit (*vendor, kombëtar ose ndërkombëtar*), të marrë në konsideratë nga konsulentët e politikave publike. Objekti ipunës së tyre mund të jetë:

- Konsulenti i politikave publike ka ndikim të jashtëzakonshëm në komunitetin qytetar dhe në njerëzit brenda tij. Duke ndihmuar në edukimin e publikut, në punën me partnerët publikë e privatë dhe qeverinë, ata ndihmojnë në formimin e debatit dhe në fund të fundit, të legjislacionit që ndikon në përmirësimin e situatës në komunitetin e tyre.
- Konsulenti i politikave publike mund të ndikojë tek qytetarët në mënyra të ndryshme si: Rritja e vetëdijes publike për një çështje, ndryshimi i perceptimit të publikut, ndihma për të krijuar legjislacionin, përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët, ndikim në nivelin individual.
- Konsulenti i politikave publike punon në ndryshimet e nivelit makro që i japin formë ligjeve të shoqërisë. Si e tillë, ndikimi i tyre tek individit depërton poshtë nga një nivel politikash që mund të ndikojnë dramatikisht jetën e përditshme të individit. Për shembull, një konsulent i politikave publike që mbron të drejtat e të pastrehëve pa qëllim fitimi, mund të ndihmojë në ndalimin e legjislacionit që kriminalizon të pastrehet. Kjo ka ndikim të madh në jetën e tyre, të cilët përndryshe mund të burgosen nëse ligji miratohet. (Rosly, 2013).
- Konsulenti i Politikës Publike ndikon në familje, duke ndryshuar natyrën e debatit shoqëror. Një shembull mund të jetë një i tillë që punon në një grup për mbrojtjen e prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta. Duke ndihmuar në nxjerrjen e legjislacionit që krijon fonde për kujdesin ndaj prindërve të këtyre fëmijëve, kur ka nevojë për kujdes shëndetësor apo për të pasur një fëmijë të shëndetshëm. Ndikimi i kësaj përkrahje ka shumë vlera.
- Edukimi që ata realizojnë për t'u bashkuar me fuqinë punëtore të kështillimit të politikave publike. Shumica e punëdhënësve kërkojnë kandidatë për konsulentë të politikave publike me diplomë “*Master*” në Politikën Publike, Administratë Publike, Marrëdhënie Qeveritare, ose në një fushë të ngjashme. Gjithashtu ata synojnë individë me njohje dy-gjuhësore ose shumë-gjuhësore.

Nga ky aspekt kuptojmë jo vetëm anën profesionale që studiues të ndryshëm mund të kishin përshtatur në një qasje teorike, siç janë sjell element të detajuara këtu, por del në sipërfaqe edhe gatishmëria e një përvoje, e cila duhet që të jetë sa profesionale, po aq e mundur për t'i dhënë një mesazh një shoqërie, e cila ka nevojë për instruksionet e duhura.

KAPITULLI V

V.1. Përfaqësimi etnik dhe pozita e shqiptarëve në RMV

Në pjesën e studimeve dhe analizave bashkëkohore të qasjeve akademike dhe jo vetëm kaq; sidomos tek vendet e Ballkanit, sot po zënë vendin më të madh të studimeve çështja e hapjes së konflikteve, të cilat kanë për bazë raportin ndëretnik (Kok-Kheong Yeoh, 2016). Tek kjo pjesë po ndalemi dhe i referohemi aspektit të përfshirjes në përfshirjen institucionale në baza etnike, respektivisht, përfshirjes së shqiptarëve si etnitet i dytë, pas maqedonasve në Maqedoninë e Veriut.

Raporti në mes shqiptarëve dhe maqedonasve gjithnjë ka qenë çështja që ka çuar në lëvizjen e proceset politike përpara në RMV. Sido që ka pasur probleme të natyrave të ndryshme, sot mund të thuhet se proceset kanë lëvizur më shumë përpara. Bazuar në praktikën e deritanishme të procesit të gjithëmbarshtëm të përvojës politike në RMV, ajo është shoqëruar nga kriza politike të vazhdueshme, të cilat erdhën si rezultat i mospërmblidhjes së detyrimeve të njëpasnjëshme të shtetit dhe pushtetit politik, dhe të mosgatishmërisë për vullnet politik, që do t'i përmbushte kërkesat për përfshirje të barabartë të shqiptarëve brenda sistemit shtetëror, si etniteti i dytë më i madh në shtetin maqedonas.

Në këtë situatë, pos mungesës së përfshirjes në përbërjes e sistemit juridik kushtetues si popull i barabartë shtet-formues me maqedonasit; në një rast të tillë, një qasje e një politike të diferencuar reflekton edhe tek mungesa e një përfaqësimi në institucionet shtetërore ligjzbatuese brenda strukturave të organeve administrative. Pas konfliktit të viti 2001 me (MO) Marrëveshjen Kornizë të Ohrit u përcaktuan qartë çështjet, të cilat duhesh të kishin qenë pjesë e rregullimit etnik brenda sistemit juridik të vendit dhe përcaktimin qartë të pozitës së shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Rrjedhimisht, situata nuk u zhvillua siç pritej, si pasojë e rrethanave të njohura për opinionin, si mungesë e theksuar e aktorëve politik, të cilët për një kohë të gjatë kishin uzurpuar pushtetin. Në pjesën e mëposhtme të studimit, do të parashtrohen disa të dhëna statistikore, të cilat u publikuan pas krizës politike që u shfaq në RMV, në vitin 2016. Kjo periudhë shquhet si faza, e cila mbledhi sërish faktorin ndërkombëtar për t'iu rikthyer edhe njëherë çështjes së zhvillimit të proceseve për të cilat po këta aktorë ndërkombëtar ndërhyjnë për t'i zgjidhur në konfliktin ndëretnik.

Pamvarësisht spektrit politik që ka drejtuar vendin dhe analizave të detajuara mbi përfaqësimin etnik, në këtë fushë kanë munguar shumë qasje studimore në RMV, si pasojë e mbingarkesave të institucioneve me karakter publik, të cilat shumë çështje të sferës publike nuk i deklarohin hapur. Këtu bën pjesë edhe ky element, sa shqiptarët kanë qenë etnikisht të përfaqësuar në sektorin publik dhe vendet me ngjajshmëri të institucioneve shtetërore.

Shumë analiza dhe forma anketash, vetëm viteve të fundit janë bërë publike. Nga të dhënat e Ministrisë së Administrimit Publik dhe shoqërisë së informatikës, janë këto të dhëna relevante në sektorët përgjegjës, ku shqiptarët bëjnë pjesë nga 110. 311 të punësuar gjithsej që ka sot struktura shtetërore në Maqedoninë e Veriut:

Tabela nr. 1. Përkatësia etnike e të punësuarve në institucionet shtetërore.

Përkatësia e bashkësisë	Të punësuar	Përqindja
Maqedonas	82,900	75.15%
Shqiptar	21,279	19.29%
Turq	1,781	1.61%
Serb	1,272	1.15%
Rom	1,215	1.10%
Boshnjak	479	0.43%
Vlleh	478	0.43%
Të tjerë	907	0.82%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Në këtë tabelë, janë të dhëna të cilat reflektojnë mbi përfaqësimin e përgjithshëm, si etnitete që bëjnë pjesë në shoqërinë e vendit, përfshirë këtu maqedonase, shqiptarët, turqit, serbët, romët, boshnjakët dhe vllehtë. Radhitja është bërë në vlerësimin numerik në përqindje punësimi sipas publikimeve të autoriteteve të vendit. Në vështrimin e përgjithshëm gati 7 etnitete përfshijnë vetëm 24.9% të përfaqësimit, kur të gjithë këto të marra sëbashku përbëjnë më shumë se

gjysmën e popullsisë në RMV. Raporti i përfaqësimit 1:3 të të punësuarve në favor të etnisë maqedonase është shumë diskriminues.

Në pjesën e mëposhtme të të dhënave të tjera statistikore, evidentohen detaje të tjera, të cilat janë më specifike, duke depërtuar edhe në llojet e institucioneve. Sjellja e statistikave në veprimin e tyre vertikal brenda piramidës së institucioneve shtetërore, sjell përfundime interesante. Në tabelën në vijim, (*tabela nr. 2*), paraqitet situata në organet më të rëndësishme të pushtetit, përfshirë presidencën, parlamentin, pjesë të pushtetit gjyqësor, sekretariate të qeverisë, zyrës së Avokatit të Popullit, duke mos anashkaluar pushtetin gjyqësor dhe bankën kombëtare, etj.

Ajo që bie në sy tek të dhënat statistikore është fakti që, tek autoritetet e pushtetit shtetëror, përfaqësimi etnik i detyruar sipas sistemit juridiko-kushtetues, përfshirë shqiptarët si etnitet shumicë pas maqedonasve në RMV, ata janë të përfaqësuar në përqindje simbolike. Në raport me maqedonasit, që janë 85.71%, shqiptarët si etnitet i dytë janë vetëm 7.14%, ku etnitete e tjera nuk e kalojnë prapen 3% të përfaqësimit në institucione.

Përqindja më e vogël tek këto dikastere është tek Banka Kombëtare, pjesë kjo tek e cila shqiptarët arrijnë të përfaqësohen vetëm 7%, përballë 89.68% të përfaqësimit maqedonas. E njeta situatë shfaqet edhe për zyrat në qeveri, përveç sekretariateve, të cilat arrijnë nivele simbolike të përfaqësimit, deri në 4.72%, përballë 91.08% të përfaqësimit të palës maqedonase.

Disa raste meritojnë t'i nënshtrohen analizës, kur është fjala për sistemin e gjyqësisë; ku theksohet pjesa e përfaqësimit tek gjykata kushtetuese, një organ shumë i rëndësishëm tek i cili asnjëherë nuk është menduar më parë që të jenë të përfshirë të tjerë pjesëtarë, të cilët në fjalorin e gjuhës së RMV vlerësohen si etnitetet jomaqedonas, por konsiderohen - të tjerë, pa specifikuar saktësisht për cilin etnitet bëhet fjalë.

Në Gjykatën Kushtetuese, si një prej organeve të rëndësishme brenda sistemit të Drejtësisë, në këtë periudhë përfaqësimi etnik shkon në 4.35%, ku në masën 91.30% përfaqësohen nga etnia maqedonase. Sipas të dhënave të tabelës nr. 2, përfaqësimi mesatarisht i palës maqedonase është 71%, i shqiptarëve 21% dhe vetëm 8% etnitë e tjera.

Në raportet e përgjithëshme 1:5, i vetmi organizëm ku shqiptarët janë shumicë, janë sekretariatet e ministrive me burokratë deri në 86.67%. Raportet 1:20 në institucionet qendrore, shprehin skajshmërisht mangësitë e theksuara në politikbërje, e cila në mënyrë të hapur diskriminon etnitë e tjera, duke favorizuar ndjeshëm etninë maqedonase.

Tabela nr. 2: Të dhënat e përfaqësimit etnik në institucionet qendrore të RMV.

Lloji i institucionit	Maq.	Shq.	Boshnj.	Vlleh	Rom	Serb	Turq	Tjerë
Presidenca	85,71	7.14%	0.00%	3.57%	1.79%	0.00%	1.79%	0.00%
Parlamenti	70,57%	25,18%	0.71%	0.00%	1.42%	1.06%	1.06%	0.00%
Trupat Rregullator	82,67%	13,60%	0.53%	0.53%	0.00%	1.60%	1.07%	0.00%
Org. të pav.SH.	81,33%	12,58%	0.41%	1.89%	1.35%	1.22%	0.54%	0.68%
Ombudsmani	40,91%	42,42%	4.55%	3.03%	3.03%	4.55%	1.52%	0.00%
Banka Kombëtare	89,58%	7.18%	0.23%	0.00%	0.23%	0.46%	0.23%	2.08%
Gjykata Kushtetuese	91,30%	4.35%	0.00%	0.00%	0.00%	4.35%	0.00%	0.00%
Qeveria e RM	71,12	6.81%	1.36%	0.82%	8.99%	1.09%	9.54%	0.27%
Sekretar. në qeveri	4,93%	86,67%	1.61%	0.16%	2.84%	0.16%	2.46%	1.18%
Zyrtarë në qeveri	91.08%	4.72%	0.79%	0.79%	1.31%	0.79%	0.52%	0.00%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Nuk shfaqen më mirë edhe pjesët e tjera të veçanta të strukturës qeverisëse në ministrinë përkatëse, si pjesë përbërëse e drejtimit qendror të shtetit. Dallimet janë të dukshme në strukturën ministrore, sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3: Përfaqësimi etnik në institucionet e nivelit të dytë.

Komuna dhe Qyteti Shkupi 76,84 18,55		0.41%	0.49%	0.56%	1.27%	1.7%	0.51%
Persona Publik me Autorizim zyrtarë		0.0%	0.00%	0.00%	0.00%	2.38%	0.00%
Autor.Zyrtarë	83,59	0.22%	0.88%	0.88%	0.66%	1.3%	0.22%
Këshilli i Prokur. Publik	0.00%	0.00%		0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Gjykatat	81,67 13,34	0.42%	1.09%	0.96%	0.80%	1.34%	0.38%

Këshillat e gjykatave	81,82 909	0.00%	0.00%	0.00%	4.55%	2.7%	2.27%
Ministritë			0.64%	0.95%	1.46%	1.8	0.36%
Org. në përbërje të minist. 78,76 17,03%	0.24%		0.68%	0.46%	0.94%	1.7	0.1
Org. pavarura	0.52%		0.81%	1.39%	2.18%	1.89%	0.29%
Persona Juridik me autorizime zyrtare	0.13%		0.06%	0.25%	0.63%	0.2	1.9
Institucione pub.	75,75 19,51	0.37%	0.37%	0.58%	1.12%	1.68%	0.60%
Ndërmarrje pub.	76,45 15,01	0.48%	0.32%	3.08%	1.22%	1.34%	2.10%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Simbolik shfaqet edhe numri i përfaqësimit të shqiptarëve dhe etnive të tjera në Këshillat e Gjykatave, tek të cilat vendimet kanë një rol kyç në pjesën e prioriteteve të punës që udhëhiqen në raport me pjesën e kompetencave që kanë këto organe vendimmarrëse.

Tabela nr. 4: Të dhëna mbi përfaqësimin etnik në sistemin mediatik dhe telekomunikacion.

Lloji i institucionit	Maq.	Shq.	Bosnja	Vlleh	Rom	Serb	Turq	Tjerë
Agjension për audio dhe shërbime të medimeve audiovizuele	76.00%	22.00%	0.00%	0.00%	0.00%	2.00%	0.00%	0.00%
Agjension për komunikim elektronik	93.75%	6.25%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Agjensioni për posta	88.24%	11.76%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Agjension për rregullimin e	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

sektorit hekurudhor								
Agjensioni për supervizion dhe sugjerime kapitale të financimit penzional.	55.17%	24.14%	0.00%	3.45%	0.00%	3.45%	13,79%	0.00%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Në këndvështrimin e studimit nuk mund të anashkalohet situata në një pjesë të rëndësishme të strukturës qeverisëse, në Sekretariatit e Përgjithshëm të RMV. Edhe në këtë rast, dallohet numri simbolik i përfaqësimit të shqiptarëve, ku ata arrinë një përfshirje 6.81%, përballë një numri i cili është 71.12%. Jo vetëm kaq, por numri i përfaqësuesve rom dhe turq në këtë sekretariat është më i madhe sesa për shqiptarët.

Tabela nr. 5: Përfaqësimi etnik në Sekretariatit e Përgjithshëm të qeverisë së RMV.

Qeveria e RM	Maq.	Shq.	Boshnjak	Vlleh	Rom	Serb	Turq	Tjerë
Sekretariati i përgjithshëm i RM	71.12%	6.81%	1.36%	0.82%	8.99%	1.09%	9.54%	0.27%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Është interesant fakti që në aparatin burokratik, ku nuk funksionon autoriteti vendimarrës, si në rastin e mbushjes së organikës së Sekretariateve në Qeveri, apo të Sekretariatit të Zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit, ku përqindja e shqiptarëve shkon në 91.5%. Në të gjithë strukturat qeverisëse, ky sekretariat është lënë në këto nivele përfaqësimi.

Nëse do t'i referohemi realitetit, është pikërisht kjo Marrëveshje që nuk është zbatuar nga shteti dhe pushtetit politik për të realizuar kërkesat që kanë një mandat ndërkombëtar. I lënë nën juridiksionin e strukturave politike, ky organ është pjesë e parandësishme e politikbërjes në RMV. Përgjegjësia e morealizimit të kërkesave të MKO u është lënë subjekteve politike. Shumica e pranisë së shqiptarëve në këtë institucion, kalon përgjegjësitë e moszbatimit në

drejtim të tyre. Thjeshtë të punësosh njerëz dhe efektet të jenë minimale, do të thotë që e drejta e politikbërjes në këtë drejtim i është deleguar institucioneve të tjera me shumicë maqedonase.

Tabela nr. 6: Përfaqësimi etnik në strukturat dytësore të qeverisë së RMV.

Sekretariatet e qeverisë në RM	Maq.	Shq.	Bosnjak	Vlleh	Rom	Serb	Turq	Tjerë
Qeveria e RM	60.0	29.00%	2.00%	3.0	2.00%	0.00%	3.00%	1.00%
Sekretariat për çështje evropiane	80.	12.00%	0.00%	0.0	0.00%	8.00%	0.00%	0.00%
Sekretariat për zbatimin e Marrëv. së Ohrit	0.69%	91.05%	1.61%	0.0	2.93%	0.06%	2.47%	1.20%

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Në dekadën që analizojmë në këtë studim, shqiptarët kanë qenë pjesë e pushtetit politik dhe janë bërë pjesë e qeverisjes së vendit në bazë të përfaqësimit të tyre elektoral. Për një kohë të gjatë partia më e madhe shqiptare BDI ka drejtuar vendin në koalicion me partitë më të mëdha maqedonase, VMRO-DPMNE dhe së fundi me LSDM.

Zvogëlimi i numrit të aktorëve politik dhe të nëpunësve me etni shqiptare, ka shkuar në kundërshtim me kërkesat e vendimmarrjes ndërkombëtare, nëpërmjet mbajtjes së pushtetit me standarde demokratike të përfaqësimit.

Sipas përllogaritjes në strukturën e qeverisë së RMV në dekadën e fundit, në përfaqësimin e 14 ministrive qëndrore mesatarisht pala maqedonase është e përfaqësuar në masën 67.5%, ndërsa pala shqiptare në masën 25% dhe pakicat e tjera në masën 7.5%. Edhe këtu raportet e përfaqësimit janë 1:4.

Tabela nr. 7: Përfaqësimi etnik në strukturat ministrore të qeverisë së RMV.

Ministritë	Maq.	Shq.	Bohsnj.	Vlleh	Rom	Serb	Turq	Tjerë
Ministria e Ekonomisë	44.68%	46.81%	1.42%	1.42%	0.71%	0.71%	3.55%	0.71%
Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor	64.16%	32.30%	0.44%	0.00%	0.00%	2.21%	0.44%	0.44%
Ministria e shëndetësisë	66.42%	31.39%	0.73%	0.00%	0.73%	0.00%	0.73%	0.00%
Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ujësjellësit	76.35%	17.37%	0.50%	0.30%	0.90%	1.70%	2.40%	0.50%
Ministria për administrim dhe shoqëri të informatikës	86.83%	7.80%	1.95%	0.49%	0.49%	1.46%	0.98%	0.00%
Ministria e kulturës	61.25%	31.25%	1.25%	0.63%	0.63%	4.38%	0.63%	0.00%
Ministria e pushtetit lokal	35.29%	56.86%	5.88%	1.96%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Ministria e punëve të jashtme në Republikën e Maqedonisë	74.73%	21.81%	0.00%	0.22%	0.65%	0.65%	1.51%	0.43%
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	59.77%	30.27%	1.53%	0.77%	2.30%	2.68%	2.68%	0.00%
Ministria e mbrojtjes në RM	76.55%	16.08%	1.01%	0.67%	0.67%	1.68%	2.85%	0.50%
Ministria e drejtësisë	56.19%	35.40%	1.77%	0.88%	1.77%	0.88%	3.10%	0.00%
Ministria e transportit dhe lidhjes	79.62%	12.69%	0.77%	0.00%	1.54%	1.15%	2.31%	1.92%
Ministria për punë dhe politikë sociale	74.10%	17.77%	0.30%	2.11%	2.71%	2.11%	0.90%	0.00%

Ministria e financave	87.27%	10.00%	0.30%	0.91%	0.30%	0.61%	0.61%	0.00%
-----------------------	--------	--------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Burimi: Të dhëna zyrtare - marrë nga: <http://www.mio.gov.mk>, parë më 2016.

Duke i marrë në analizën e përgjithëshme trajtimin e 7 tabelave kryesore, të cilat përmbajnë material zyrtar sipas informacioneve të institucioneve të shtetit maqedonas, të dhënat shifrore shfaqin një natyrë të hapur të morrespektimit të raporteve të pjesmarrjes në institucionet qendrore vendimarrëse, jo vetëm të palës shqiptare, por edhe të etnive të tjera që përbëjnë demografinë e RMV.

Masa e përfaqësimit është e lidhur edhe me kontributin në vendimmarrjen politike, edhe pse shpesh herë në rastet e tensioneve apo të krizave, përsha specifike e zgjidhjeve ka kaluar në dorë të subjekteve politike.

Kjo mënyrë përfaqësimi në çdo rast nuk ka shërbyer për të ulur tonet apo dozat e nacionalizmit nga të dy palët, duke e tensionuar hera herës situatën në vend.

Kjo mënyrë përfaqësimi në aspektin e mosrespektimit të të drejtave elektorale, njerëzore dhe demografikea, nuk i ka shërbyer dhe nuk i shërben as sot nivelit të lartë të politikbërjes që i duhet shtetit të RMV, për shkak të orientimit të tij drejt anëtarësimeve euroatlantike.

Klasa politike dhe drejtuesit aktorë politikë të institucioneve qendrore shtetërore, duhet t'i largohen frymës së nacionalizmit, sepse ata janë faktor shumë i rëndësishëm në politikbërjen në të gjithë nivelet e jetës.

Në këtë situatë imazhi i kësaj republike ende qëndron në ujërat e vjetra të nacionalizmit sllav. Urrejtja që shpërthen hera herës e ka bërë edhe në këto parametra, duke e bërë shtetin maqedon të mos gjenerojë siguri të brendshme dhe siguri rajonale.

Ndryshe nga dekada që marrim në analizë, të dhënat e viteve të fundit janë më premtuese. Kalimi i pushtetit politik tek LSDM dhe koalicioni qeverisës me shqiptarët, po krijon gradualisht një klimë më bashëkpunuese dhe lënien e hapësirave më të mëdha në përfaqësimin etnik në institucionet qendrore.

Fakti që në zgjedhjet e fundit, drejtimi i Parlamentit iu besuar palës shqiptare dhe ndarja e strukturës qeverisëse ka pësuar ndryshime në favor të shqiptarëve, premt për një politikbërje

me efektive, më të hapur, më transparente dhe të përfshirë brenda vizionit dhe objektivave strategjikë të shtetit.

V.2. Përvojat e politikës regressive në shoqëritë diverse shumëkulturore, pozita e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

Pas viteve '90-të, shumë vende të ish-sistemit komunist kaluan në një periudhë tranzicioni, të shoqëruar me ndryshime të vazhdueshme dhe realizim të reformave, duke filluar në radhë të parë nga sistemi politik, modeli i tij, reformat institucionale dhe shumë karakteristikave të tjera, të cilat sot radhiten në vlera të funksionimit të mirëfilltë të demokracisë dhe të shtetit ligjor të së drejtës.

Këto karakteristika, ku më shumë e ku më pak gjetën zbatim konkret në fillimin e procesit të reformave, ku në praktikën e vendeve të ndryshme u evidentuan përvoja të reja politike, duke zbatuar në sistemet e tyre një praktikë të ndikuar nga standardet e demokracisë perëndimore dhe të BE-së. Këto ndryshime e shoqëruan Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor, duke ndikuar fuqishëm në transformimin e jetës social – politike dhe ekonomike të shoqërisë dhe të rajonit. Ndryshimi u shoqëruar me shpërbërjen e RSFJ-së, duke rënuar bazat e një sistemi monist, që mbante nën diktat popuj dhe kombe, të cilët aspironin për pavarësi dhe zhvillim.

Në fakt, rënia e sistemit dhe ndryshimi kishte filluar kohë më parë në shumë vende të Evropës lindore dhe qendrore me rrëzimin e Murit të Berlinit, për të mbërritur edhe në rajonin ballkanik. Me natyrën e një lëvizje të re epokale, ajo shprehte optimizëm tek popujt dhe kombet edhe pse në disa vende, përfshi dhe RMV, një pjesë e opinionit kërkoi ndryshime të priti me skepticizëm.

Ndryshimet politike dhe ligjore që pasuan, bënë të mundur që krahas transformimit të koncepteve dhe bindjeve të ndryshme politike (*kalimit nga sistemi monist në atë pluralist*), ndryshimet të orientoheshin në shumë drejtime të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë dhe ndërtimit të institucioneve. Në ish federatën e Jugosllavisë pas shpërbërjes do të duhej të ndërtohej një sistem i ri politik me këto orientime bazë:

- Krijimin e rrethanave dhe kushteve të funksionimit një shoqërie me mentalitet të ri, në bazë të funksionimit të pluralizmit politik;
- Në ndërtimin e institucioneve të pavarura të pushteteve, sipas modelit perëndimor;

- Plotësimin e institucioneve shtetërore me kuadro të nevojshme, duke synuar një psikologji të re kombëtare;
- Krijimin e kushteve për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në të gjitha drejtimet e zhvillimit strategjik të vendit etj.

Vëmendja në reforma iu kushtua reformimit të thellë të administratës shtetërore, si një veprim kompleks dhe i shumëfaktorshëm, që do të mundësonte kalimin gradual të pushtetit në faën fillestare. Në këtë çështje në RMV proceset ecën ngadalë, të shoqëruara me situata të vështira politike, duke shfaqur vështirësitë e pranimit të kërkesave të reformave të thella demokratike.

Përballë standardeve perëndimore mbi profesionalizmin dhe transparencën, situata në administratën shtetërore kaloi në rrugë shumë të vështira. Reformimi i administratës publike të RMV nuk filloi që në momentet e shkëputjes nga Ish Federata Jugosllave, edhe pse deri në vitin 1994 sistemi do të funksiononte ndryshe nga më parë. Prej vitit të shkëputjes dhe shpalljes së pavarësisë e deri në vitin 2001, me mbarimin e konfliktit të armatosur, shteti do të luhatej ende nën frymën e vjetër të sistemit monist, e diktuar nga persioni politik dhe ushtarak i Serbisë dhe çështjeve të autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shkupit.

Në objektin e studimit në këtë periudhë veçohet fakti i tendencave të transformimit të administratës publike, duke u mbështetur në ndryshimet e Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ dhe RSM, (*amendamentet 57 - 80*), të cilat sollën për rrjedhojë dy Ligje në drejtim të sistemit të administratës publike:

- Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Veriore;
- Ligji për organet e administratës;

Plotësimi ligjor të fillimit të këtij procesi reformues do të shihet më vonë me vazhdimësinë e prezantimit të Ligjit për zgjedhjet lokale, të cilat u plotësuan me një akt ndërkombëtar të marrë nga Konventa Evropiane për Qeverisje Lokale të Këshillit Evropian në maj të vitit 1997. (Gaz. Zyrtare nr. 59/22.07.2000-www.pravo.org.mk).

Pavarësisht përpjekjeve simbolike në drejtim të thellimit të reformave ligjore dhe administrative sipas kërkesave të BE-së, ajo që ka interes në këtë studim janë disa çështje të cilat kanë ndikimin e tyre deri në kohën e sotme, duke synuar drejt një politikbërje në kushtet e një shteti multi-etnik. Këto çështje kanë të bëjnë në radhë të parë me aspektin e ndarjes së pushtetit dhe vetëqeverisjes

lokale, si dy shtylla kryesore të fillimit të procesit të reformimit, sipas situatës konkrete në rastin e RMV, pasi ajo përbën një situatë specifike, *sui generis*, apo e veçantë në llojin e vetë.

Në vijimësi, në proceset politike u përcaktuan më saktë standardet e procesit të politikbërjes, të cilës i duheshin rregulla të reja sipas standardeve ndërkombëtare, të njohura si Kriteret e Kopenhagës. Këtu përcaktohen qartë kriteret politike, kriteret ekonomike dhe kriteret institucionale. Sipas çështjeve dhe problematikave kryesore me të cilat përballlet sot procesi i tejzgjatur i thellimit të reformave, do të duhej të mbaheshin parasysh edhe këto orientime:

- Konsolidimi i sistemit demokratik dhe garantimi i të drejtave themelore të njeriut dhe etniteteve të tjera në Maqedoninë Veriore;
- Përmirësimi i sistemit zgjedhor dhe i zgjedhjeve të përgjithshme;
- Përmirësimi i sistemit të zgjedhjeve të organeve të përgjithshme;
- Reformat institucionale në institucionet qendrore si, Parlamenti, Drejtësia, Pushteti Vendor, Ekzekutiv qendror dhe administrata publike;
- Të drejtat themelore të njeriut dhe të pakicave, të drejtat etnike, të drejtat e pronësisë, garantimi i procesit të drejtë zgjedhor, liria e besimit.
- Ndërtimi i shtetit ligjor të orientuar në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, fuqizimin e organeve të sigurisë së vendit, zbatimi rigoroz i ligjit, përmirësimi i dokumentacionit dhe informacionit, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe bashkimi ndërkombëtar, edukimi ligjor etj.

Duke filluar nga kuptimi dhe rëndësia e përgjithshme që ka ***Samiti i Kopenhagës***, i cili u referohet kritereve të mësipërme, në studim është parë e arsyeshme që këtë çështje ta trajtojmë përmes raporteve dhe mendimeve, të cilat i janë dërguar RMV në këtë drejtim nga subjektet kompetente ndërkombëtare. Gjithashtu janë marrë në konsideratë analizat e vitit '98-të dhe të raportit të vitit 2001, si harku kohor i fillimit të negociatave për anëtarësim në BE.

Kjo është periudha e fillimit të këtyre negociatave në proceset e intergimit europian. ***Në radhë të parë rëndësia qëndron në faktin që vihet theksi i veçantë procesit të reformimit dhe fillimit të negociatave 1997-2002, dhe në bazë të saj sillet vendim për fillimin e negociatave në vitin 2004. Gjithësesi në këtë çështje rëndësi e veçantë i kushtohet kritereve politike dhe ekonomike.***

Kriteret politike që i kërkojnë në këtë periudhë RMV, janë ato të cilat korrespondojnë me përcaktimet e Bashkimit Evropian për të gjitha vendet që janë në procesin e anëtarësimit; ku mes të tjerash theksohet: respektimi i të drejtave të pakicave; kërkesa për zhvillimin e një qeverisje të mirë (*good governance*); lufta kundër korrupsionit e cila faktikisht është pjesë e domosdoshme e përbushjes së kriterit politik për procedurën e kriterëve apo kushteve politike.

Ato tani paraqesin një tërësi vlerash, të cilat erdhën si vazhdimësi e **Traktatit të Amsterdimit**, në të cilin ku më shumë e ku më pak kërkoreshin këto kritere, të cilat më vonë u plotësuan pikërisht me Kriteret e Kopenhagës, atë që ne sot e konsiderojmë si pjesë të domosdoshme të përbushjes së këtyre kërkesave.

Me qëllimin e rishikimit të këtyre kriterëve para Komisionit Evropian, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim bëri një listë të indikatorëve dhe nivelit demokratik të vendeve, të cilat shfrytëzonin kreditë e saj, duke vënë në detyrim këto parakushte; mbrojtje të barabartë para ligjit përfshirë këtu edhe minoritetet, shprehjen e lirë të individit dhe të mediave, të drejtën e organizimit dhe të mbledhjes, të drejtën e ndërgjegjes dhe të religjionit, të drejtën e pronësisë private, si dhe të drejtën e formimit të sindikatave dhe të grevës.

Për të gjitha këto kritere, Komisioni Evropian në praktikën e tij përgatit dhe ua paraqet në raportet vjetore vendeve aspirate, në fazën e para anëtarësimit, ku mes të tjerash nuk bën vetëm përshkrimin formal të zhvillimeve të proceseve, por bën një tjetër studim mbi nivelin e zhvillimit demokratik dhe qeverisjes së të drejtës, prapa të cilave qëndrojnë vendet që shfrytëzojnë fondet e saj. (Progress Report toward asociacion, RM. 2015).

Për më tepër, çdo raport vjetor përmban sugjerime të veçanta për vendin të cilit i adresohet. Në rastin konkret, në RMV, pas periudhës së vitit 2001 raportet zyrtare që vijnë nga Brukseli, gjithnjë e më tepër tek pjesa që i referohet kriterëve politike, në mes tjerash përmendet nevoja e stabilitetit politik dhe roli i partive politike si subjekte politike, të cilat në këtë drejtim mund të luajnë një rol të rëndësishëm.

Në këtë kontekst përfshihen partitë politike shqiptare dhe ato të bllokut maqedonas, pasi roli i tyre është shumë i rëndësishëm në bashkërendim për stabilitetin politik dhe të sigurisë së vendit. Vëmendja i kushtohet momenteve të mbajtjes së zgjedhjeve për garantimin e rendit publik dhe respektimit të votës së lirë të qytetarit.

Nga vërejtjet e vëzhgimeve që i janë bërë Republikës së Maqedonisë së Veriut nga monitorimi ndërkombëtar OSBE dhe ODIR-it, ato kanë qenë kategorike në probleme të tilla që i janë

adresuar qeverisë dhe institucioneve të RMV. Këto vërejtje në radhë të parë i janë adresuar qeverisë, e cila në periudhën pas konfliktit të armatosur të vitit 2001 dhe më pas, e kishte shumë të vështirë të siguronte stabilitetin politik, institucional, pa folur këtu për stabilitetin ekonomik.

Për këto çështje thelbësore BE-ja rekomandonte tek plotësimi i këtyre kushteve, të cilat kishin dalë si pasojë e rekomandimeve të Këshillit Evropian, i cili në vitin 1993 në Kopenhagë do të përcaktonte kushtet e anëtarësimit.

Procesi i reformimit të RMV ishte për Bashkimin Evropian një proces më specifik dhe më i komplikuar. Vazhdimësia e proceseve të mëtejme që BE-së synonte në faktin se si kanë ecur reformat në RMV dhe ku më saktë ishin problemet që i referoheshin kryesisht kriterit politik, që kishin të bënin me demokracinë dhe sundimin e së drejtës.

Në këtë këndvështrim, para së gjithash duhet veçuar fakti dhe rrethanat në bazë të të cilave është zhvilluar kjo procedure reformimi. Kështu, RMV me Deklaratën e Pavarësisë më 25 janar të vitit 1991 u shpall shtet i pavarur, e cila u pranua kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht me referendumin e 8 shtatorit. Qysh nga faza e parë e pavarësisë, praktika tregon që në përfitimin ndaj vlerave të shpërndarjes dhe pavarësisë, shqiptarët u përballën me padrejtësi të mëdha.

Në vendimin për shpalljen e Kushtetutës së RMV - 17 nëntor 1991 u shfaqën probleme, të cilat u pasuan me; Vendim për shpalljen e Amendamenteve I dhe II të Kushtetutës së RMV - 6 janar 1992; Vendim për shpalljen e Amendamentit III të Kushtetutës së RMV - 1 korrik 1998. Të rëndësishme u vlerësuan ndryshimet kushtetuese të 16 nëntorit 2001, (*gjithësejt 15 të tilla*), pas përfundimit të konfliktit të armatosur. (www.sobranie.mk:2006).

Ndryshimet e kushtetutës, veçanërisht i preambolës së saj, kanë vijuar në vitet në vazhdim, deri në ndryshimin e fundit më 11 janar të vitit 2019. (Gazeta zyrtare e RMV nr. 1/92, 31/98, 91/2001, 84/2003, 107/2005). Miratimi i Kushtetutës së RMV, u konsiderua si një nga aktet më të larta juridike, në mënyrë që t'i jepet më tepër hapësirë në radhë të parë krijimit të një sistemi juridik, edhe pse ky akt nuk do të përmbushte kriteret e duhura dhe nuk do të përfshinte rolin dhe rëndësinë e shqiptarëve në këtë shtet.

Ndryshimet u realizuan në periudha të shkurtra kohore, duke përmirësuar gradualisht legjislacionin dhe pozitën e shqiptarëve në RMV. Kjo do të ishte një garanci juridike, e cila në aspektin e zbatimit praktik do të sillte dallime mbi realitetin shoqëroro - politik në Maqedoninë e Veriut. (KE, 9 nëntor, Bruksel, 2005).

Strukturat ndërkombëtar do të paracaktonin rregullat ndaj vendeve aspirante për anëtarësim në BE, duke marrë garanci nga qeveritë përkatëse ëpr zbatimin e standardeve dhe kushteve, të cilat këto vende do të duhej tu përmbaheshin. Me këtë rast, në raportin analitik të Qeverisë së RMV drejtuar Brukselit, ndër të tjera do të veçoheshin këto pika, në bazë të të cilave ajo do të raportonte në vijueshmërinë e reformave, duke vënë theksin: Në vitin 1992, nga periudha e shkëputjes së RMV, shprehet kategorikisht se vendi nuk ka pretendime territoriale me asnjë nga vendet fqinje dhe se nuk do të përzihet në të drejtat sovrane të vendeve të tjera apo në punët e tyre të brendshme, (*konflikti me Greqinë për njohjen ndërkombëtare të saj*); më 1998, për kohëzgjatjen e paraburgimit dhe vendimin gjyqësor nga 90 - 180 ditë; në vitin 2001, sigurimin e një kornize kushtetuese për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, të realizuar më 13 gusht të vitit 2001; në 2003, për krijimin e mjeteve të jashtëzakonshme të kontrollit nga ana e policisë me kontrollin nga ana e gjykatës. (*Raporti analitik, 9 nëntor, SEI- Bruksel, 2003*).

Kjo përmbajtje problemore paraqet Raportin analitik dhe pikat e të cilit u bënë pjesë e reformimit në sistemin e funksionimit politik dhe shtetëror në RMV. Për sa i përket modelit të sistemit politik dhe mënyrës së organizimit të pushtetit shtetëror, vëmëndje në studim i është kushtuar parlamentarizmit në RMV. Edhe pse ekzistojnë forma të ndryshme të organizimit të pushtetit shtetëror, vende të ndryshme kanë praktika të ndryshme, por karakteristika e përgjithësme, është pikërisht ndarja e pushteteve në sistemin e demokracisë.

Këtu fillon ndarja e pushteteve, sepse sipas praktikave në vende të ndryshme ka raporte të ndryshme mes ekzekutivit, parlamentit sipas modelit të sistemit politik dhe mënyrës së ushtrimit të pushteteve, mbi bazën e parimeve themelore. Parimi i unitetit të pushtetit dhe Parimi i ndarjes së pushtetit, është ajo formë e qeverisjes së shtetit, ku pushteti shtetëror është i koncentruar në një organ suprem shtetëror, i cili formon dhe mbikëqyr të gjitha format e tjera të pushtetit shtetëror. Parimi i unitetit të pushtetit shtetëror, bazohet në dominimin e organit legjislativ (Elezi, 2017).

Në praktikën e shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave prej të cilës dolën shtete të reja të pavarura, u krijuan mundësinë e ndryshimit të parimeve të ushtrimit të pushtetit dhe daljen në skenë të shteteve me orientim bashkëkohor. Qasja shkencore teorike në parimin e ndarjes së pushteteve, duke respektuar raportet në Parlament, Qeveri dhe sistemin gjyqësor, i cili u përfshi në nivelin tre shkallësh, (*gjykata si sistem, me tre llojet e gjykatave, themelore, të apelit dhe atë kushtetuese*), një praktikë kjo e realizuar në Maqedoninë e Veriut.

Me paraqitjen e shtetit bashkëkohor dhe përmbysjen e ideologjisë komuniste, shtetet e dala nga sistemi socialist pësuan disa ndryshime, duke u munduar kështu t'i japin praktikave të pushtetit dhe shteteve të tyre element të demokratizimit drejt arritjes së standardeve Evropiane.

Statuti i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën dhe rendin juridik në RMV, e radhit atë në vendet ku mbizotëron sundimi i rendit dhe të drejtës kontinentale. Burime kryesore të së drejtës janë: Kushtetuta, Ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i RMV. E drejta ndërkombëtare paraqet burimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë në sistemin e së drejtës në RMV. Sistemi i demokracisë parlamentare është i bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit.

Kjo paraqet një nga vlerat themelore të demokracisë parlamentare, praktikë kjo e cila ndiqet edhe nga RMV. Me kushtetutën e vendit është ndarë pushteti në tre nivele: pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor. Nga praktika e ditëve të fundit (Prill, 2017), u realizua rikthimi në punë i deputetëve të Kuvendit të RMV. Problematika u shfaq në qëndrimin qytetar, ku opinionet shpërthyen rëndom (*opinion i maqedonas*) kundër deklaratës së përbashkët të partive politike të shqiptarëve në Maqedoni, të etiketuar, “*Tiranska Platforma*”, apo “*Platforma e Tiranës*”, duke shfrytëzuar si pretekst takimin e realizuar të liderëve të partive politike të shqiptarëve të RMV në Tiranë, dhjetor 2016.

Qëndrimi kundër u orientua drejt mospranimit të të drejtave legjitime të shqiptarëve në RMV, të cilat janë të anashkaluara nga sistemi juridik dhe kushtetues i këtij shteti, të mbështetura gjithashtu nga institucionet dhe organet shtetërore.

Takimi i liderëve politik shqiptarë nga RMV, nuk nënkupton marrjen e opinionit nga Tirana, për faktin se u realizua një takim me kryeministrin e Shqipërisë. Edhe pse në praktikën teirke të politikës kjo nuk bën përjashtim, debatet e pafundme të motivuara nga fryma nacionaliste, por mbi të gjitha arritja e një zgjidhje, sollën një përvojë të re që nuk ka të bëjë me pretendime territoriale, por me zgjidhje politike në interes të stabilitetit të shtetit të RMV.

Njohja juridike dhe marrëdhëniet normale dypalëshe do të jenë një faqe e re e përvojës që duhet të krijohet në RMV, ku faktori maqedon duhet ta shikonte deklaratën e përbashkët me tjetër frymë, në interes të stabilitetit dhe të ardhmes së shtetit.

Këto qëndrime dhe përvoja nuk kanë vend për t'u trajtuar si pengesa nga faktori politik shqiptar, por si kërkesa stabiliteti, të cilat duhet të përfshihen në programet qeverisëse dhe në politikbërjen e qeverisë dhe institucioneve qendrore në RMV. Skandalet politike që shoqëruan jetën politike

dhe sociale në dekadën që përfshihet në këtë studim janë një përvojë negative e qëndrimit të njëanshëm të faktorit politik dhe ekzekutiv maqedonas, duke e rënduar situatën brenda shtetit.

Përvoja e disa shteteve në Ballkan, përfshi dhe RMV, ka dëshmuar sesa herë pushteti dhe shteti janë përfshirë në krizë politike, janë përpjekur ta kalojnë situatën në përplasje etnike, duke synuar kriminalizimin e faktorit shqiptar. Periudha studimore është e mbushur me raste të tilla, të cilat shkaktuan incidente të rënda me karakter etnik dhe fetar. Zhvillimet e mëvonëshme në RMV, po tregojnë se këtyre praktikave po u vjen fundi.

Shqiptarët po dëshmojnë çdo ditë se janë të vendosur në rolin e tyre të shtetndertimit dhe të bashkëjetesës, duke e kushtëzuar këtë jo me pretendime nacionaliste, por me respektimin nga palët të të drejtave njerëzore, etnike, ekonomike e sociale sipas standardeve europiane të shtetit të qytetarit. Shqiptarët janë të hapur në mirëpërdorimin e fondeve të gatshme nga BE-ja, për më tepër transparencë nga organet shtetërore, për rindarje më të drejta të tyre, për të ngushtuar dallimet e investimeve në hapësirat shtetërore mes lindjes dhe perëndimit, duke respektuar të drejtat jo mbi baza etnike, por në baza qytetare.

Kundër qëndrimeve diktatoriale, situatat sot sjellin sfida të reja të krijuara në kushtet dhe rrethanat e gjeopolitikës dhe strategjive të reja që vijnë, si rrjedhojë e proceseve të reja në politikën globale. Është e qartë se vazhdosin të funksionosh në kornizat e ngushtuara të një shoqërie që lëviz shumë ngadalë, si në praktikën e RMV, do të thotë të mos jesh në harmoni me kërkesat që janë thelbi i demokracisë, si pjesë e domosdoshme e standardeve ndërkombëtare, praktika të paarritura deri më sot. Arsyet dhe faktet nuk mund të zgjidhen “*ad hock*”, por bazuar nga përvoja që është përcjellë deri më sot, që nga periudha e konfliktit të vitit 2001.

Sot, të jesh aktor në rrethanat aktuale në procesin e politikbërjes në RMV, do të thotë të përballesh me vështirësi të dyfishta të kohës dhe vendit. Në radhë të parë, mbështetemi në faktin se ky sistem dhe kjo përvojë që gradualisht po lihet pas, duhet nënkuptuar si një epokë e errët e politikbërjes, objekt i analizave studimore shkencore në fushën e politikës, si një përvojë nga e cila duhen nxjerrë përfundime e rekomandime, për vetë natyrën e karakterin e një shteti multi-etnik, ekzistenca e të cilit është e kushtëzuar nga vullneti i popujve që jetojnë brenda shtetit. Përvoja ballkanike edhe në këtë fushë nuk mungon.

“Nëse vini në pushtet ose ju ofrojnë ndonjë post keni kujdes nga sjelljet e juaja. Mos u bëni mendjemëdhenj, mos t’ju hyjë vetja në qejf. Mos merrni gjërat të cilat nuk ju përkasin juve, ndihmoni të dobët dhe përmbahuni rregullave të moralit. Mos harroni se çdo pushtet i vjen fundi. Çdo post ose pushtet është përkohësishëm i yti pra është kalimtar dhe herët a vonë të gjithë kanë për të dhënë llogari

fillimisht para popullit të tyre e pastaj para Zotit të gjithësisë. A.I. (Ibrahimi, N. Jeta dhe vepra e A. Izetbegović, 2015).

Të bindur në këto parametra dhe bazuar në faktorë që shoqërojnë një periudhë si kjo, nuk mund të qëndrohet indiferent ndaj krizave politike të shkaktuara për shkaqe etnike. Mungesa e theksuar e transparencës dhe funksionimit jo të mirëfilltë të shtetit demokratik dhe prania e shumë anomalive të tjera, janë faktor bazë që kushtëzojnë dështimin e politikës aktuale të bllokut politik të shqiptarëve, por dhe të subjekteve politike me të cilat bashkëveprohet në qeverisje.

Këto dhe një sërë elementesh të tjerë, bëjnë të mundur që në shoqëri të shfaqen pakënaqësitë, shkak i neglizhencës dhe mospërfilljes së qytetarit në bazë të standardeve normale që duhesh të zbatojë një pushtet demokratik. Kjo formë trajtimi në funksion të mbrojtjes së vlerave fundamentale të demokracisë, nënkupton që shoqëria në zhvillim nuk duhet të qëndrojë larg parametrave të tillë që burojnë nga e drejta në demokraci.

Civilizimi dhe bota që në lashtësi këto sfida i ka tejkaluar por edhe sot në kushte të reja, për të njetat çështje ajo ka gjetur zgjidhje. Krahasimi me këtë përvojë është i pranushëm. Për shumë arsye historike, shëkulli që lam pas dhe bota europiane shkarkoi mbi popujt e Ballkanit, e veçanërisht mbi shqiptarët pasoja të rënda, duke e lënë kombin të përçarë e të coptuar, të pafuqishëm politikisht dhe ekonomikisht dhe të ndërruar nga vendimarrja e fuqive të mëdha.

Sot, kur kriza politike ballkanike është thelluar edhe më tej, faktori politik shqiptar nuk duhet ta kërkojë ende përgjegjësinë tek të tjerët për shkaqe historike, as tek veprimi i faktorëve të jashtëm, kur në marrëdhënie e ndërveprimin e brendshëm kombëtar shfaqen shumë probleme. Dështimi në një masë të theksuar i politikës që sot është e interesuar vetëm për pushtet, ka dhënë efekte negative mbi subjektet politike dhe opinionin shqiptar, të cilët nuk janë dakort me përkuqjen para diskriminimit racor, etnik, fetar dhe ekonomik që u bëhet popullsisë shqiptare që banojnë brenda territoreve gjeografike e politike të shteteve ballkanikë.

Në kushte dhe rrethana të reja bashkëkohore, mund të thuhet se edhe pse fill pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Rendi i Ri botëror që u krijua u mbështet kryesisht mbi të drejtat individuale dhe Kombet e Bashkuara dolën me Deklaratën Universale për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, situata për shkak të sistemit politik – ideologjik në Ballkan shumë pak reflektoi. Ajo thekson se *“qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta me dinjtet dhe të drejta”* dhe shërben si forca lëvizëse e shumë legjislacioneve që kanë si bazë të drejtat e njeriut.

Me këtë akt ndërkombëtar do të mbroheshin në përmasa më të gjera liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, duke i dhënë garanci të gjitha vendeve të cilat do ta ratifikojnë këtë

deklaratë, duke bërë pjesë në grupimin e shteteve që do të aspirinin për rendin e ri demokratik. Duke u përfshirë në këtë organizim ndërkombëtar dhe duke u përballur me këto sfida, sigurisht që është e vështirë për vendet në zhvillim si rasti i RMV, e cila sot ende është në rrugën e transformimit dhe të ndryshimeve rrënjësore në sistemin e saj politik.

Me bindje mund të shprehim se sot, krahas këtyre akteve ndërkombëtare të karakterit universal, shumë akte të tjera kanë dalë në funksion të rindërtimit të kapaciteteve institucionale, politike, ekonomike dhe kulturore, që i duhen domosdoshmërisht shtetit për tu marrë në konsideratë nga faktori ndërkombëtar si për RMV dhe vendet e tjera që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Kushtet ecurinë e proceseve të reformimit janë të qartësuara drejt dhe hapur.

Konsolidimi i sistemit demokratik dhe garantimi i të drejtave themelore të njeriut dhe pakicave; Përmirësimi i sistemit zgjedhor dhe i zgjedhjeve të përgjithshme; Përmirësimi i sistemit të zgjedhjeve të organeve të përgjithshme; Reformat Institucionale që përfshijnë Parlamentin, Drejtësinë, Pushtetin Vendor, Ekzekutivin qendror dhe administratën publike; Të drejtat themelore të njeriut dhe të pakicave, të drejtat etnike, të drejtat e pronësisë, garantimi i procesit të drejtë zgjedhor, liria e besimit, zbatimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, fuqizimi i organeve të vendit, zbatimi rigoroz i ligjit, përmirësimi i dokumentacionit dhe informacionit, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, edukimi ligjor.

Duke e konsideruara këtë përmbledhje si një paketë ligjore demokratike, të gjithë shtet që kanë dalë nga konflikte të armatosura për shkaqe etnike, kanë detyrësimin e përmbushjes së kësaj pakete, duke respektuar jo vetëm qytetarët e tyre brenda shtetit, por të reflektojnë politika të tuilla aktive edhe me shtete fqinje. Këtu veçohet rasti i RMV me realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, si dhe rasti i Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995, pas përfundimit të konfliktit në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe të praktikave të vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë. Situata e zhvilluar pas këtyre viteve lëvizi pozitivisht në aspektin e teorisë së shkencave politike, duke e avancuar kompromisin me specifikat por dhe me përgjegjësitë kolektive të kontinentit.

“Më 1999 Unioni Evropian propozoi Procesin e ri për Stabilizim dhe Asocim për pesë shtete të Evropës Juglindore. Më 16 qershor 1999, filluan negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe më pas më 9 prill të vitit 2001 u nënshkrua Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim. Me këtë Maqedonia e Veriut është vendi i parë në Ballkanin perëndimor që është nënshkruar në një Marrëveshje të këtillë me Unionin Evropian”;

Kështu deklarohen të dhënat zyrtare kur flitet për ecurinë e proceseve të reformave në Maqedoninë e Veriut, për hapat e njëpasnjëshëm në vlerësimin e kësaj hapësire perëndimore që hap dyert e anëtarësimit, për të cilët praktikisht në këtë shtet për shkak të mungesës së vullnetit

politik, shfaqen vështirësi të mëdha. Praktika në RMV në çështjen e konsolidimit të shtetit me karakter multietnik, nuk mund të krahasohet me praktikën e vendeve të tjera, por ajo sjell një panoramë politike komplekse me specifikat e saj, të cilat janë edhe objekt i këtij studimi.

Sigurisht që studiues të ndryshëm në analizën e spektrit politik dhe zhvillimin e historikut në Ballkan, i referohen shkaqeve të ndryshme, të cilat e kthyen rajonin në një situatë pasigurie dhe shpërthimesh. Do citojmë **Georges Castellan**, i cilin në veprën e tij *“Historia e Ballkanit”* në mes tjerash thekson:

“Dje, Ballkani ishte “fuçi baruti” e Evropës....Sot, përprjekjet për demokraci kanë sjell aty shpërthimin e nacionalizmit. Kjo enigmë shtetesh të vegjël, të përçarë nga grindjet ndëretnike dhe probleme kufijsh, përmbledh një mozaik popujsh që janë përzier me njëri – tjetrin ose i janë kundërvënë njëri – tjetrit gjatë shekujve. Përveç Greqisë në Kampin socialist ndjejnë nevojën për të ripohuar identitetin e tyre kombëtar duke i shprehur në grindje ndëretnike dhe në ndikime arkaike kufijsh.

Për agjencitë perëndimore të udhëtimit janë peizazhe piktoreske me minaretë në sfondin e maleve të zhveshura dhe me plazhet e nxehta, bregut të një deti që quhet i Zi. Castellan, do të nënvizojë që në shek. XIX në hartën e Ballkanit njëngjyrëshe, njollat që vendoseshin mbi të shprehnin fitoren e nacionalizmave dhe “tërheqjen e njeriut të sëmurë të Evropës”. Modeli i shteteve të reja ishin në radhë të parë kujdestarët e Francës dhe të Anglisë.

Nga e para, ata morën nocionin e shtetit komb, nga e dyta atë të një demokracie parlamentare, por shpejt kopjet përfunduan në karikatura... Maqedonia e Veriut, që për francezët ka qenë një përzierje kulinare, nuk ishte e vetmja që i përziente etnitë dhe besimet fetare. Këto probleme në mes etniteteve të ndryshme shpesh herë ata mundoheshin që t’i shfrytëzojnë për të fshehur iredentizmat territoriale duke përbërë kështu edhe vetë idetë e tyre kombëtare- Megali Ideja Greke apo Naçertania serbe, Maqedonizmi bullgar, që iu kundërvunë njëri-tjetrit edhe në konflikte me armë. Sa për parlamentet e Sofijes, Athinës, ata nuk i dallonte shumë me modelin britanik”. (Castellan, G. 1991:11).

Jo vetëm kaq por edhe më tej, sot e kësaj dite, studiues të shumtë bashkëkohorë, analistë të historikut dhe zhvillimeve të ngjarjeve bashkëkohore, si Samuel Huntington, në veprën, **“Kush jemi ne”**, mbron tezën e multikulturalizmin, diversitetin proevropian, si dhe në veprën tjetër **“Përplasja e qytetërimeve”**, ai mbron tezën mbi dhënien e prioriteteve zgjerimit të proceseve euro-integruese, politikave globale: *“Politika lokale është politikë e etnicitetit edhe në nivel të Evropës, fenomeni multietnik është dhe do të jetë i dështuar”*. Mendime shumë diverse që flasin duke u nisur nga këto përvoja, të cilat ngrihen në rang botëror nga studiues me potencë, japin të kuptojmë se tani në shekullin e ri, mund të pranohet se po ndryshojnë gjykimet dhe perceptimi i fenomeneve në lidhje me mënyrën se si duhet menduar për të zgjidhur problemet apo për t’u ballafaquar me to.

Në kushtet e një shoqërie dhe shteti multietnik, përvoja ka treguar që problemet kanë shumë vështirësi për t’u zgjidhur. Nisur nga ky këndvështrim vjen në ndihmë mendimi i shfaqur vite më parë nga Arbën Xhaferi në RMV. *“Kur dështon ndërtimi i shtetit multietnik, objektivisht hapen konceptet etnike”*, ashtu siç po ndodh realisht në praktikën e RMV. Një dekadë më parë ai do të

shprehej: “*ndërtimi shteteve nacionale, shteteve federative dhe shteteve konfederative, janë ndërtuar në bazë të një diversiteti etnik*”. (Xhaferi, A.2004).

Jetojmë dhe veprojmë politikisht në shekullin XXI. Çdo popull dhe individ gëzon të drejtën që të prekë dhe përjetojë të mirat që ofron një sistem i lirë në demokraci dhe për mirëqënie sociale, siç paraqitet rasti në shtete skandinave mbi respektimin dhe funksionimin e vlerave të demokracisë. Këto simbolika aktualisht për popullsinë shqiptare në RMV ende mbeten të largëta, përderi sa përfaqësimi politik nuk do të jetë në nivelet e përgjegjësisë shtetërore, morale e shoqërore dhe nuk do të respektojë kriteteret bazë të politikbërjes.

Përfaqësimi i denjë në politikë i një populli, do të thotë edhe mbrojtje dhe respektim i të drejtave kombëtare të tij. Qytetarët shqiptar në këtë shtet e ndiejnë veten të diskriminuar, të pambështetur, të nënçmuar deri në mentalitete bizantine të qytetarit të dorës së dytë. *Adenauer*, në një kohë në mes tjerash do të shprehej: “*Jetojmë të gjithë nën një qiell, por asnjëri s’ka të njëjtin horizont*”.

Në praktikat e sotme, jo vetëm në Maqedoninë Veriore por dhe në vende të tjera, procesi i politikbërjes dallon shumë nga serioziteti i shtetit dhe vënia në zbatim e praktikave ligjore. Para se gjithash këtu nënkuptojmë gatishmërinë e aparatit shtetëror, për të marrë në konsideratë përbërjen multietnike të shoqërisë nga e cila buron fuqia elektorale dhe demografike e shtetit.

Në RMV, kjo praktikë rezulton të jetë e ndikuar nga reflektimi i prurjeve dhe pasojave të politikës së ish-sistemit komunist. Kjo do të thotë se, vendi akoma sot e kësaj dite ndeshet me probleme të ndryshme. Janë të shumta arsyet, të cilat çojnë deri tek dhënia e përgjigjeve të dilemave që mund të shtrohen para opinionit publik në këtë drejtim.

Në radhë të parë mund të pranohet që, jemi në kuadër të një përvoje politike komplekse, ku veçanërisht shteti nuk arrin të dalë nga praktika e një politike të dështuar. Pasojat e saj po ndihen edhe sot, duke lënë të hapur pasoja të tjera për brezat që do të vijnë. Një situatë dyshimi vërtitet mbi opinionin publik, në raport me situatën dhe përvojën e pas viteve të 90-të, pas periudhës së pavarësisë nga ish sistemi dhe shpërbërja e RSFJ-së. Nuk ka dyshim që edhe në situatën që trajtojmë në këtë studim, sistemi politik e ka të vështirë të ndërtojë një klimë besimi pozitive dhe demokratike dhe për më shumë, të krijojë stabilitetin e brendshëm dhe sigurinë publike të një shteti multietnik.

Bazuar në këto parametra, studimi praktik i këtyre dukurive bën të mundur të kuptojmë se, aspiratat e çdo subjekti dhe politike që është vënë në zbatim, ka hasur në një përvojë të brishtë me ndikime delikate, e cila i ka kushtuar shumë të ardhmes së shoqërisë dhe etniteteve që e

përbëjnë atë. Edhe pse pakënaqësitë janë manifestuar në mënyra të ndryshme kohë pas kohe, ato nuk kanë pasur një përkrahje mbarëkombëtare me pretekst të ndryshme, duke ngushtuar hapësirat që problemi të vihej në vëmendjen e faktorit ndërkombëtar.

Në seancat parlamentare të ditëve të fundit në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para mbylljes së sesionit të mbledhjeve parlamentare më datë 25 Qershor të vitit 2015, kjo situatë nuk u diskutua nga deputetët përfaqësues të politikës shqiptare, si jeshë e shumicës së tyre në Parlament. Rasti i mbledhjes së kësaj date korrespondon me seancën e parashtrimit të pyetjeve të deputetëve, drejtuar Kryeministrit të vendit. Heshtja nuk justifikon përgjegjësitë politike para elektoratit shqiptar.

Janë të shumta çështjet për të cilat ata mund të hapnin debatin, veçanërisht për çështje të cilat lidhen me rastin e destabilizimit të kohëve të fundit nga ngjarjet e ndodhura në Maqedoninë Veriore si:

- Ngjarja e Kumanovës dhe vrasjet që ndodhën prej palëve në konflikt dhe humbjet që pësoi popullata shqiptare;
- Bisedat e agjentëve me grupin e armatosur;
- Diskriminimi ekonomik në komunat me shumicë të përbërjes etnike shqiptare;
- Problemet e shumta në arsim;
- Vendbanimet shqiptare të neglizhuara dhe mungesë të kushteve elementare;
- Çështja e zyrtarizimit të gjuhës shqipe, si një nga kushtet e MKO;
- Përfaqësimi i merituar në institucionet e vendit;
- Papunësia;
- Mungesa e regjistrimit periodik të popullsisë, etj.

Këto janë çështje të cilat jo vetëm do të duhej të trajtoheshin në seancat parlamentare, por përfaqësuesit legjitim, bazuar në bashkëpunimin që kanë me partnerin e koalicionit qeverisës, i dhanë hapësirë kryeministrit të asaj kohe (N. Gruevski), që të vepronte duke abuzuar me forcën e pushtetit të tij që të realizonte edhe më tej skenarë dhe projekte antishqiptare.

Ashtu siç janë aktuale tendencat e ndërtimeve të pushteteve sot, të tilla ishin edhe para shumë viteve, në kohë të tilla, ku niveli i politikanëve ishte shumë më poshtë sesa në këtë periudhë dhe ata ndoshta pak kuptonin mbi rolin dhe funksionin e politikës dhe të shtetit, por ishin të bindur që, brenda këtij shteti krahasuar me vendet e tjera, gjërat nuk ishin duke shkuar në drejtimin e duhur. Përderisa të drejtën për arsim dhe kulturë shqiptarët e arritën në situata të dhunshme, u desh si pasojë të ndodhte konflikti i vitit 2001 që ata të fitonin të drejtën për t'u konsideruar si qytetarë të ligjshëm të këtij vendi.

Problemet më thelbësore nuk u futën në rrugën e zgjidhjes, sepse edhe në periudhën që analizojmë, shumë çështje janë zvarritur dhe kanë mbetur pezull. Procese të tilla të pazgjidhura janë në rend të ditës edhe sot për institucionet qendrore të shtetit të RMV. Edhe pas 20 vitësh nga “*ç'rrënjosja*” sistemit të kaluar, ngjarjet që kanë pasuar dëshmojnë se modeli politik dhe sistemi që është zgjedhur kanë probleme.

Në skemat politike të drejtimit të shtetit, në çfarëdo lloj rasti të marrjes së pushtetit, kompromisi politik më shumë i ka shërbyer ecurisë dhe stabilitetit formal, sesa reformave të thella që harmonizojnë marrëdhëniet multietnike brenda shtetit. Kjo situatë e ka konformuar faktorin politik shqiptar me gjendjen pa rrugëzgjidhje.

Në çdo rast të tendencave për ndryshime, sipas qeverisjeve që vijnë në drejtimin e shtetit, nga subjektet politike është shfrytëzuar rasti për të luajtur politikisht me përmirësimin e raporteve etnike dhe shfrytëzimin e tyre nga politikanët, veçanërisht në bllokun maqedonas, pozicioni i të cilit do të vazhdonte të orientohej negativisht në raport me faktorin shqiptar dhe kundër tij. Në këto raste i është dhënë kurajo opinionit publik maqedonas, mbi vendosmërinë politike për të mos bërë lëshime palës shqiptare.

Të bindur dhe të njohur me këto rrethana, të cilat janë pjesë e praktikës së mënyrës së realizimit të proceseve politike në RMV, në vitet e fundit të qeverisjes vërehet një kurs politik më i ekuilibruar mbi raportet etnike dhe politikbërjen në favor të stabilitetit të shtetit multietnik. RMV, si vend i Ballkanit Perëndimor, me interesa ambicioze gjeopolitike, i ndodhur mes përplasjeve lindje – perëndim, nuk arriti të kap nivelet e një politike me standarde perëndimore, duke lënë hapësira boshe në disa drejtime:

- Nuk pati orientim politik të qartë të shtetit që në momentet e para të shpalljes së pavarësisë;

- Mungesa e theksuar e përcaktimit të shtetit multi-etnik brenda përmbajtjes së normës më të lartë juridike kushtetuese, e cila edhe në ditët e sotme është me mangësi;
- Trajtimin e drejtë dhe të barabartë të shqiptarëve në institucionet e shtetit, apo në nivel shtetëror;
- Probleme të tjera të karakterit social – ekonomik, të cilat flasin për mungesën e theksuar të funksionimit të shtetit demokratik dhe pamundësia e shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale në mënyrë transparente dhe profesionale.

Në krizën politike të dy viteve të dekadës së fundit, vështirësia u ndje edhe tek faktori ndërkombëtar, i cili në ndërmjetësim mes palëve nuk arriti të gjente modusin e përbashkët dhe më të përshtatshëm në një marrëveshje politike, për t'i dhënë një shans tjetër të favorshëm Republikës së Maqedonisë së Veriut si shtet, me synimin për të kontribuar në mbarëvajtjen e proceseve politike të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

Në mungesë të një politike të mirëfilltë konstruktive nga pushteti i përfaqësuar nga pala maqedonase, shqiptarët kanë luajtur një rol shumë konstruktiv, duke mos lejuar që kjo situatë të merr trajtat e një konflikti ndëretnik, i cili në këtë rast do të ishte shumë i dëshirueshëm për ta nxjerrë jashtë kontrollit jetën social politike të vendit, duke fajësuar kështu palën shqiptare.

Këto anomali të sistemit politik, të cilat e çojnë shtetin në rrugën e dështimit janë në kundërshtim me çdo formë të një shteti modern të qeverisjes së mirë, aq më tepër kur Republikës së Maqedonisë së Veriut i është hapur rruga si vend me statusin e kandidatit në proceset e anëtarësimit në Unionin Evropian.

Këto tentativa në këtë dekadë u futën në rrugën e dështimit. Kryetari i shtetit; si përfaqësues i kësaj rrymë radikale nacionaliste, duke shfrytëzuar koalicionin politik udhëheqës (VMRO-DPMNE dhe BDI), si përfaqësuese të shumicës nga pala maqedonase dhe shqiptare, të njohura për dështimin e tyre në jetën politike të vendit, dëshmoi edhe një herë mungesën e kompetencës kushtetuese që do t'i shërbente stabiliteti në RMV. Ai zgjodhi formën destruktive të të qenurit politikan, duke nxjerrë ndasitë etnike në opinionin e vendit.

Kjo formë veprimi në kushtet dhe rrethanat e një politike të shumëfaktorëshme; mori kahje më ekstreme në fundin e prillit të vitit 2017, kur opinionin po vetëdijësohej për zgjedhjen në krye të Parlamentit të RMV një përfaqësues nga pala shqiptare. Parametrat e kësaj politike në krizë u bënë të pranishme në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm, duke vënë para përgjegjësisë edhe

faktorin ndërkombëtar, i cili e kishte lënë për një kohë të gjatë jashtë vëmendjes akumulimin e krizës politike në RMV, duke shpresuar në marrëveshjen e brendshme politike.

Nga analiza e situatës, në këtë rast kjo tezë nuk funksionoi. Tendenca e palës maqedonase për të qëndruar me çdo kusht në krye të të gjithë institucioneve qendrore të shtetit u bë e njohur, duke moa mbajtur përgjegjësi për të gjitha rastet e inskenuara për acarimin e krizës dhe për kriminalizimin e faktorit shqiptar. Ky diktat politik nuk lejoi që në këtë shtet të funksiononte sistemi i drejtësisë në mënyrë të pavarur. Ky presion u ushtrua edhe në punën e Prokurorisë Publike Speciale, e cila ka në dorë zbardhjen e të gjitha veprave kriminele.

Shtetndërtimi dhe konsolidimi i nivelit të demokracisë në këto vende të Evropës që pretendojnë të anëtarësohen në BE, sot janë përballë një sprove. Qeveria në ikje e koalizionit VMRO-DPMNE-BDI, brenda tensioneve të krijuara politike dhe sociale, shfrytëzoi rastin për nxitjen e mëtejshme të problemeve ndëretnike, duke provokuar tensione të karakterit ndëretnik, mbi bazën e një projekt të korruptuar dhe jo stabil, për t'i ikur uljes në një tryezë të përbashkët me shqiptarët dhe qartësimin e problemeve të mbetura pezull nga Marrëveshja e Ohrit.

Të bindur që këto forma të politikbërjes në skenën politike nuk ishin të favorshme dhe të dëshirueshme për opinionin shqiptar dhe faktorin ndërkombëtar, të bindur se në një kohë tjetër ata do të përfundonin para drejtësisë, nuk i shërbyen zgjidhjes së krizës dhe stabilitetit të vendit.

Shqiptarëve në RMV iu desh kohë që brenda kësaj periudhe që t'u qëndronin fort aspiratave të tyre dhe të kontribuonin në stabilitetin e shtetit, u ulën në tryezë duke ofruar një platformë të përbashkët politike, së cilës nga debatet e fundit në parlament, pala maqedonase do ta paragjykonte. Partia maqedonase në pushtet në ikje, *(parti e njohur si pjesë e uzurpimit të pushtetit me qëllime nacionaliste, me njerëz të inkriminuar politikisht, të përfshirë në strukturat kriminale)*, përmes qëndrimeve ekstreme e quajti këtë marrëveshje si, **“Platforma e Tiranës”**.

Takimi bëri bashkë liderët shqiptarë të RMV në Tiranë, të cilët përmes kësaj forme në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve, dolën me Deklaratë të përbashkët, në interes të zgjidhjes së krizës dhe stabilitetit të vendit. Në 27 prill 2017, në mjediset e Parlamentit të RMV, u sulmuan fizikisht ashpër dy liderët e partive opozitare maqedonase dhe shqiptare, me pasoja të rënda për shëndetin e tyre.

Kjo sjellje agresive e lejuar nga autoritetet shtetërore përkonte me kohën e vështirë të situatave që kalonte shteti. Koha vërtetoi që partia në pushtet VMRO-DPMNE, organizoi sulmin dhe nuk reflektoi për ta mbrojtur Parlamentin e RMV dhe deputetët e tij. Ky akt i paprecedentë i dha të

kuptojë botës demokratike dhe faktorit politik ndërkombëtar për situatën e rëndë që mbizotëronte në RMV dhe të evidentonte përgjegjësit kryesor të krizës politike. Ata kuptuan qartë objektivat dhe synimet ultranacionaliste të partisë në pushtet. Në opinionin publik kjo ngjarje është njohur si *“beteja e përgjakshme në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”*. Reagimi i turmës dhe njerëzve të skenarit nuk u ndal edhe para ambasadës së SHBA-ve në Shkup, duke synuar dhunimin e saj. Me këtë rsat partia në pushtet shfaqti prirjen e frymës antiperëndimore të saj.

Të aspirosh në të mirën e shoqërisë dhe të sakrifikosh në mbrojtjen e të drejtave të saj demokratike, nuk është e lehtë. Çdo veprë e figurave kryesore të politikanëve shqiptarë në RMV me tendencë të tillë, i kanë shërbyer dhe do t'i shërbejnë të ardhmes së shtetit në bashkëjetës dhe harmoni etnike.

Ky është thelbi i përfaqësimit në një politikbërje drejt një qeverisje të mirë në mbështetje të interesave publike të qytetarëve. Ky është thelbi i qëndrimit demokratik për të krijuar të gjitha premisat për anëtarësimin e vendit në strukturat euroatlantike, drejt BE së dhe vendeve të Paktit të Atlantikut Verior. Këto tendencë dhe apsirata me frymë bashkëpunimi meritojnë të mbahen gjallë, për të krijuar klimën e besimit dhe edukimin e brezit të politikanëve të rinj. Rritja e kapaciteteve politike e profesionale, edukimi mbi bazën e frymës së standardeve perëndimore të demokracisë, janë një garanci drejt një politikbërje të suksesshme, kundër stadi të rezistencës që ende shfaqin rrymat regressive në RMV.

V.3. Decentralizimi fiskal, praktikat diskriminimit etnik në rajonet me shumicë shqiptare

Procesi i ndërtimit të një sistemi politik, demokratik dhe funksionimi i sistemit të ekonomisë së tregut në vendet e Ballkanit Perëndimor, sot përfshin të gjitha reformat politike dhe institucionale, të oreintuara drejt decentralizimit fiskal, duke marrë parasysh të gjithë faktorët veprues në natyrën e veçantë që paraqet rasti i RMV mbi diversitetin politik, ekonomik dhe social etnik në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Decentralizimi politik dhe fiskal, ka arritur të realizojë pjesërisht qëllimet për të ndërtuar një demokraci lokale funksionale dhe një nivel të qëndrueshëm financiar dhe fiskal të komunave dhe rajoneve, duke marrë në konsideratë që, procesi është në dekadën e dytë të zbatimit praktik të tij.

Ristrukturimi organizativ në nivel lokal edhe në këtë vend ka shfaqur veçoritë e tij, krahasuar me disa vende të Ballkanit Perëndimor, të cilët kanë një nivel të qeverisjes vendore; në dy nivele të organizimit lokal, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina përballen me një organizim në tre nivele të

tilla. Kjo mënyrë organizimi shoqërohet dhe dikton praninë e sistemeve të ndryshme të kontrollit mbi financat, duke e bërë të vështirë kryerjen e analizave krahasuese të duhura të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të krahasuara me BE-në (Osmani & Mazllami, 2014).

Hulumtimet e kryera nga institucionet relevante ndërkombëtare si; Banka Botërore, Komisioni Evropian dhe autoritetet fiskale të vendeve që janë marrë si rastet e analizuara, dëshmojnë se vendet e Ballkanit krahasuar me BE-në, kanë nivele të ulëta të decentralizimit fiskal në nivelin 5-6% të BPV-së, që ekuilibrohet me 40-50% të BE-së, ndërsa në krahasim me shpenzimet publike ky nivel arrin në 15-16%, që ekuilibrohet me 55% të BE-së. Organizimi territorial, numri i komunave dhe numri i popullsisë sipas komunave në vende të ndryshme të BE (*Bashkimit Evropian*) dhe BP (*Ballkanit Perëndimor*), reflektojnë specifikat territoriale, ekonomike, etnike, kulturore dhe politike të vendeve të analizuara. Serbia ka numrin më të madh të komunave (170) dhe Mali i Zi ka numrin më të vogël të komunave (21).

Numri i komunave, numri i banorëve dhe informacione të tjera të rëndësishme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë paraqitur në tabelën e mëposhtëme. (tabela nr. 8). Këto informacione janë produkt i një procesi shumë kompleks të vendimmarrjes politike, për tejkalimin e ndërveprimit ndër-rajonat dhe mosmarrëveshjeve politike, si dhe për të zgjidhur ndikimet e zhvillimeve të trashëguara asimetrike në nivel lokal dhe rajonal.

Karakteristikat e përbashkëta të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor, janë përqendrimi i popullsisë më të lartë në kryeqytetit, një fakt i cili shoqërohet me përqendrim të lartë të potencialit ekonomik dhe fiskal që i favorizon kryeqytetet dhe dëmton rajonet e tjera të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Tabela nr. 8: Njësitë e pushtetit lokal dhe popullsia në vendet e Ballkanit Perëndimor

Shtetet	Popullsia	Njësi të pushtetit lokal	Popullsia në pushtetin lokal	Popullsia në pushtetin lokal në %	Përqindja e popullsisë në kryeqytet	Mesatarja e dendësisë në km ²
▪ Shqipëria	4,202,098	61	68,886	NA	14,5%	NA
▪ F B dhe H	2,337,660	80	29,591	13,8%	18,7%	268,75
▪ B dhe H SR	1,433,038	63	23,114	25,4%	15,8%	63,42
▪ Kosova	2,236,963	38	58,867	5,3%	11,4%	290.47

▪ RMV	2,027,697	81	25,033	21,3%	25,0%	85,77
▪ Mali i Zi	620,029	21	29,525	14,3%	30,0%	61,69
▪ Serbia	7,748,519	170	55,836	0,6%	21,0%	395,22
▪ EU-27	--	--	5,580	--	7,0%	116,92

Burimi: WB, (ECSSD) SEE - Municipal Finance Review, LGF in the West Balkans.

Organizimi territorial, numri i komunave dhe numri i popullsisë sipas komunave në vende të ndryshme të BE dhe Ballkanit Perëndimor reflektojnë specifika territoriale, ekonomike, etnike, kulturore dhe politike. Duke analizuar me kujdes të dhënat e tabelës së mësipërme arrijmë të veçojmë dallimet në sasi të numerike, duke synuar në daljen e përfundimeve që në krahasueshmëri kanë interes në përpimësimin e situatës në Maqedoninë e Veriut:

- Kroacia si shtet anëtar i BE dhe një vend që nuk është në qendër të kësaj analize, nuk përfshihet në të dhënat statistike;
- Popullsia e RMV është korrigjuar në bazë të të dhënave më të fundit të Entit të Statistikave; numri i komunave në këtë shtet është 81, në bazë të ndryshimeve legjislative në vitin 2013;
- R. Shqipërisë bazuar në organizimin e ri territorial të komunave në vitin 2015, ka në përbërje 61 komuna (bashki);
- Mali i Zi ka 21 komuna, Serbia 170, Kosova 38, Bosnje Hercegovina 63.

Organizimi territorial i komunave, numri i banorëve, përqendrimi i madh i popullsisë, potenciali ekonomik dhe fiskal në kryeqytetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, imponon nevojën për rivlerësimin e efektivitetit të këtij modeli në një mënyrë funksionale drejt zhvillimit. Organizimi i ri i bashkive dhe rajoneve duhet të përqendrohet në gjetjen e modeleve të reja me shfrytëzim optimal të potencialit njerëzor dhe burimeve ekonomike, duke favorizuar komunat dhe rajonet me më pak zhvillim dhe arritjen e një zhvillimi harmonik komunal, rajonal dhe etnik në të gjitha nivelet.


Të hyrat lokale dhe shpenzimet nga rajonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, treguesit përkatës financiar paraqiten në grafikun nr. 1, të cilat argumentojnë pabarazitë e mëdha që

shfaqen në mes të rajoneve të planifikuara. Rajoni i planifikuar i Shkupit ka potencialin më të madh ekonomik, fiskal dhe investues, të analizuar nga perspektiva e angazhimit të qytetarëve dhe kompanive, si obligues dhe pagues të taksave.

Rajoni i Pollogut është rajoni i dytë bazuar në numrin e popullsisë në RMV, por me të dhëna më e ulëta në renditje, përse i përket zhvillimit dhe potencialit fiskal. Ky fakt demonstroi jo vetëm diskriminimin territorial, por edhe atë etnik, sepse është një rajon planifikimi ku shumica absolute e popullsisë i përket komunitetit shqiptar, i trajtuar padrejtësisht si komunitet jo-shumicë në nivel shtetëror. Sipas treguesit, *"të ardhurat buxhetore bazë buxhetore për çdo banor"*, grafiku shpreh potencialin fiskal të komunave dhe autonomisë fiskale të pavarur nga autoriteti qendror.

Rajoni me potencial më të lartë fiskal është rajoni i Shkupit, me vlerë 2.5 herë më të madh në krahasim me rajonin e Pollogut, i cili është me potencialin më të ulët ekonomik dhe fiskal. Sipas këtij treguesi, të gjitha rajonet e tjera janë nën mesataren fiskale të RMV, fakt që pasqyron pabarazi të mëdha në të gjitha rajonet e tjera, krahasuar me rajonin e Shkupit. Brenda rajonit të Shkupit ka dallime të thella në mes të komunave urbane dhe rurale. Ky fakt argumenton se, asimetria nuk është një veçori dalluese, jo vetëm midis rajoneve, por në të njëjtën kohë, të njëjtat dallime janë krejtësisht të ndryshme në komunat brenda të njëjtit rajon.

Grafiku nr. 1: Të ardhurat e buxhetit bazë dhe transfertave të donacioneve në të ardhurat totale (2014).



Sipas të dhënave, rajoni i Shkupit mbledh të ardhura nga buxheti kryesor 52% ose 10% mbi mesataren e RMV, pavarësisht rajonit të Pollogut, i cili nxjerr vetëm 22% të të hyrave autonome

dhe 78% të të ardhurave fiskale janë transferime në këtë rajon nga qeveria qendrore. Ky proporcion në rastin e rajonit të Pollogut, shpreh brishtësinë fiskale të këtij rajoni, e diktuar në varësinë e qeverisë qendrore për të përmbushur funksionet themelore të qeverisjes vendore, siç përcaktohet nga kushtetuta dhe ligji i komunave.

Në rastin e komunave rurale dhe komunave pjesërisht urbane në menaxhimin e financave publike, dobësia e menaxhmentit të lartë është manifestuar në përcaktimin e numrit të saktë të tatimpaguesve, mbledhjen e tatimeve dhe realizimin e buxheteve komunale, si rezultat i mungesës së burimeve njerëzore cilësore dhe politizimit të administratën komunale (Osmani, 2012). Pozicioni fiskal i qëndrueshëm në aspektin e burimeve komunale të të ardhurave, kanë rajoni i Pelagonisë (36%) dhe Jugperëndim (34%), ndërkohë që pozicioni fiskal i brishtë ka rajonin veri-lindor (22%) dhe rajonin e Vardarit (27%).

Tabela nr. 9: Vlera e pritshme e lejeve të ndërtimit të lëshuara sipas rajoneve (2010-2015-milion denarë)

Viti	RMV	Vardar	Rajoni lindjes	R. Jug-perënd	R. Jug-lindor	Pellagonia	Pologu	R. veri-lindor	Shkupi
2010-2015	252,515	25,156	18,698	38,994	20,316	14,411	30,240	12,252	92,447
Mesatarja në intervalet kohore	42,086	4,193	3,116	6,499	3,386	2,402	5,040	2,042	15,408
Mesatarja në % në 2010-2015	100%	10%	7,4%	15,4%	8,0%	5,7%	12,0%	4,9%	36,6%

Ky proces kishte të ardhura të tjera fiskale për komunën, sepse u përcaktua tarifa për legalizimin (€1-20€) në varësi të llojit të ndërtesave, vendndodhjes dhe destinacionit të objektit. Ndërtimi dhe legalizimi i ndërtesave të banimit dhe biznesit, prodhon më shumë efekte pozitive të shumëzuesit në favor të buxheteve komunale.

Përveç pagesës së tatimit për ndërtim në fazën e shitjes, blerësit paguajnë tatimin mbi qarkullimin me normë (2-4%), bazuar në vlerën e tregut të buldings dhe pas dhënies në

përdorim, pronarët e objekteve bëhen paguesit vjetorë të detyrueshëm të tatimit në pronë sipas normës (0.1-0.2%), bazuar në vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme.

Sot, në kushtet dhe rrethanat aktuale të tendencave të *“krijimit të përvojës së re politike”* në Maqedoninë e Veriut, merre rëndësi çështja e decentralizimit fiskal dhe tendenca që shfaqet në diskriminimin e territoreve me baza etnike shqiptare.

Në planifikimin e strukturave, sa herë që ndërrohen pushtete politike, edhe pse kjo çështje vendoset si prioritet, si një problematikë që kërkon ndryshim imediat, asnjëherë pushteti politik që ka drejtuar shtetin i kënë bërë premtimet letër syrtarësh, duke vazhduar të zbatojnë politika shumë destruktive, pa zgjidhjet e duhura.

Kjo situatë fiskale, sikundër edhe shumë problemeve të tjera që trajtohen sipas përfaqësimit të elementit etnik, shfaq një anë të errët të shtrytëzimit ekonomik të zonave, duke privilegjuar zonën qendrore dhe lindore të RMV. Krahas tendencave të rregullimit të raporteve ndëretnike, elementi i decentralizimit fiskal në vazhdimësi do të përbëjë një nga elementet shumë të ndjeshëm në planifikimin e politikbërjes në rastin e RMV.

V.4. Vende të rajonit-Kosova, përmbushja legislative e të drejtave të etnive joshumicë si detyrim kushtetues, mesazh për RMV

Në natyrën e studimit të temave të kësaj fushe, aspekti i krahasuar me një vend të afërt, i cili në pikëpamje gjeografike edhe për shumë arsye të tjera, qëndron i afërt me përvojën që mund ta ndajë me një vend siç është RMV, nuk do të ishte e tepërt t'i referohemi rastit të Republikës së Kosovës. Duke e gjykuar faktin, Kosova si një nga vendet fqinje të rajonit mund të jepte një mesazh me përmbajtje shumë pozitive, për të krijuar një ambient normativ shumë të lakmueshëm, që korrespondon me kërkesat e praktikave ndërkombëtare mbi garantimin e të drejtave themelore të njeriut dhe aspekteve të vlerave universale.

Në këtë këndvështrim, aspekti krahasues vjen në shprehje në një moment, kur analizohen dhe studiohen në detaje çështje të qasjes normative, duke dhënë një qëndrim të qartë në raport me kushtetutën e Republikës së Kosovës mbi të drejtat themelore dhe garantimin e lirive të tjera mbi dispozitat themelore të kushtetutës së vendit. Nga përmbajtja e neneve fillestare të Kushtetutës, krijohet përshtypjen e një vendi me Kushtetutë të një shteti me vlera demokratike, pa dashur të komentojmë aspektin e rregullimit normativ dhe sistemin juridiko-kushtetues të Kosovës.

Studimi merr parasysh dimensionin, i cili tregon gatishmërinë për të vendosur garantimin ligjor për çështje për të cilat shqiptarët në RMV sot ndeshen me probleme të natyrës së mosfunksionimit të sistemit juridik të mirëfilltë, që iu përkushtohet të drejtave themelore dhe aspekteve të vlerave të tjera të rëndësishme për shoqërinë. Këtu për argument, mund të shkëpusim pjesë të neneve, të cilat iu përkushtohen të drejtave themelore:

- *Neni 5 [Gjuhët] 1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. 2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune, ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.*
- *Neni 6 [Simbolet] 1. Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës, të cilat pasqyrojnë karakterin shumëetnik të saj. 2. Pamja, mënyra e përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe simboleve të tjera shtetërore, rregullohen me ligj. Mënyra e përdorimit dhe e mbrojtjes së simboleve kombëtare rregullohet me ligj.*
- *Neni 7, Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. - 3 - 2.*
- *Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore. (Kushtetuta e R. Kosovës, 2015). Burimi: Marrë nga: <http://www.kryeministriks.net/docs/Kusht.e.RK.pdf> (parë më nëntor, 2015).*

Këto janë disa nga konceptet bazike, me të cilat mund të bëhet një analizë krahasuese se si këto nene me përmbajtje demokratike, të bëhen pjesë e lëgjislationit kushtetues edhe në përfshirjen e interesave të shqiptarëve dhe etnive të tjera në Maqedoninë Veriore, pra ato të gjejnë hapësirën e domosdoshme në kushtetutën e Maqedonisë Veriore.

Në të tilla situata me shume probleme të diferencuara, proceset politike në Ballkan, sigurisht që nuk mund të pretendohet që kanë arritur të krijojnë një klimë të shëndoshë politike, e cila do të ishte e denjë për të krijuar një model ndaj një vendi tjetër të rajonit, aq më shumë kur flitet për çështje themelore të të drejtave të etniteteve joshumicë brenda shoqërive të këtyre shteteve. Në analizat e mëposhtëme përvojat e shteteve, të cilat vijnë si rezultat i gjykimit të proceseve politike që zhvillohen në RMV dhe në shtete e tjera rrotull saj, rasti i paraqitur i Republikës së Kosovës merr një rol të rëndësishëm në politikën e gjithëmbarshme në Ballkan.

Duke marrë në konsideratë mendimet e njohësve më të mirë në fushën e administrimit publik dhe në sferën e politikbërjes, nga elementet e intervistimit që janë realizuar në këtë studim, opinionet e dhëna krijojnë bindjen se: Në sistemet demokratike, siç është edhe shteti i Kosovës, vendimmarrja, përfshirë dhe administrimin publik, është e definuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por edhe në ligjet që adresojnë fushat për të cilat bëhet fjalë, në këtë rast për

administratën publike. Janë të rregulluara këto çështje në kuptimin e gjithëpërfshirjes së komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Parlamenti i Kosovës, sidomos në raste kur merren vendime dhe janë në pyetje interesat e minoriteteve, iu jep mundësinë atyre që të kenë një lloj mekanizmi, vendimet apo miratimi i ligjeve që merren në Republikën e Kosovës, për çështjet që kanë të bëjnë me minoritetet, votimi bëhet i dyfishtë, pra, duhet të respektohet që 1/3 e pjesëmarrjes së minoriteteve ta votoj atë vendim, ligj apo rezolutë. Gjithashtu në kuadrin e veprimtarisë së Qeverisë së Kosovës, ka pjesëmarrje të minoriteteve, një çështje kjo e rregulluar me Kushtetutë në kapitullin për minoritetet. Rregullisht Qeveria e Kosovës ka të rezervuar tre vende ministrore, që janë dy për serbët dhe një për komunitetet tjera, si dhe një Zv. Kryeministër plotësohet nga minoritetet. Në këtë mënyrë përballemi me një sistem të demokracisë, të ashtuquajtur demokraci koncesionale apo të garantimit të pjesëmarrjes së minoriteteve në qeverisjen e vendit dhe në vendimmarrjen e tij. Për më tepër, në nivelin lokal, minoritetet gjithashtu janë të përfaqësuara në asamblетë komunale edhe udhëheqjet komunale.

Në Kosovë mund të thuhet se, në raport me minoritetin serb kemi politika shumë të hapura, ndoshta janë edhe përtej standardeve, sepse minoriteti serb nuk ka dalë në regjistrim për ta ditur numrin e saktë, por pak a shumë përbëjnë 5% të popullsisë së përgjithëshme. Në fakt ky komunitet arrin të qeverisë 10 komuna, që nënkupton gati 25% të pushtetit vendor në Kosovë. E krahasuar me rastin e RMV, ku shqiptarët përbëjnë mbi 25% të popullsisë së përgjithëshme (të dhënat tregojnë edhe më shumë), sado që regjistrimi i popullsisë ka dështuar dhe këto nuk janë statistikë reale, megjithatë qeverisja komunale e shqiptarëve në RMV nuk e plotëson këtë kriter numerik. Përfaqësimi është rreth 10%, madje gjuha shqipe si gjuhë zyrtare duhet të ishte e lejuar në mbi 25%, ndërkohë që gjuha serbe është gjuhë zyrtare në Kosovë.

Minoritetet në procesin e vendimmarrjes. Nga këndvështrimi i vlerësimeve të popullsisë shqiptare në RMV, krahasuar me popullsinë serbe në Kosovë, nuk mund të bëhet të arrihet një mendim unik, sepse serbët në Kosovë janë minoritet ndërsa shqiptarët në RMV janë popullsi shtetformuese të barabartë me maqedonasit. Mungesa e këtij statusi ka shkaktuar shumë probleme në politikbërja, një praktikë që gradualisht në dekadën e fundit është futur në rrugën e zgjidhjes.

Marrëveshja e Ohrit deri në një kufi të caktuar i ka realizuar të drejtat legjitime të shqiptarëve në RMV, por siç vërtetoi praktika kjo marrëveshje e deformua dhe u zvarrit nga autoritetet shtetërore, duke e dobësuar gradualisht pozitën e shqiptarëve. Realiteti është ende larg asaj që

pretendohej të arrihej, për shkak të qëndrimit të subjekteve politike shqiptare, të cilat duhet ishin këmbëngulës në kërkesat e tyre për zbatimin plotësisht të Marrëveshjes Kornizë.

RMV ende është në kohë që mund të marrë përvojë nga Kosova rreth përfshirjes së barabartë (*në baza etnike*) të shqiptarëve në institucionet kyçe. Edhe pse krahasimi nuk mund të bëhet mes shqiptarëve të RMV dhe serbëve në Kosovë, prioritet është praktika e Kosovës në drejtim të respektimit të të drejtave të minoriteteve. Ky shembull duhet marrë në konsideratë të praktikën dhe teorinë politike të funksionimit të një shteti multietnik.

Kjo përvojë apo ky koncept politik që respektohet së pari nga një shumicë absolute shqiptare në Kosovë, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është shfaqur koncepti demokratik i funksionimit politik të shtetit. Shteti u takon të gjithë qytetarëve dhe ata duhet të marrin pjesë në vendimet që prekin interesat qytetare, si një nga parimet bazë të politikbërjes. Nga ana tjetër, praktika e Kosovës duhet të kenë ndikim veçanërisht në drejtuesit politik dhe të shtetit, sepse shoqëria në këtë vend e ka të nevojëshme transformimin e mentalitetit shoqëror dhe klimës së besimit në RMV.

Nuk mund të gjykohet më me koncepte të tilla të njëanëshme përballë një realiteti shumë etnik në RMV. Në më shumë se 25 vite nga shpallja e pavarësisë së shtetit, duke jetuar me popullsi të ndryshme, përgjithësisht janë shfaqur tendenca drejt konceptit monoetnik, një qasje negative që nuk i shërben interesave publike të qytetarëve dhe politikbërjes së mirë.

Me këtë rast, analiza rekomandon ndryshimin e konceptit bazë mbi funksionimin e shtetit në RMV, duke i shërbyer politikave të programuara me bazë kushtetuese mbi shumëetnicitetin, ku veçanërisht popullsia shqiptare duhet të vlerësohet e barabartë me popullsinë maqedonase. Kjo mënyrë trajtimi respekton autoktoninë, por jep hapësira më shumë për pjesëmarrjen në politikë, duke respektuar edhe minoritetet e tjera.

Praktika politike e vlerësimit të shqiptarëve si minoritet në këtë shtet, është e gabuar dhe me pasoja. Të dy vendet fqinje, si Kosova dhe RMV janë vende që aspirojnë për t'u futur në NATO dhe në BE, dhe si të tilla ato janë si përvoja në rrugën e gjatë të zbatimit të standardeve demokratike. Rregullimi i këtyre marrëdhënieve me qytetarët do të çojë më shumë frymë besimi në pranimin dhe zbatimin e doktrinë së funksionimit normal të shtetit demokratik të së drejtës, ku respektimi i të drejtave njerëzore do të mbetet koncepti bazik për një politikbërje të suksesshme me pjesëmarrjen e gjerë të qytetarëve në vendimarrjen e saj.

Standardet evropiane përsosen në rrugën e zbatimit të tyre, duke iu referuar përvojave pozitive të mirëfunksionimit të shtetit në demokraci. Shtetet e reja apo dhe ato ekzistuese në Ballkanin Perëndimor, në shumë raste të keqpërdorimit të pushtetit politik, në vend që të bëjnë hapa përpara në ndërtimin demokratik të shtetit, nuk e konsiderojnë këtë kërkesë si shprehje të vullnetit politik të udhëheqësve ballkanikë, por si një procedurë imponimi e ekzistencës dhe kërkesave evropiane për standardet demokratike.

Kjo është një praktikë e gabuar që në analizën e saj sjell shumë përfundime shqetësuese. Në fakt për nevojat që kanë shtete e rajonit dhe për shumë arsye të imponuara ngë kushtet e vështira ekonomike e sociale, do të duhej të ishte e kundërta.

Imponimi që i bëhet në këtë mënyrë klasës politike në vendet e Ballkanit zbehin vlerat e demokracisë dhe nuk krijojnë mjedisin e nevojshëm që këto kërkesa dhe nevoja të jenë në koherencë me njera - tjetrën.

V.4.1. Gjeneza e diskriminimit etnik në përfaqësimin institucional

Autorët e ndryshëm, duke u bazuar në të dhënat e burimeve historike ofrojnë shënime pak a shumë reale për rrugën politiko-gjeografike e historike dhe të zhvillimeve sipas epokave në RMV. Georges Castellan, në librin e tij *“Histori e Ballkanit”* thekson:

“Maqedonia si emër daton që nga kohërat antike. Ajo përmendet në veprat e autorëve antikë... Por, prejardhja e emrit “Maqedoni” është e errët. Në lashtësi, diskutohej nëse banorët e kësaj krahine që shtriheshin në veri të Heladës, ishin grekë apo thrakas të helenizuar. Nën udhëheqjen e Filipit II dhe Aleksandërit, Maqedonia fitoi emër, i cili do të përmendet edhe gjatë periudhave të mëvonshme historike, si provincë apo si shprehje gjeografike. Ai gjithashtu thotë se: Aleksandri, i quajtur i Madh, u bë kampion i një panhelenizmi që sundoi Azinë e Vogël, Egjiptin, Azinë Jugperëndimore dhe zotëroi krahinat deri në Indi. Por, perandoria e tij nuk mundi të qëndrojë unike pas vdekjes së tij. Ajo u copëtua midis ushtarakëve të Aleksandërit. Ndërkaq, Maqedonia “origjinale” (ajo Ballkanike), u përpoq të mbajë kontrollin mbi Greqinë, por u përfshi në luftëra të shumta në mes qyteteve të Heladës. Grindjet midis pasardhësve të Aleksandërit, i dhanë rastin Senatit romak të ndërhyjë në gadishull. Gjatë shekullit III e II para e. së re, legjionet romake u dukën në bregun lindor të Adriatikut dhe pasi i mundën ilirët, i nënshtruan maqedonasit dhe grekët. Kështu i gjithë gadishulli u gjend nën një pushtet të vetëm, nën atë romak” (Castellan, G. 1991) Në tekstin “Histori e Ballkanit”, Çabej, Tiranë.

Autor tjetër si Edwin E. Jacques në librin *“Shqiptarët”*, vëllimi I, thotë:

“Kur Filipi II u lirua si peng që ishte në Tebë dhe u kthye në atdhe, në Maqedoni, në v.359 para e. së re hyri në fronin mbretëror duke caktuar rezidencën dhe kryeqytetin e monarkisë maqedonase në Pela, afër Selanikut.

Në fazën e parë të strategjisë së tij kombëtare ishte bashkimi i vetë Maqedonisë. Pasi Filipi u shqua si një udhëheqës i fuqishëm, kjo bëri që të fitonte besnikërinë e krerëve të fiseve dhe të krijonte ndërgjegjen kombëtare maqedonase.

Sa me bindje e sa me forcë ai krijoi aleancën e fiseve të pavarura në malësinë perëndimore. Duke u martuar me Olimbinë, krijoi një aleancë të ngushtë me Molosët e Epirit. Gjithashtu, Filipi arriti t’u shkëpuste atinasve disa prej kolonive të tyre tregtare përgjatë bregut të Egjeut. Kështu për herë të parë

në histori të tri mbretëritë pellazge: Maqedonia, Epiri dhe Iliria, dmth. Shqiptarët e hershëm, u vunë nën një prijës, nën mbretin Filip II. ... Aleksandri III, biri i Filipit, i njohur edhe me emrin Leka, lindi në korrik të vitit 356 para e. së re, në Pela". E. Jacques, E. (1996) "Shqiptarët"- vëllimi I, Kartë e Pendë, 132-133 dhe 137. Ideja për një Maqedoni si shtet lindi nga fundi i shekullit XIX. Atëherë doli në skenë një lëvizje e fuqishme, që njihet me emrin VMRO.

Sipas platformës politike të saj, RMV do të duhej të ishte një **"Zvicër ballkanike"** ku do të jetonin në barazi të plotë bullgarët, shqiptarët, turqit, vllehtë, grekët, etj. Duke u nisur nga parimet e lartpërmendura dhe arsyet e krijimit të shtetit maqedon, përkundër situatës së imponuar, në vitin 1903 shpërtheu kryengritja, e cila njihet me emrin **"kryengritja e Ilindenit"**. Ngjarjet kryesore të saj u zhvilluan në hapësirat ku jetonte shumica shqiptare. Për shkak të karakterit çlirimtar të kryengritjes së Ilindenit, shqiptarët morën pjesë aktive në të. Këtë e dëshmojnë shumë autorë maqedonas, të cilët kanë shkruar për këto ngjarje.

Shteti i sotëm, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë apo, sot me emrin e ri RMV, shtrihet midis Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës. Sipas pozitës gjeografike, ajo përfshin hapësirën, ku kryqëzohen rrugët dhe hekurudhat në drejtimin Veri-Jug, që lidhin Greqinë dhe Kosovën me Serbinë ashtu sikundër edhe vijat e komunikimit Lindje - Perëndim, që lidhin Shqipërinë me Bullgarinë. Shkupi është një nga nyjet kryesore komunikuese në Maqedoninë e Veriut dhe në Ballkan. Popullsia që jeton brenda kufijve të Republikës së Maqedonisë Veriore, sipas statistikës zyrtare përbëhet kryesisht nga: maqedonas, shqiptarë, turq, vllehtë, rom, serb, bullgarë etj. Përbërja e larmishme e popullatës në RMV, është rrjedhojë e së kaluarës historike.

Dyndjet dhe kalimet e popujve të ndryshëm nëpër Gadishullin Ballkanik si dhe pushtuesit e shumtë të këtyre trojeve, kanë lënë gjurmët e tyre në Maqedoninë Veriore, sikurse në vendet e tjera fqinje. Banorët më të lashtë të Maqedonisë së Veriut, që përmenden tek autorët antikë grekë e romakë, janë fiset ilire, trakase dhe helene. Këto të dhëna lënë të kuptojmë se sot, trashëgimtarët e banorëve më të vjetër të këtij shteti, janë shqiptarët, të cilët me shekuj jetojnë këtu. Kjo për shkak të një fakti shumë të qartë, se pasardhësit e ilirëve janë shqiptarët, pasardhësit e helenëve janë grekët, ndërsa si pasardhës të trakëve të vjetër nuk përmendet ndonjë popull i sotëm, përpos hapësirës gjeografike **"Trakia"**, që shtrihet në Bullgarinë e sotme. Historianët sllav përpiqen që të dëshmojnë se populli i sotëm maqedonas është pasardhës i maqedonasve antikë (*gjë që me të fuqishëm e konteston Greqia edhe pas shpalljes së R. së Maqedonisë së Veriut si shtet sovran në Tetor të vitit 1991*).

Ky trajtim historik nuk është objekt më vete i studimit, por për shkak të politikës ditore maqedonase, për të arsyetuar krijesën dhe ekzistencën e shtetit të sotëm **"Republika e**

Maqedonisë së Veriut”, ata dëshirojnë ta paraqesin si vazhdimësi historike e Maqedonisë antike. Por, për saktësinë “*shkencore*” të teorisë sllave, nuk ekzistojnë fakte relevante në historiografinë e huaj.

Përprjekja e maqedonasve në këtë drejtim është një orvajtje që buron nga praktikat e tendencave të krijimit të kombeve të reja, siç ka ndodhur edhe me kombin boshnjak. Periudha e shkurtër e ekzistencës së shtetit dhe fryma nacionaliste, vazhdojnë të nxisin qarqet shkencore me prapavija nacionaliste për të ushqyer frymën historike pa histori dhe me deformime të papranueshme edhe në historiografinë rajonale e botërore. Historia e lëvizjeve të popullsive në Europës dhe Ballkan nuk mund të pranojë qasje antishkencore që injorojnë elementët më të spikatur të autenticitetit të tyre.

Procesi i dyndjeve sllave dhe kolonizimi prej tyre i tokave në rajonin ballkanik, pati pasoja dhe reagime të mëdha prej popullsive ilire të gadishullit. Grupe të ndryshme sllave në shekullin VI u vendosën në rrethinat e Selanikut (*qendër e rëndësishme ballkanike*). Kolonizimi sllav mori përmasa të mëdha në shekullin VII. Perandoria Bizantine në këtë periudhë ishte në luftë me Persinë dhe nuk ishte në gjendje të ndalte procesin e depërtimit të tyre. Si rezultat i kolonizimit sllav, u ndërrua struktura etnike e hapësirave Ballkanike. Në “*historinë e popullit maqedonas*” thuhet:

“Me shndërrimin e Maqedonisë në tokë sllave, u krijua simbioza midis sllavëve të ardhur dhe popullsisë vendase maqedonase (që ishte pakësuar). Si rezultat i simbiozës midis sllavëve dhe popullsisë së vjetër vendase maqedonase, pak nga pak tek sllavët u imponua emri i vjetër i vendit “Maqedoni”.

Në këtë mënyrë, pas **asimilimit definitiv** të popullatës së vjetër maqedonase, nga etnosi sllav, erdhi në shprehje “*populli-etnosi*”. Shih. ”Institut za nacionalna istorija, (2000) “Istorija na makedonskiot narod“, II, Shkup, 287. Në **aspektin juridiko-kushtetues, Preambula e Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut**, nuk është e shënuar me emrin “*Preambulë*”, por si e tillë, ajo përbën dy aspekte:

Në planin e parë, theksohen momentet më të rëndësishme për zhvillimin shtetëror-juridik të shtetit të RMV. Si rezultat i kësaj theksohet se, RMV është e konstatuar si shtet nacional i popullit maqedonas, ku sigurohet barazia e plotë civile dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptaret, turqit, vllehtë, romët, etj.

Në planin e dytë, përcaktohen qëllimet që synoheshin me këtë kushtetutë, që “*Republika e Maqedonisë së Veriut*” të konstituohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet civil dhe

demokratik, qeverisja e drejtësisë, liritë dhe të drejtat e njeriut, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa...

Preambula përmbante konceptin e shtetit nacional, ndërsa synonte të zhvillohej si “shtet sovran i pavarur dhe si shtet civil e demokratik” (al.2). Në konceptin politik,

- Preambula nuk ka fuqi juridike por ka rëndësi politike;
- Ajo paraqet burimin e të drejtës kushtetuese, Gjykatat kushtetuese e përdorin si bazë për interpretimin e tekstit normativ;
- Marrëveshja Kornizë e Ohrit (*aneksi “A”*), si bartës të sovranitetit përkufizon shtetasit.

Në kushtet e drejtimit të shtetit nga qeverisja e re pas dekadës që analizohet në këtë studim, ky koncept politik është ndryshuar. Kompromisi politik u arrit me amendamentin IV, në kombinimin e konceptit të individit dhe shtetit kombëtar, me tekstin e Preambulës me këtë përmbajtje:

“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë Veriore, populli maqedonas si dhe qytetarët që jetojnë brenda kufijve të Maqedonisë së Veriut, që janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit serb, popullit vllah, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerët”. (Kushtetuta e RMV, 2018)

Kjo është një qasje e re, por jo kosequnente deri në fund ndaj konstituimit të shtetit të Maqedonisë së Veriut, pavarësisht se shqiptarët dhe të tjerë etni përcaktohen si pjesëtarë të pakicave kombëtare, atyre u njihet atributi i konstituimit të RMV si atdhe i tyre, u njihen meritat e tyre për konstituimin e shtetit si shtet sovran e i pavarur, duke u barazuar në përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre në shtetin e përbashkët. Për ta argumentuar këtë përmbajtje kushtetuese, po i referohemi strukturës së ***Tekstit normativ të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut:***

- *Dispozitat themelore Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut;*
- *Organizimi i pushtetit shtetëror;*
- *Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut;*
- *Pushteti lokal;*
- *Marrëdhëniet ndërkombëtare;*
- *Mbrojtja e vendit, gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme;*
- *Ndryshimi i Kushtetutës;*
- *Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. (www.sobranie.mk)*

Në kushtet e ndryshimit të pushtetit politik dhe marrjen e drejtimit të vendit nga koalicioni LSDM-BDI, një nga objektivat kryesorë politik ishte ***pranimi i amendamenteve kushtetuese për përmirësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut*** në raport me praktikën politike të ndjekur më parë:

Për herë të parë është plotësuar me dy amendamente të vitit 1992, me heqjen e dyshimit se Maqedonia e Veriut nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje, (Amendamenti I) dhe se me rastin e përkujdesjes për pozitën e pjesëtarëve të popullit maqedonas në vendet fqinje, Republika e Maqedonisë së Veriut nuk do të përzihet në të drejtat sovraane të atyre shteteve dhe në punët e brendshme (Amendamenti II);

Amendamentet në bazë të Marrëveshjes Kornize të Ohrit të vitit 2001;

Amendamentet në sferën e pushtetit gjyqësor 2005;

Me Amendamentin XIX u përcaktua mundësia dhe rastet për anashkalimin e parimit të pacenueshmërisë së letrave dhe formave të tjera të komunikimit;

Me miratimin e Amendamenteve XX deri XXX, u bënë ndryshime thelbësore të zgjidhjeve ekzistuese kushtetuese, në fushën e sistemit të jurisprudences, duke krijuar premise për reformën në Drejtësi;

Në 11 janar 2019 njihen ndryshimet e fundit për miratimin e amendamenteve 33, 34, 35, 36 të propozuar nga Qeveria dhe duke pranuar propozimet e dy partive më të mëdha shqiptare. Amendamentet ishin pjesë e Marrëveshjes së Prespë qershorin e vitit 2018 midis Athinës dhe Shkupit. (d.d/BalkanWeb, www.sobranie.mk)

Duke vlerësuar këto ndryshime, sot në Kushtetutën e RMV marrin rëndësi dy nenet kryesore, të cilat përfaqësojnë thelbin e shtetit demokratik:

Neni 1: *Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social. Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pambartshëm.*

Neni 2: *Në Republikën e Maqedonisë sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë pushtetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë. (www.sobranie.mk)*

Shikuar në këndvështrimin historik, mungesa e skajshme e trajtimit të çështjes së shqiptarëve në RMV, ka qenë një trashëgimi e problemeve që sistemi politik i mbarti nga ish sistemi monist. I trashëguar si problem brez pas brezi deri në dekadën që analizon studimi, në forma indirekte dhe jo si qëllim në vetëvete, do të ishte bërë e mundur të gjallërohej përfaqësimi gradual në institucionet e shtetit i pozitës së shqiptarëve në RMV.

Anashkalimi dhe formaliteti u bënë pjesë e politikbërjes në shtetin maqedonas, duke e zvarritur nevojën për harmoni dhe ekuilibër të funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë, deri në ngjarje tragjike me efekte në rajon. Mungesa e klimës së bashkëpunimit nga pushteti shtetëror, solli mungesën e vullnetit politik për ti dhënë një dimension të shëndetshëm të drejtave njerëzore brenda shtetit multietnik. Mes të tjerash Arbën Xhaferi do të shprehej:

“Në fëmijërinë time, Tetova ishte e ndarë në dy tabore, në atë institucionale dhe atë jashtëinstitucionale. Maqedonasve u takonin institucionet, ndërkaq, shqiptarëve u takonin rrugët, lumenjtë, natyra. Na dënonin në mënyrë institucionale, ndërsa shqiptarët ua kthenin me “street fighter”-a, për të dëshmuar se pjesa jashtëinstitucionale u takon atyre. Për këtë sfidë, ata nuk kishin përgjigje. Një kohë sillnin elemente violente, me mendësi dinarike, të ngjashëm me shqiptarët, kryesisht nga Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina, por kot. Pastaj sollën të ashtuquajturit maqedonas të egjeut, (i quanin “egejca”) por edhe ata shumë shpejt kuptuan se janë në një mision të pamundshëm. (Zona Express, dedikuar figurës së liderit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Arbën Xhaferi) (Marrë nga: <https://www.youtube.com>).

Teoritë politike nuk do të ishin të mjaftueshme për të sqaruar mirëfunksionimin e një shoqërie me këto kushte komplekse siç janë manifestuar problemet në Maqedoninë e Veriut. Klima e mosbesimit e shkaktuar nga nxitja e pakënaqësive të palëve etnike në konflikt, do të sillte një qasje të re në studimin e kësaj praktike, duke e marrë jetën social politike në RMV si një shembull specifik me vlera teoriko – praktike.

Thjeshtë paraqitja e një “rokade” të politikës, e cila përveçse ndërrimit të pushteteve, jepte një skemë shumë interesante, ***ku partitë politike edhe pse me programe të kundërta nacionaliste, në jetën politike për hatër të pushtetit dhe vazhdimësisë së shtetit, u kristalizua ndarja e koalicioneve politike, pozitë – opozitë, si në anën maqedonase e po kështu në anën shqiptare.*** Një model specifik që meriton vëmendje studimore. Një arsye më shumë për të mos krijuar qasje të reja në mundësinë e thellimit të reformave të jetës së vendit, duke e bërë zhvillimin strategjik të vendit objekt të politikave të ditës.

Rendi juridik i një shteti mund të vlerësohet nga aspekti i pranimit të normave demokratike brenda një kushtetute. Baza juridike e një shteti nëse nuk është e shëndoshë, vështirë se mund të flitet për vlera të tjera që e përcaktojnë rolin e funksionimit të mirëfillt të shtetit demokratik dhe të një sistemi të paraparë sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare për një vend me karakter multietnik, siç është rasti i RMV. Në kushtetutën e shtetit pjesa e preambolës trajtohet në këtë mënyrë:

*Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale dhe për krijimin e shtetit të vetë, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevs dhe vendimeve historike të KAÇKM-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si Republikë sovranë në Federatën Jugosllave, nga vullneti lirisht i shprehur i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është **konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas** në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në RM”.*

Të vendoset dhe ndërtohet sundimi i së drejtës si sistem themelor i pushtetit; Të vendoset apo të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale;

Të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa e popullit maqedonas, me kombësitë që jetojnë në RM. Të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, miraton KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”. (Pjesë të Kushtetutës së RM Veriut-të vitit, 2001).

Në përmbajtjen e preambulës në asnjë rast nuk përmendet RMV si një shtet dhe shoqëri **multietnike**, por thuhet: *“Shtet nacional i popullit maqedonas, duke nënvizuar më pas në vijim të paragrafit se “sigurohet barazia e plotë qytetare e bashkëjetesa e kombësive të tjera”* (Gazeta zyrtare nr. 08-4642/1, Shkup:17.11.1991). Ana simbolike e përkrahjes së popullsive të tjera nuk mjafton për veçoritë karakteristike të multietnicitetit në RMV.

Përfshirja formale në jetën social – politike e shqiptarëve dhe popullsive të tjera, i dha natyrë formale edhe politikbërjes institucionale, duke frenuar vlerat e reformave demokratike. Për ta konkretizuar këtë formalitet, tregues kryesor janë vetë statistikat e shtetit maqedonas sipas të dhënave zyrtare, pas konfliktit të vitit 2001 e në vijimësi deri tek të dhënat në vitin 2016 të të punësuarve në sektorin publik, duke e marrë në konsideratë përkatësinë etnike.

Pasqyrimi i qartë në këtë material studimor i një sërë tabelave dhe grafikëve, janë një realitet problematik, që vërtetojnë diskriminimin etnik jo të rastësishëm. Baza juridike e këtij trajtimi fillon dhe mbështetet në Kushtetutën e vendit. Përfundimet që përfitojnë nga kjo analizë, janë një argument i fortë në vërtetimin e hipotezave kryesore të studimit, duke dhënë mundësinë e evidentimit të qasjeve të reja me karakter politik në inteers të përmirësimit të politikbërjes në Maqedoninë e Veriut.

Nga një studim i realizuar nga Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes (QKSM), u dhanë disa opinione shumë të qarta, të cilat korrespondojnë me qëndrimet e një përfaqësimi më të denjë dhe të ndarë edhe në dikastere të tjera relevante në organet e pushtetit, brenda autoriteteve vendimmarrëse në Qeverinë e RMV. Vlen të theksohen disa përfundime që dalin nga raportet e kësaj qendre:

“Marrëveshja e Ohrit vendosi një theks të veçantë mbi përfaqësimin e barabartë (proporcional me përbërjen e popullsisë) për të adresuar përjashtimin e mëparshëm të bashkësive etnike nga administrata shtetërore dhe për të siguruar ndarjen më të drejtë të pushtetit. Gjatë viteve të fundit vihet re një përmirësim i rëndësishëm në përfaqësimin e shqiptarëve në administratën shtetërore, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin, por kuotat e plota ende nuk janë arritur. Ndërsa nuk ka njohje në mesin e shqiptarëve që “Përfaqësimi i drejtë nuk është vetëm në lidhje me numrat, por në lidhje me ndarjen e pushtetit dhe sigurimin e besnikërisë ndaj shtetit”, dhe” kjo nuk mund të ndodhë brenda natës”.

Në qasjet e reja që vijnë si rrjedhojë e analizës politike, në paërfaqësuesit politik maqedonas, ekziston një perceptim i gabuar, që ata nuk kanë vullnetin politik dhe ende nuk janë të gatshëm për t’i dhënë shqiptarëve pozicione në pushtetin qëndror të drejtimit të shtetit. Disa dikastere që kanë të bëjnë më çështje të sigurisë kombëtare, të ligjvënies, të financave apo të politikës së jashtme, kanë qenë sektorë të ndaluar për drejtuesit shqiptarë, të justifikuar se palës shqiptare i mungojnë ekspertët e nëvishëm profesionistë për të drejtuar në këto fusha.

Në krahun tjetër, shqiptarët vazhdojnë të ankohen se, kryetarët e komunave maqedonase të komunave ku ata janë të përfaqësuar deri në 20%, nuk janë të interesuar në zbatimin e shtetit ligjor. Punonjësit e institucioneve shtetërore rrallëherë u përgjigjen qytetarëve në gjuhën shqipe. Ashtu sikurse çështja e gjuhës vazhdon të jetë një problem i shtruar për zgjidhje, qeverisjes së re në RMV do t'i duhet të përshpejtojë zbatimin e ligjeve ekzistuese në përmirësimin e raporteve ndëretnike dhe të politikbërjes.

Asaj do t'i duhet të marrë në konsideratë zgjerimin e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore në Shkup, ku shqiptarët zyrtarisht, përbëjnë 21% të popullsisë dhe më shumë se 20% në katër nga dhjetë komunat e zonës nr. 2. Për të forcuar konceptin që, Shkupi është kryeqyteti i një shteti të unifikuar multietnik, zyrtarët duhet të promovojnë dygjuhësinë, duke filluar me shenjat rrugore në komunikacion.

“Ekzistojnë edhe tri fusha të rëndësishme që kërkojnë vëmendje për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni: Përfaqësimi i drejtë, (sidomos përfshirja e më tepër shqiptarëve në postet e larta), decentralizimi, dhe zbatimi i plotë i ligjit për gjuhët. Korniza e fuqishme institucionale për promovimin ndëretnik të dialogut në nivel kombëtar dhe lokal është minuar nga një mbështetje e dobët politike, koordinimi dhe financiare.

Sekretariati për implementimin e Kornizës së Ohrit e udhëhequr nga BDI-ja, parti shqiptare e shumicës dhe pjesë përbërëse e pushtetit, nuk ka hartuar një raport publik mbi zbatimin e Marrëveshjes dhe nuk ka asnjë bazë të dhënash për monitorimin e përfaqësimit të barabartë” (Raport: QKSM, 2013).

Sot, jetojmë në një kohë kur procesi politik i një vendi siç është RMV, gjendet përballë tendencave të reformave të mëdha. Procesi i mëtejshëm i sfidave të politikbërjes ka përballë një sërë detyrimesh, të cilat dolën si rezultat i kërkesave të politikës së kohës. Ishin detyrimet të cilat iu rekomanduan RMV, për të marrë një kahje tjetër si shtet në bisedimet që u zhvilluan së fundi me shtetin e Greqisë në lidhje me emrin.

Ky proces politik u zhvillua në nivelin e lartë të përfaqësimit qeveritar të kryeministrave dhe ministrave të jashtëm, në praninë e faktorit ndërkombëtar evropian, përfaqësuesve të politikës së jashtme të BE-së. Arritja e kompromisit në mes të dy vendeve për problemin e emrit të RMV, mes të tjerash ishte dhe një arritje e faktorit politik shqiptar.

Më këtë rast u zgjidh një krizë me karakter ndërkombëtar, që i hapi rrugën RMV për t'u anëtarësuar në NATO dhe për të çuar më përpara proceset e intergrimit në BE. Hapat e mëtejshëm në politikbërjen brenda shtetit të RMV shtrojnë detyrimet drejt tendencave të reja për realizimin e detyrimeve dhe kërkesave të bashkëpunimit më të thellë me faktorin ndërkombëtar, në harmoni me politikat e mitëfillta të BE-së për zgjerim.

KAPITULLI VI: Shoqëritë multietnike, praktika nga vendet e zhvilluara

Identiteti etnik paraqet ndërtimin pluridimensional, të karakterizuar nga ekzistenca e ndjenjave të përkatësisë etnike dhe të krenarisë kombëtare të popujve, si një qëndrim pozitiv ndaj traditës, kulturës dhe veçorive të tjera etnike. Ndjenja e vetos përcaktohet në etnikëterma, që presupozojnë origjinën e përbashkët dhe dërgon një seri elementesh në lidhje të ngushtë me gjuhën, kulturën ose origjinën. Identiteti etnik ndryshon siç ndryshon dhe vetë koha, mosha është rezultat i disa përvojave personale dhe eksplorimeve të cilat kanë një karakter dinamik (Phinney, 1992: 156-176).

Të flasim për çështjet e multikulturalizmit ashtu siç i parashohin teoritë apo postulatet e etikës liberale, ku në mes tjerash veçohet inkluziviteti që nënkupton se, nuk duhet të hidhet e jotja që të bëhesh multikulturor, por se nuk duhet të nënçmohen njerëzit, për të mbajtur tënden. Richard Molard vlerëson se: *“Një grup etnik karakterizohet nga një bashkësi bindjesh, vlerash, gjuhësh dhe e kundërta me hapësirën kritike”*. (Vulcănescu, 1979: 104).

Në këmbim të kësaj teorie antropologu i Afrikës së Jugut, **Meyer Fortes**, beson se etnia përfaqëson një grup të përcaktuar hapësinor, brenda të cilit ekzistojnë lidhje shumë të forta (Encyclopedia Universalis, 971: 972). Për të qenë multikulturor dhe të respektosh jo vetëm kulturën por edhe përkatësinë etnike të tjetrit, duhet që toleranca të jetë më e madhe, në mënyrë që të ketë respekt në mes formave të diversitetit etnik dhe kulturor, që ekziston brenda një shoqërie. Kjo thënie më tepër përkon me frymën e një qasje të nivelit shumë të lartë të ngritjes së shoqërive, të cilat janë pjesë e një civilizimi të lashtë, si në Evropë ashtu dhe gjetiu.

Në këtë përcaktim, ka shumë element të cilave mund t’iu referohemi e të na shërbejnë njëkohësisht më shumë në sendërtimin e një koncepti më madhor të funksionimit të mirëfilltë të shoqërisë për të cilën ne pretendojmë idenë shumëkulturore, shumëetnike, apo dhe pjesë të shumë vlerave të tjera.

Në gjurmimet e studimeve të funksionimit të shteteve, të cilat radhiten si modele të funksionimit të shteteve shumëetnike, mund t’i referohemi disa praktikave nga Brukseli, Zvicra si dhe duke mos anashkaluar tendencat pozitive të shteteve skandinave, të cilat pos karakterit të një modeli të shtetit me politika të mirëfillta të sferës sociale, janë po aq të shquara si vende të cilat kanë tolerancën dhe respektimin e ndërsjellë në mes popujve që bashkëjetojnë me ta dhe kultivojnë

vlerat me dimensione diverse nga ajo pjesë e përditshmërisë, që shquhet në pjesën e praktikës dominante të tyre si shteti dhe si popujt me kulturë të lashtë, të njohur si Vikingët Evropian.

Fillimisht po ndalemi tek përvoja që ofron Belgjika. Shteti belg ndan një përvojë të cilës i referohemi si shteti që ka krijuar mitet e bashkëjetesës dhe respektimit të ndërsjelltë në mes popujve të ndryshëm. Sado që përshtypja e përgjithshme është bazuar në mendimin se, nuk ka vende të cilat të mos kenë kaluar konflikte mes kulturave të ndryshme dhe nuk ia kanë dalë lehtësisht, por është po aq e vërtetë që kjo është arritur me një politikbërje me vizion dhe hapësira duke mos lënë shtigje kundërshtimesh e mosmarrëveshjes mes popujve me kultura e tradita të ndryshme.

Qeverisja e vendit shfaqet e komplikuar nga struktura e veçantë me tre komunitete gjuhësore (*Flandria në veri, Valonia në jug dhe një rajon i vogël gjerman në Lindje*). Ky fakt përbën thelbin e statusit multilingual, multikulturor dhe shumëkombësh të Brukselit. Gjuha në Valoni është frëngjisht (*megjithëse ende ekziston një gjuhë valone e njohur jo zyrtarisht*). Gjuha në Flandri është flamanishtja, e cila është zyrtarisht gjuha e njëjtë si holandishtja që flitet në Holandë. Në praktikë, dallimet mes flamanishtes dhe holandishtes kanë ngjashmëri, (*kryesisht në shqiptim, gjithashtu në fjalor dhe në shprehje*). Megjithëse Brukseli është i rrethuar nga territori i flamanëve, të cilët në shtetin belg përbëjnë rreth 55% të 10 milionë banorëve, në Bruksel 10% dhe Valonas pjesa e mbetur prej 35%.

Ka pasur shumë konflikte politike midis dy komuniteteve kryesore gjuhësore, por problemi i gjuhës, është çështja që ka marrë më shumë publicitet jashtë Belgjikës. Që nga Federalizimi i shtetit, konfliktet gjuhësore duket se janë zvogëluar shumë, tani që politikanët nuk janë më në gjendje të fajësojnë vështirësitë në "*anën tjetër*" (Heligen, 1998). Kjo është një qasje e re si përvojë edhe për shtetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nuk ka pasur kurrë ndonjë konflikt të vërtetë midis banorëve belgë (*valon dhe flaman*), në krahasim me konfliktet midis politikanëve belgë. Ilustrimi më i mirë i kësaj është se, gjatë episodeve më të nxehta, askush nuk është vrarë ndonjëherë ose është plagosur rëndë në përplasjet e lidhura me konfliktin gjuhësor. Mjafton të merren parasysh situata të ngjashme në vende të tjera ku ekzistojnë konflikte midis komuniteteve kulturore ose gjuhësore, (*p.sh. vendet e ish-Jugosllavisë, Kanadaja, Irlanda Veriore*), për të arritur në përfundimin se një qetësi e tillë, nuk përbën ndonjë rregull të zakonshëm në politikë.

Shembujt e praktikave të tilla sot zënë vend më pak në shumë shtete të tjera, në të cilat arrihen të përfshihen deri në përgjakje e situata tragjike me pasoja të pariparueshme. Shkak i përvojave pozitive si në rastin e Belgjikës, janë politikbërja me vlera kombëtare, duke respektuar multikulturalizmin dhe duke hequr barrierat frenuese në komunikimin mes popujve me kultura të ndryshme. Politika ka ditur në mënyrë vizionare t'i administroje situatat brenda vendit.

"Kombi është mbi të gjitha një konstrukt shoqëror, një krijim i zgjuar, një kombinim kulturor i kombinuar me traditat e gjetura në territorin kombëtar; vazhdimësia historike është e lidhur ngushtë me marrëdhëniet mes etnisë dhe nacionalizmit" (Grosaru, 2018).

Politika e Zvicrës zhvillohet në kuadrin e një sistemi shumëpartiak si Republikë Federale Demokratike, ku Këshilli Federal i Zvicrës është kreu i Qeverisë. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria dhe administrata federale dhe nuk është përqendruar në ndonjë person. Fuqia legislative Federale është dhënë në qeveri dhe dy dhomat e Asamblesë Federale të Zvicrës. Gjyqësori është i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi.

Për çdo ndryshim në kushtetutë, një referendum është i detyrueshëm, për çdo ndryshim në ligj mund të kërkohet referendum. Përmes tyre qytetarët mund të kundërshtojnë çdo ligj të votuar nga Parlamenti Federal dhe përmes iniciativave, mund të fusin ndryshimet në kushtetutën federale, duke e bërë Zvicrën shtetin më të afërt në botë, me një demokraci të drejtpërdrejtë.

Qeveria e Zvicrës me sistemin e qeverisjes politike daton që nga viti 1848 me themelimin e Kushtetutës dhe shtetit modern. Konfederata e Zvicrës (*lat. Confoederatio Helvetica - CH*) qeverisjen e realizon në tri nivele politike: Qeveria Federale, Kantonet dhe Komunitet. Një vend ky, i shquar për një formë shtetërore organizative të njohur si **Modeli i kantonizimit të shtetit Zviceran**.

Në fakt, ky model në pikëpamje të sqarimit më të detajuar të terminologjisë "*Kanton*" (*gjermanisht: Kantone, frëngjisht: kantonet, italisht: cantoni, romak: chantuns*), është me origjinë frënge dhe nënkupton "**qoshe**" ose "**bashki**". (Swiss.worlds.org, janar, 2016). Kjo është trajta që merr kuptimin aspekti i emërimit në pikëpamje terminologjike.

Edhe këtu në teorinë politike kemi një përvojë dhe një qasje të re për një model të kantonizimit të Maqedonisë së Veriut, (*varjant për rastin konkret*). Ky problem shpesh herë është bërë debat bisedimesh në tryeza publike, por asnjëherë nuk ka pasur gatishmëri për të marrë një hap konkret, i cili sot mund të ishte i zbatueshëm në vlerat e organizimit politik në RMV.

Nëse paqja mes kulturave të ndryshme brenda kornizave të një populli arrin një kompromis dhe respektohen të drejtat themelore të njeriut, atëherë arrihet një gjuhë e përbashkët për të ruajtur

vlerat e ndërsjella. Nuk ka dyshim që ata popuj do të mbijetojnë në kultivimin e vlerave që mund t'i kenë pasur paraprakisht. Por, sigurisht ky është një fakt dhe element, i cili ka rezultuar si praktikë e shumë shteteve të botës.

Shtete dhe shoqëri të ndryshme kanë bërë çmos që të ruajnë ekuilibrin në mes vlerave të ndryshme në shoqëri. Në këtë rast, këto vende sot shquhen si shtete me kulturë dhe civilizim të lartë, të cilat reflektojnë përvoja të reja në shkencat politike.

Në rastin e RMV, janë disa probleme të cilat nuk lejojnë që këto praktika europiane të vijnë si shprehje e kërkesave për zbatim. Në radhë të parë, janë çështje të cilat kanë reflektuar me probleme të njëpasnjëshme historike dhe si rrjedhojë e një deformimi historik, të cilin jo vetëm faktori ndërkombëtar e ndihmoi para shekujve që lamë pas, por janë nxitur nga vetë autoritetet brenda shtetit që sot udhëheqin politikbërjen në vend.

- ***Republika e Maqedonisë së Veriut është në krizë të vazhdueshme, për shkak të modelit të shtetit që nuk përputhet me realitetin etnik si dhe standardet e tjera për shoqëritë e hapura, plurale ku respektohen diversitetet kulturore dhe etnike.***
- ***Republika e Maqedonisë së Veriut është në krizë për shkak se nuk ka vullnet politik të reflektojë mbi të kaluarën, dhe të pranojë të vërtetat historike mbi ngjarjet deri në ditët e sotme.***
- ***Republika e Maqedonisë së Veriut është në krizë në raportin e marrëdhënieve të pastabilizuara me popullsinë shqiptare, për shkak të vetë shqiptarëve! Kërkesat e tyre të deritanishme nuk arritën të shndërrohen në mekanizma detyrues në interes të barazisë sociale dhe etnike, që vazhdimisht do të prodhonte barazinë në të gjitha segmentet e shoqërisë” (Bela, 2018).***

Sado që opinionin publik do të dëshironte të realizoheshin përvojat e vendeve të ngjashme në multietnicitetin dhe multikulturalizmin e tyre për të krijuar një realitet të përshtatshëm me to edhe në RMV, tezat dhe qasjet e reja që vijnë nga këto përvoja nuk kanë arritur të gjejnë konsensusin e përbashkët në objektivat e zhvillimit strategjik të vendit.

VI.1. RMV përballë praktikave të mira të shoqërive multietnike, sfidat në aplikimin e formave bashkëkohore

Në historikun e zhvillimit dhe të krijimit të shteteve të reja, por dhe të atyre shteteve që sot mund të paraqesin element apo modelin e funksionimit harmonik të një vendi, ka kohë që kanë përfunduar çështjet e rregullimit apo përcaktimit të llojit të sistemit politik me të cilin ato qeverisen. Për më tepër se kaq, dilemat mund të jenë më të vogla drejt riorganizimit apo hapjes dhe qëndrimeve për aspirata dhe mundësi më të mëdha të qeverisjes në hapësira territoriale jashtë kufijve aktual.

Sot, Evropa bashkë me institucionet relevante të saj, ka krijuar një mekanizëm të atillë që këto shtete të njohura zyrtarisht me statusin e tyre të plotë nga faktori ndërkombëtar, si shtete të pavarura me të drejtat e plota dhe të barabarta në mes vendeve të tjera, janë të orientuara ose duhet të jenë të orientuara drejt përmbushjes së standardeve të reja demokratike, të cilat janë pranuar në kuadër të standardeve evropiane dhe atyre ndërkombëtare. Për shtetin maqedonas ekzistojnë parakushte të veçanta, duke marrë në konsideratë rrethanat në të cilat kërkohet rregullimi i veprimtarisë shtetërore, e cila duhet të udhëhiqet sipas këtyre standardeve.

Për ardhmërinë e RMV ka një sërë përvojash nga strukturat relevante evropiane, të cilat mund të merren si model, për ta çuar vendin më përpara. Pas konfliktit të armatosur të vitit 2001, RMV iu hapën shumë mundësi në rrugën e zhvillimit dhe për të marrë shumë element polzitivë të politikbërjes, duke pasur të afërt bashkëpunimin me faktorin ndërkombëtar dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian (BE), duke kërkuar prej saj vullnet dhe gatishmëri më të madhe politike.

Si një vend nënshkrues i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA), dhe marrjes së statusit të vendit kandidat në vitin 2005, RMV u orientua drejt hapave të mëtejshëm për të plotësuar kushtet për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian (BE). Kjo nënkuptonte që vendin e prisnin shumë sfida në rrugën e tij të zhvillimit. Këto dhe një sërë procesesh të tjera të cilat erdhën më pas, ishin një parakusht që vendi të ndiqte hapa të tjerë më të avancuar në proceset e eurointegritit.

Që nga kjo periudhë e deri në dekadën e fundit, vendit i është dashur të lëvizë përpara shumë procese në drejtim të aspektit ekonomik, politik dhe rregullimit të sistemit juridik, duke vendosur parametra normativ apo juridik, të cilët korrespondojnë me praktikën e mira të shteteve të zhvilluara.

Bazuar në raportet periodike që RMV ka marrë në formë të rekomandimeve çdo vit nga Bashkimi Evropian, përherë flitet për të njëjtat shtylla të rëndësishme të funksionimit të shtetit në kushtet normale që i duhen një shteti modern dhe demokratik. Praktika ka vënë në dukje

elementet themelore të krijimit dhe funksionimit të institucioneve të shëndosha të shtetit, të cilat do të funksionojnë në bazë të normave juridike, norma këto të bazuara në parimin e njohur të *“acquis communitaire”*, respektivisht në përshtatshmëri me sistemin juridik vendor dhe të praktikave të Bashkimit Evropian.

Përvoja të tilla, të cilat kanë qenë pjesë e bashkëpunimit të autoriteteve qeveritare në Maqedoninë e Veriut dhe autoriteteve të Bashkimit Evropian, në mungesë të transparencës së plotë, shumë çështje nuk janë bërë pjesë e diskutimeve apo debateve publike. Raportet janë komentuar nga politika qëndrore në pika shumë të përgjithëshme, duke anashkaluar shumë probleme të ndjeshme për opinionin publik brenda vendit. Autoritetet e Bashkimit Evropian kanë parashtruar shumë detyrime ndaj qeverisë së RMV.

Nën një vështrim kritik, konstatohen aspektet formale të këtij komunikimi, duke vlerësuar faktin e mosmbjlljes së burimeve të financimit dhe formës së granteve europiane, që i dedikohen thellimit të reformave dhe programeve të transformimit të jetës social – politike në vend. Një pjesë e këtyre detyrimeve janë një mekanizëm këshillues i Bashkimit Evropian.

Në udhëzimet praktike për funksionimin e institucioneve vendore, BE ka rekomanduar përherë që të rregullohen shumë çështje, të cilat i referohen veprimtarisë së përgjithshme procedurale të organeve administrative, të cilat do të udhëheqin me fonde të Bashkimi Evropian (BE).

Këto çështje i referohen problematikave më të ndjeshme si, konflikte interesi, decentralizim dhe implementim të politikave përmes fondeve të dedikuara për sferën e shërbimeve publike, akreditimin e IPA fondeve (Udhëzimi nr.718/2007 Qeveria e RM-së); Projekte për financim nga IPA, fondet që i referohen autoriteteve institucionale të caktuara, përcaktimin e granteve dhe themelimin e komisioneve të veçanta të cilat do të kujdesen për vlerësimin dhe verifikimin e shfrytëzimit të mjeteve të dedikuara nga fondet e Bashkimit Evropian (BE), qëllimi i të cilave është për të realizuar një formë kontrolli në funksion të mirëadministrimit të fondeve dedikuara këtyre qëllimeve. (Burimi <http://www.sep.gov.mk>; parë më: Janar 2016).

Në raportet e njëpasnjëshme të cilat referohen ecurisë së procesit të vendit, ajo që evidentohet mes të tjerave në raportet periodike të autoriteteve të Bashkimit Evropian (BE), respektivisht të Komisionit Evropian, theksi është vënë në porositë ndaj qeverisjes në drejtim të sistemit të reformimit të administrimit publik, sidomos administratës shtetërore, edhe pse pretendohet që në këtë drejtim bëhen lëvizje reformuese, gjithsesi tendenca është për të mos frenuar proceset e reformimit të administratës shtetërore.

Kërkesa drejt strukturimit dhe krijimit të pjesëve organizative të vetë organeve të administratës, të cilat janë angazhuara në realizimin e politikës së gjithanëshme shtetërore, duke rekomanduar më së shumti në procesin e një politike, e cila është e vendosur në mbrojtjen e interesit publik.

Sido që përshtypja e përgjithshme është krijuar sikur gjërat kanë filluar të lëvizin për mirë, gjithnjë ka pasur hapësira për t'u marrë në konsideratë drejt një modeli të arrirë në interes të zhvillimit perspektiv të vendit.

Në përmbajtjen e disa pjesëve specifike të raporteve periodike të Komisionit Evropian, janë ende shumë çështje të cilat theksohen në formë të rekomandimeve në pjesën përfundimtare të studimit, duke mos anashkaluar pjesën e trajtimit të proceseve të mirëfillta, të cilat merren në konsideratë mbi thelbin e politikbërjes, të rekomanduara nga autoritetet ndërkombëtare. Ky aspekt është një hapësirë më shumë, që klasa politike të marrë mësim për shumë çështje, të cilat janë të një rëndësie madhore dhe ato bëhen të plotfuqishme në rrjedhën e procesit të politikbërjes së një shteti, ashtu siç i kërkohet sot RMV.

Çdo pjesë e këtyre rekomandimeve adresuar RMV, janë një model nga i cili shteti dhe politika duhet të mësojnë shumë, duke i dhënë rëndësi zbatimit praktik të tyre në interes të reformimit të administratës profesionale të mbështetur në ligjshmërinë kushtetuese, për t'i shërbyer interesave publike sipas standardeve ndërkombëtare.

Duke i bërë një përmbyllje këtij kapitulli të rëndësishëm në trajtimin teoriko – praktik dhe duke iu referuar situatës aktuale në RMV, sot rezulton se faktori shqiptar është determinant në administrimin e krizës politike, duke qenë në unitet me interesat gjeostrategjike të SHBA-ve në rajon. Sot në RMV qeversjen e vendit e ka në dorë BDI. Përvoja e përkrahjes në zgjedhjen e Presidentit të shtetit, është një model i qëndrimit të drejtë politik dhe dëshmi e këtij realiteti.

Për shkak të politikave problematike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku krizat politike janë të ndjeshme, sot pothuajse të gjitha vendet janë në prag të zgjedhjeve të parakohëshme, siç ndodhi në Greqi. Një situatë e tillë është në Kosovë, në Serbi dhe kriza politike po troket edhe në RMV dhe në Shqipëri. Me sa duket, faktori ndërkombëtar po tenton t'i lëviz gurët dhe t'i çojë në vendin e tyre. Korrupsioni i skajshëm po ha vetë kokat e politikës në vendet ballkanike. Në rajonin më të varfër të Europës, korrupsioni po gërryen nga brenda vlerat e demokracisë së brishtë. Në këtë situatë, problemi shtrohet: Nga do të shkojë RMV?

Politika shqiptare në këtë shtet po i përshtatet më të fortit, duke vendosur në diskutim interesat kombëtare të popullsisë shqiptare, për nevojat më adekuate të stabilitetit brenda vendit. Ajo është vënë përpara dilemës: A është në gjendje politika aktuale të harmonizoj qëndrimet në interes të bashkëjetesës multietnike në vend, kundër tendencave separatiste si element ndarës në RMV?

Pala shqiptare është faktor shtetformues në shtetin maqedonas. Ajo kërkon ekuilibër, sepse objektivat e saj gjeopolitike përkojnë me interesat e politikës euroatlantike.

Pala shqiptare në RMV në këto kushte, gjen mbështetjen nga Republika e Shqipërisë, si një shtet anëtar i NATO-s. Ky qëndrim është një mbështetje për shetin e ri të Kosovës. Në këto kushte, kundërshtarët e politikave të tilla ekuilibruese do të tentojnë të përçajnë qëndrimin politik të palës maqedonase, e interesuar për proceset e integritetit të vendit në strukturat euroatlantike. Kjo përçarje sot është orientuar brenda aleates së shqiptarëve, partisë së LSDM-së në pushtet. Skenarët antiperëndimor në RMV janë hedhur në veprim. A do të pengohet RMV të futet në NATO?

Në këto kushte, politikbërja e brendshme kërkon orientimin drejt shtetit multi-etnik të qytetarit, i cili mund të garantohet vetëm nga standardet demokratike dhe konsolidimi i sistemit politik.

Kush e ushqen ultranacionalizmin në shoqërinë maqedonase? Kjo është pyetja që ka shoqëruar gjatë jetën politike të vendit, duke shtruar në çdo kohë dilemën politike: Ose RMV do të ndjek kursin politik euroatlantik, ose do të shkojë drejt ndarjes, duke kaluar më parë në fazën e federalizimit të saj. Modeli politik i Qipros brenda BE-së është i pranishëm dhe mund të jetë objekt studimi edhe në rastin e Republikës së Maqedonisë Veriore. E thënë në versionin filozofik;

Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të rilindë nëpërmjet “vdekjes”, duke lënë pas të kaluarën e saj të errët në trajtimin e rastit të një shteti tipik multi-etnik.

Republika e Maqedonisë së Veriut sot është një laborator i vlerave të demokracisë, i raportit të forcave etnike brenda saj.

Në konceptin politik, sot situata në Republikën e Maqedonisë së Veriut shfaq vetë fytyrën e Europës, të luftës politike që realizohet drejt harmonisë, bashkëjetesës, multikulturalizmit dhe tentativave të respektimit të të drejtave njerëzore.

Brenda saj ndeshen interesat e shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ajo nuk përfaqëson një mjedis autokton homogjen, siç paraqitet brenda saj pjesa shqiptare. Shteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut Maqedonisë sot shfaqet si një integral faktorësh për shkak të multi-etnicitetit të saj. Pretendimet e Greqisë sot ndikojnë në politikbërjen e saj të brendshme dhe të jashtme.

Situata tenton ende të defaktorizojë palën shqiptare, duke e inkriminuar atë nën frymën e neootomanizmit dhe të përfshirjes brenda “islamit” politik. Këto janë influenca të caktuara që nuk e dëshirojnë një shtet maqedonas të stabilizuar me orientim perëndimor, një vend të hapur ndaj kulturave, traditave dhe mundësive të zhvillimit.

Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është shtet shumë i veçantë, por për shtetet ballkanike është një shtet shumë i rëndësishëm, sepse brenda saj ndërthuren interesa të shumëfaktorëshme, të cilat ndikojnë ndjeshëm në situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

VI.2. Analiza deskriptive e të dhënave

Realizimi i mbledhjes së të dhënave, në kushtet dhe rrethanat aktuale të kohës që po jetojmë, me avancimin e zhvillimit tekniko-teknologjik, është mundësuar lehtësimi i paraqitjes dhe mbledhjes së tyre për të gjithë studiuesit që angazhohen në veprimtari studimore, duke shfrytëzuar me efikasitet versionin elektronik të shpërndarjes së pyetësorit dhe njëkohësisht, mbledhjen e të dhënave në po të njetën metodë.

Në përmbyllje të çdo pyetje (në formë linku), e cila është dërguar në postën elektronike deri tek anketuesit, mundësohet që çdo përgjigje të regjistrohet, duke u vendosur në evidencën e tabelës përkatëse si pjesë e programit të pyetësorit, e krijuar paraprakisht nga pyetjet e hartuara në anketë. Ky format elektronik i bashkangjitur në pjesën tabelare të mëposhtëme të pyetësorit, mbledh ato të dhëna të përgjigjeve, të cilat vetë anketuesit i plotësojnë dhe më pas ato konvertohen në të dhëna të shndërruara në përqindje.

Kjo formë jep mënyrën elektronike direkte të të dhënave bazë, që janë të nevojshme të shfaqen në realizimin e anketës, të cilës i përgjigjen anketuesit përmes linkut elektronik që iu jepet. Ky format më i avancuar i realizimit elektronik të përgjigjes së pyetësorit, është një hap më i suksesshëm drejt realizimit të një ankete më të shpejtë në afat kohor të shkurtër, duke pasur parasysh që, përvojat e mëparshme kanë qenë një version më i komplikuar drejt përfshirjes së të dhënave në versionin tabelar apo elektronik, të radhitura në formën e sqarimit të çështjeve që kanë nxjerr në pah një dukuri reale, si pjesë e synimit të hulumtimit shkencor.

Sa persona janë intervistuar?

Në natyrën gjithëpërfshirëse të anketimit në interes të hulumtimit shkencor, është paraparë që në të të përfshihen gjithësej 300 (*treqind*) persona të anketuar. Pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar në sektorin publik, përfshirë këtu:

- Sektorin qeveritar (*nëpunës në qeveri*) - administratat shtetërore;
- Nëpunës në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Sektorë të njësive të pushtetit lokal në RMV. (*Qytetet, Tetovë, Strugë, Gostivar, Shkup, Kumanov, Kërçovë*).
- Autoritete të administratës komunale.
- Autoritete të administratës së sistemit gjyqësor në pushtetin lokal, gjykata themelore.
- Autoritete, figura politike aktive, pjesë e pushtetit dhe të partive opozitare në RMV.

Kur janë kryer intervistat?

Realizimi i intervistave është kryer në periudhën e fundvitit 2017, me ish-Ministren për Dialog në Republikën e Kosovës, Zonjën Edita Tahiri, autoritete të pushtetit lokal në RMV, kurse në Tetovë janë marrë në intervistë përfaqësues të bllokut politik qeverisës të pushtetit politik të kohës, udhëheqës të sektorit të arsimit, si dhe përfaqësues të zyrës së Bashkimit Evropian në RMV, me seli në Shkup.

Në fillesat e veprimtarisë hulumtuese në terren, duke e vlerësuar Republikën e Kosovës si një një nga shtetet më të rinj në botë, si dhe vend fqinj, njëkohësisht duke studiuar aspektin juridiko-kushtetues, i cili në aspektin përmbajtësor i kushton një rëndësi të jashtëzakonshme rregullimit dhe garantimit me norma juridike të të drejtave të etniteteve të tjera, që e përfaqësojnë një shoqëri multietnike.

Njëkohësisht, u morën mendime nga aktorë të politikës vepruese, duke llogaritur që ky element do të nxjerrë në prioritet aspektet më të rëndësishme dhe madhore të rregullimit juridik brenda sistemit pozitiv të Republikës së Kosovës.

Një nga arsyet kryesore ishte fakti që Republika e Kosovës është një vend, që nuk dallon shumë për nga format e organizimit të pushtetit shtetëror, duke mos e anashkaluar përvojën e përbashkët të së kaluarës historike, të një shteti autonom që në aspektin politik e lidhnin shumë gjëra të

përbashkëta me RMV, si dy vende, pjesë e ish RSFJ-së. Brenda këtij konteksti, nuk u anashkaluan edhe shumë tipare të tjera, që nuk e dallojnë atë nga një vend, siç është RMV.

Intervistat janë realizuar drejtpërdrejt në bisedë me aktorë të politikës dhe për janë ruajtur këtë dëshmitë e regjistrimeve elektronike, të cilat përmbajnë një pyetje të përbashkët:

- *Cila është rëndësia e përfshirjes në procesin e politikbërjes në një vend me karakter multietnik, duke iu referuar praktikave që tanimë jemi të fokusuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Kosovës, si dy vende fqinje me një të kaluar të përbashkët?*

Opinion i përgjithshëm, si në rastin e individëve të përfshirë në politikë në Republikën e Kosovës, ata më tepër aludonin që në këtë veprimtari hulumtuese të ketë përfshirje të barabartë, duke iu referuar parimeve themelore, të cilat janë pjesë e padiskutueshme e shërbimeve publike cilësore, kur është fjala për realizimin e politikbërjes së mirëfilltë, që prodhon efekte madhore për të plotësuar në mënyrë të barabartë interesin e qytetarëve të saj.

Nga ky këndvështrim, aktorët politikë si brenda vendit ashtu edhe jashtë RMV, me të drejtë iu përmbajtën me korrektësi elementit thelbësor kushtetues, i cili është realisht në aspektin juridik, argumenti më i rëndësishëm për të vërtetuar qartë dhe saktë karakterin multietnik të shtetit, duke vënë në dukje garantimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve sipas kushtetutës. Këto organe vendimarrëse dhe autoritetet shtetërore, u vlerësuan si shumë të rëndësishme në drejtimin e çështjeve madhore të politikbërjes së mirëfilltë.

Realizimi i intervistës ka pasur hendikapet e veta gjatë tërë fazave të marrjes së opinionëve të ndryshme nga aktorë të politikës. Kjo për arsyen e thjeshtë, për hir të rrethanave konkrete në kuadër të të cilave ballafaqimi bëhej me zhvillimet reale politike në RMV. Në këtë aspekt, kjo temë shpesh u realizua si qëllim në vetëvete, duke krijuar vështirësitë e çastit. Ishin disa element të tillë, të cilët në situata të caktuara e vështirësuan paraqitjen e realitetit subjektiv dhe veprimin e faktorëve objektiv brenda realitetit dhe të pandikuar nga rrethanat e kohës.

Në këto kushte të zhvillimit dhe realizimit të hulumtimit shkencor, nga vetë natyra dhe përmbajtja e tematikës politike, shfaqti vështirësitë e veta, për shkak të këmbënguljes për të nxjerrë në pah mangësitë e sistemit politik në praktikën shtetërore, politike dhe sociale, gjë që nuk ishte e lehtë për t'u realizuar. Ngurrimi dhe frenimet për shkak të interesave dhe paragjykimëve në një farë mënyre dhanë efektet e tyre.

Brenda kësaj veprimtarie u siguruan intervista të vlefshme dhe opinione nga përfaqësues të zyrës së Bashkimit Evropian në RMV. Prej materialit të siguruar prej tyre, u kuptua vendi dhe roli dhe vetë rëndësia aktuale e trajtimit të barabartë të qytetarëve në aspektin etnik, siç ai vepron në praktikën e RMV.

Si përfaqësues të një zyre të huaj me mision diplomatik, për shkak të natyrës së hulumtimit studimor shkencor, ata nuk kursyen dhënien e mendimeve të vlefshme, por të paekspozuar në mjediset publike, vetëm të angazhuar për të dhënë maksimumin në interes të problemit që shtronte hulumtimi.

Prej tyre u ndje përkrahja pa rezerva, duke qenë të kujdesshëm për të mos ndikuar në aspektin politik në qëllimin e studimit. Përkrahja e idesë së studimit dhe mbështetja për të kontribuar në plotësimin e tij, ishte e mjaftueshme, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë. Kontributi i tyre u shfaq në dëshirën e mirë për të dhënë shembullin, se si mund të funksionoj shteti ligjor në kushtet e natyrës multietnike, si në rastin e praktikës së RMV.

VI.3. Popullata dhe kampioni

Pjesa së cilës i është kushtuar vëmendje e veçantë në vërtetimin e pyetjeve kërkimore dhe verifikimit të hipotezave, të cilat flasin për format e diskriminimit në baza etnike gjatë procesit të politikbërjes në praktikën e RMV, është vënë në radhë të parë kampioni, si aspekt i përfaqësimit etnik. Këtu është specifikuar pozita e shqiptarëve në RMV, si kampioni apo pika e referimit, prej të cilave nisin një sërë tendencash diskriminuese të politikbërjes në këtë shtet.

Pyetjeve që lindim me këtë rast, apo përfshirjes së anketuesve dhe të dhëna të tjera që flasin për aspektin e politikës diskriminuese të qeverisjes në RMV me bazë etnike, janë trajtuar fillimisht me disa vendime, të cilat dolën si përvojë e njërit nga autoritetet e pushtetit ligjdhënës – të Parlamentit të RMV, në kuadrin e politikbërjes shtetërore, vendimet që u sollën në formën e ndryshimeve ligjore dhe propozimet që u bënë për buxhetit e viteve 2017 – 2018. Po parashtrijmë disa përgjigje të pyetjeve kërkimore:

Një formë e politikbërjes tendencioze vërehet në mënyrën e ndarjes së buxhetit, e cila në pamje të parë shfaqet si një ndarje me tendenca diskriminuese. Mungesa e theksuar e shpërndarjes së mirëfilltë, e vështirëson formën e administrimit të komunave shqiptare, të cilat janë pjesë e

shtrirjes gjeografike në pjesën perëndimore të RMV, të banuara kryesisht nga popullsia shqiptare.

Këto të dhëna janë të evidencuara dhe vërtetuara në tabelën e mëposhtme, si një evidencë të dhënash që pasqyrojnë realisht gjendjen faktike të përvojës negative me të cilën ballafaqohet shoqëria aktuale në RMV.

Në vështtrimin dhe analizën kritike të njerit prej akademikëve të UEJL-së, ekspert në sferën ekonomike të akademisë, Akademik - Prof. Izet Zeqiri, në këndvështrimin e studimit kritik, vërehet qartë se çfarë mund të thuhet me këtë rast në gjuhën e profesionistit, e cila në përmbajtje kuptohet lehtë. Në këtë shpërndarje buxhetore (*Tabela nr. 10*), shihet qartë diskriminimi në mes komunave të banuara me shumicë shqiptare, e krahasuar kjo me komunat në pjesën lindore të shtetit.

Tabela nr. 10: Të dhënat diskriminuese në financimin e komunave shqiptare.

Nr.	Komunat	Denar	Euro
1	Manastiri	307,830,474.00	5,005,374
2	Vrapçishti	126,261,400.00	2,053,031
3	Gjevgjelia	118,876,728.00	1,932,955
4	Gostivari	100,616,249.00	1,636,037
5	Dibra	109,549,692.00	1,781,296
6	Kerçova	146,371,050.00	2,380,017
7	Kumanova	233,130,023.00	3,790,732
8	Ohri	971,132,394.00	15,790,771
9	Sruga	262,203,073.00	4,263,465
10	Strumica	126,151,606.00	2,051,246
11	Tetova	918,811,611.00	14,940,026
12	Gazi Baba	140,344,585.00	2,282,026
13	Kraposhi	486,927,773.00	7,917,525
14	Kisella Voda	127,027,735.00	2,065,492
15	Saraj	92,974,614.00	1,511,782
16	Çairi	138,505,129.00	2,252,116

Burimi: [http://www.stat.gov.mk.GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wu1a & cof.FORID%3A10&ie.UTF8&q.enicka+prpadnst&sa](http://www.stat.gov.mk/GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wu1a&cof.FORID%3A10&ie.UTF8&q.enicka+prpadnst&sa).

Nga tabela shihet sa mjete financiare janë të parapara nga buxheti i shtetit për top borxhlinjtë kryesor; që do të thotë, komuna që trashëgojnë një buxhet të varfër dhe pak mjete financiare që iu ndahen në vijim.

- Me këtë rast, ligji për këtë vit financon keqmenaxhimin e së kaluarës, me pretekstin se do i dëmshtëpërblejë kreditorët kyç të komunave, që janë kompanitë e sektorit real, duke mos kërkuar llogari për borxhin real dhe fajtorin e mos mbylljes së këtyre raporteve debitor - kreditor.
- Me këtë ligj bëhet Amnistia e dytë me 51% e borxheve të një pjese më të madhe të komunave të administruara nga ish Prefekturat të VMRO-së dhe LSDM e BDI, në vend që të kërkohej llogaridhënie për këtë situatë.
- Qeveria me këtë masë u krijon komoditet pjesës më të madhe të kryetarëve të komunave që drejtohen nga funksionar të zgjedhur të LSDM dhe BDI, duke u lehtësuar me këtë rast administrimin në të ardhmen, si një parakusht për të treguar sukses dhe mundësi në synimet e fitimit të mandateve të radhës.
- Me këtë ligj diskriminohen komunat e udhëhequra nga opozita, pasi ato nuk trajtohen në mënyrë të barabartë në shpërndarjen e mjeteve financiare. Kjo paraqet një goditje të fortë në drejtim të zbehjes së aktiviteteve investuese, të cilat mund të shkaktojnë humbjen e tyre në zgjedhjet e ardhshme.
- Ajo që është shqetësuese në këtë veprim ligjor, është sakrifikimi i mundësive të investimeve të së ardhmes (*investime kapitale*) në llogari të borxheve jofunksionale të së kaluarës. Me këtë rast, qeveria favorizon keqmenaxhuesit dhe njëkohësisht diskriminon mirëmenaxhuesit, duke mos i përkrahur ata as simbolikisht me fonde për projekte kapitale jetike në këto komuna. Shuma totale e fondeve të ofruara si mbështetje financiare për financimin e detyrimeve të pashlyera dhe të papaguara për komunat është, 3.032.383.086 denar ose 49.307,042 euro d.m.th. 51% e shumës totale të raportuar të komunave dhe njësisve shpenzuese, nga shtatori 2018. (*Tabela nr. 11*). Në regjistrimin e fundit, të vitit 2002, nga të dhënat statistikore që mban zyrtarisht enti statistikor i RMV, të dhënat zyrtare japin pasqyrën e përkatësisë etnike të popullatës:

Tabela nr. 11: Pasqyra e regjistrimit të popullsisë në MV, 1953-2002.

Regjistrimi i popullsisë 1953-2002														
Etnikumi	1953	%	1961	%	1971	%	1981	%	1991	%	1994	%	2002	%
Maqedonas	860,699	65.98%	1,000,854	71.18%	1,142,375	69.35%	1,279,323	67.01%	1,328,187	65.30%	1,295,964	66.60%	1,297,981	64.18%
Shqiptarë	162,524	12.46%	183,108	13.02%	297,871	18.08%	377,208	19.76%	441,987	21.73%	441,104	22.67%	509,083	25.17%
Turq	203,938	15.63%	131,484	9.35%	108,552	6.59%	86,591	4.54%	77,080	3.79%	78,019	4.01%	77,959	3.85%
Rom	20,462	1.57%	20,606	1.47%	24,505	1.49%	43,125	2.26%	52,103	2.56%	43,707	2.25%	53,879	2.66%
Vlleh	8,668	0.66%	8,046	0.57%	7,190	0.44%	6,384	0.33%	7,764	0.38%	8,601	0.44%	9,695	0.48%
Bullgar	920	0.07%	3,087	0.22%	3,334	0.20%	1,980	0.10%	1,370	0.07%	1,682	0.09%	1,487	0.07%
Musliman	1,591	0.12%	3,002	0.21%	1,248	0.08%	39,513	2.07%	31,356	1.54%	15,418	0.79%	2,553	0.13%
Serb	35,112	2.69%	42,728	3.04%	46,465	2.82%	44,468	2.33%	42,775	2.10%	40,228	2.07%	35,939	1.78%
Gjithsej:	1,304,514		1,406,003		1,647,308		1,909,136		2,033,964		1,945,932		2,022,547	

Burimi: <http://www.stat.gov.mk.GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wu1a & cof.FORID%3A10&ie.UTF8&q.enicka+pripadnst&sa>.

Mungesa e kohezionit politik ka krijuar kushte të vështira për zhvillimin e një politike të mirëfilltë të vlerave të një sistemi politiko-demokratik, që duhet të zhvillohet në kulturën politike dhe demokratike të një shoqërie multietnike. Kjo gjë nënkupton faktin që, pjesa që i referohet përkatësisë etnike shqiptare, për dallim nga vitet e kaluara e deri më sot, është gjithnjë e më tepër në rënie, si pjesë e banorëve që mbeten për të jetuar në këtë vend, si pasojë e një politike diskriminuese dhe tendencioze nga autoritete maqedonase, të cilët dukshëm punojnë në minimizimin e kushteve për qytetarët shqiptarë. Duke zvogëluar buxhetin financiar dhe limituar në nivel të ulët buxhetin në të gjitha sferat, në kulturë, arsim, shëndetësi dhe pothuajse në të gjithë sektorët e tjerë të shërbimit publik. Këto konstatime dhe një sërë elementesh të tjerë, vështirësojnë jetën e përditshme të qytetarëve shqiptarë dhe bëjnë që ata çdo ditë e më tepër të zbrazin vendbanimet e tyre, për të emigruar në vendet e perëndimit në kërkim të një jete më të mirë.

Një argument tjetër që përkon me formën e politikës diskriminuese, e nënkuptuar si formë e një rituali të vjetër politik që nga periudha e ish-Jugosllavisë, e kanë krijuar dhe trasmetuar si përvojë në rrethanat e politikbërjes në praktikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në sferën e politikave sociale, në mënyrë të dukshme, shfaqet tendenca e qeverisë qendrore, e cila ende mbetet e diktuar nga ndjenja të theksuara nacionaliste, duke vijuar të diskriminojnë subjektet dhe popullsinë shqiptare, prej frikës së një nataliteti të lartë në pjesën e banuar me


shqiptarë. Për të vërtetuar një fenomen të tillë, po i referohemi disa të dhënave të mbartura nga koha, sipas studimeve dhe statistikave të sjella me korrektësi shkencore nga studiues shqiptarë.

“Në periudhën e ish Jugosllavisë së pas L2B, populli me natalitetin më të lartë ishin shqiptarët. Edhe mes tyre kishte dallime prej vendit ku jetonin. Kështu, shqiptarët e maqedonisë, në rregjistrimin e vitit 1953 kishin natalitetin më të lartë ndër shqiptarët e ish Jugosllavisë, por edhe më të lartë se të gjithë popujve të saj. Kështu, nataliteti kapte shifrat 52.7 për mijë, ndërsa tek shqiptarët e Kosovës ishte 45.9 për mijë. Natalitetin më të ulët e kishin shqiptarët në Malin e Zi me 29.5 për mijë. Në rregjistrimet e vitit 1961, nataliteti do të bjerë tek shqiptarët, por përsëri do të jetë më i lartë tek popujt e tjerë të ish Federatës Jugosllave. Shqiptarët e Maqedonisë përsëri do të kenë natalitetin më të lartë me 47.4 për mijë, shqiptarët në Kosovë 46.3 për mijë dhe në Malin e Zi me 26.3 për mijë. Karakteristike është rregjistrimi i vitit 1971, ku natalitetin më të lartë do ta kenë shqiptarët në Kosovë me 42.3 për mijë, në Maqedoni me 39.4 për mijë dhe në Malin e Zi me 19.2 për mijë. (Veliu, Rahmi. 2002:46).

Frika ndaj natalitetit të lartë, nxit qeverinë në RMV të gjejë rrugë dhe forma të tjera për uljen e vlerave të tij. Të njetin shqetësim shfaq sot edhe qeveria në Serbi, e cila në raportet e saj i vlerëson shqiptarët 26 vjet më përpara popullsisë serbe. (Vuçiç, mars 2019).

Pasqyrë e këtij qëndrimi në RMV është edhe buxheti financiar, i cili mbetet diskriminues. Për këtë arsye, në buxhetin e komunave hiqet pjesa e fondit të stimulimit me fond të veçantë për rritjen e natalitetit. (grafiku nr. 2).

Grafiku nr. 2: Të dhënat statistikore të fëmijëve të lindur sipas përkatësisë etnike.




Burimi: [http://www.stat.gov.mk.GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wu1a & cof.FORID%3A10%26ie.UTF8%26q.enicka+pripadnost&sa](http://www.stat.gov.mk.GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wu1a%20%26%20cof.FORID%3A10%26ie.UTF8%26q.enicka+pripadnost&sa).

Në tabelë janë të dhëna, të cilat pasqyrojnë natalitetin sipas përkatësisë etnike, ku me automatizëm është shfaqur dominimi i etnitetit maqedonas. Shqiptarët si etnitet i dytë, në rritjen

demografile sipas natalitetit, dëshmojnë me shifra që sipas vlerësimit të politikës, shfaq një efekt negativ për shkak të diskriminimit financiar dhe stimulues. Vendimet tendencioze të qeverisë mbi mbashtetjen financiare të popullsisë dhe komunave shqiptare, sjellin një qëndrim në kushte të pabarabarta sipas përkatësisë etnike. Privilegjet për qytetarët maqedonas janë të dukshme në këtë shtet.

Grafiku nr. 3: Të dhënat statistikore të fëmijëve të lindur sipas religjioneve 2017.



Burimi: [http://www.stat.gov.mk/GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wula & cof.FORID%3A10&ie.UTF8&q.enicka+pripadnst&sa](http://www.stat.gov.mk/GSearch.aspx.cx,005984792435174779271%3Av7t0sn-wula%20&cof.FORID%3A10&ie.UTF8&q.enicka+pripadnst&sa).

Rasti i figurës së dytë krijon bindjen se, bazuar në këto të dhëna që shikohen, përpara se qeveria të ketë qëndrimin diskriminues, të dhënat krijojnë një pasqyrë të qartë të aktorëve dominant të qeverisjes, duke u bazuar nga rajoni i përfaqësuar me banorë. Dukshëm veçohet kryeqyteti i Shkupit, Pollogu, si rajone të banuar me pothuajse 90% me shqiptarë.

Të dhënat statistikore imponojnë një qasje tjetër të qeverisë maqedonase, e pasqyruar në vendimet e saj në lidhje me mjetet financiare. Qeverisja aktuale është duke rikthyer përvojën e vjetër të ish sistemit komunist, me një mospërkrahje totale të familjeve shqiptare, për uljen artificiale të numrit të popullsisë shqiptare në RMV.

Mungesa e natyrës sociale të shtetit, është një tjetër difekt serioz në plotësimin e standardeve bashkëkohore të një qeverisje që pretendon se është e orientuar në frymë perëndimore të demokracisë.

VI.4. Intervista


Në intervistën e realizuar, përveç mendimeve të shprehura nga njerëz të ndryshë, janë marrë në konsideratë opinionet e dhëna nga Zonja Edita Tahiri në vitin 2016, e cila në këtë periudhë ushtronte detyrën e Ministres për Dialog në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Versioni i realizimit të pyetsorit është kryer me incizim elektronik.

Në të dhënat kryesore të intervistës, rëndësi i është kushtuar strukturës së saj, e cila ka prekur grupmoshat, gjininë, nivelin arsimor, përkatësinë etnike, vendet e punës në raport me institucionet, niveli i diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike, mendimi individual mbi rolin e inestitucioneve në raport me ruajtjen e vendeve të punës dhe respektimin e të drejtave njerëzore etj.

Rast pas rasti, sipas trajtimit të pyetjeve, do të kuptohet se struktura e pyetsorit është ndërtuar me kujdes, nga më e thjeshta drejt përgjigjeve dhe problemeve më të ndërlikuara, të cilat në vertikalen veprimit dhe ndikimit të tyre, depërtojnë në mënyrë racionale në tiparet më kryesore dhe në vetë thelbin e natyrës së politikbërjes në shtetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Analiza dhe krahasueshmëria ka sjell përfundime interesante në mbështetje të argumentuar të vërtetimit të hipotezës kryesore të studimit.

VI.5. Pyetësi

Figura 1: Të dhënat moshore të të intervistuarve.



Në bazë të analizave që janë bërë, moshë është konsideruar si një pjesë e rëndësishme e lëndës, me ndikim në përgjigjet e pyetsorit. (fig. nr. 1). Të intervistuarit e moshës 21 – 30 vjeç kapin

shifrën 27% të individëve. Synimi për të qenë në rend të dytë të të intervistuarve, ka të bëjë me faktin që ata përgjithësisht janë jashtë strukturave shtetërore, një pjesë të papunë, pa shumë përvojë në jetën politike dhe më pak të interesuar për t'u përfshirë në angazhimin politik.

Brenda kësaj grupmoshe përfshihen të rinjtë studentor, të cilët janë dhe pjesa me kualitative e intervistës. Mendimi i tyre ka rëndësi për të vlerësuar balancimin me grupmoshat e tjera, të cilët në raport me të rinjtë mund të jetojnë dhe veprojnë në kushte më të favorëshme jetësore e instrucionale sesa ata.

Të intervistuarit në nivelin e parë deri në masën 37%, kanë qenë të moshës nga 31 – 40 vjeç. Sipas arsyetimit logjik, kjo moshë është konsideruar si një moshë mesatare mes brezave, me përvojën dhe pjekurinë e nevojshme politike dhe sociale, të arsimuar dhe më së shumti të punësuar në administratat shtetërore dhe në sektorin publik e privat. Në vlerësimin e përgjithshëm, kjo moshë konsiderohet kryesisht e re dhe me ndjesi më të forta të kurajos qytetare.

Të intervistuarit në nivelin e dytë në masën 23%, përfshijnë grupmoshën nga 41 - 50, edhe kjo një moshë relativisht e re. Pjesa dërmuese e tyre janë të përfshirë me punë në administratën shtetërore dhe sektorin privat. Kjo kategori shfaq një mendim më të ekuilibruar, për shkak të raporteve që ata kanë me shtetin dhe me subjektet politike. Kjo moshë është më e prirur të jetë pranë stafeve të subjekteve politike, për të garantuar vazhdimësinë në punën shtetërore.

Të intervistuarit e nivelit të tretë në masën vetëm 9%, janë individët e moshës nga 51 – 60 vjeç, të vlerësuar si moshë e pjekur dhe me përvoja të ndryshme në angazhimin dhe jetën politike e sociale të vendit. Kategoria e fundit e të intervistuarve deri në masën 4%, janë individë me moshë mbi 61 vjeç, të cilët janë në kufirin e moshës së tretë. Pjesa dërmuese e tyre në kushte pensioni dhe aktiviteti privat.

Në të 5 grupmoshat e intervistuar, tre nivelet e para janë ato që dominojnë në mes moshës 21 vjeç deri në 50 vjeç. Mbi këto të dhëna, të cilat përfaqësojnë edhe grupmoshat e popullsisë në RMV, është realizuar një harmonizim i të anketuarve, të cilët në mendimin e përgjithshëm, përfaqësojnë më shumë sesa vetëvetja me opinionet e tyre.


Në përvojën dhe pjekurinë e tyre jetësore, ata janë shfaqur kurajozë, të ekuilibruar, por edhe jo realist për shkak të konfliktit të interesit. Rezultatet e të intervistuarve mbi këto të dhëna, mbshteten kryesisht tek individët që janë të përfshirë në tregun e punës, ku veçojmë dy aspekte.

Së pari, ata janë pjesë aktive e politikbërjes, pasi janë përgjithësisht pjesë e administratës publike, janë më afër subjekteve dhe grupeve politike, dhe në këto kushte kontribuojnë realisht në qëndrimin dhe mendimin politik në politikbërje.

Së dyti, tendenca e rrumbullakosjes së mendimeve për shkak të kofliktit të inetersit me shtetin dhe vendin e punës, në një përqindje të ulët nuk kanë dhënë mendimin real. Pjesmarrja e tyre në administratën publike, sipas raporteve të përfaqësimit politik të subjektit që i takojnë, është një arsye frenimi drejt mendimeve të përgjithëshme, të cilat mund të mos përfaqësojnë realitetin poltik.

Kjo specifikë është veçuar me kujdes në përfundimet e përgjigjeve. Përfundimet e mëposhtëme sipas problematikës së shtruar me karakter politik dhe social, japin mundësinë e ndikimit të këtij faktori objektiv në mendimin e përgjithshëm politik, mbi politikbërjen në RMV.

Figura 2: Të dhënat moshore të të intervistuarve.




Si në shumë shtete, në RMV nuk mund të shmangen tendencat e mosrespektimit të përfaqësimit gjinor në administratën publike apo dhe në pjesmarrjen e grave dhe vajzave në veprimtarime me karakter politiko – siocial dhe kulturor (*fig. nr. 2*). Përballë konceptit me ndikim shoqëror, në numrin e të intervistuarve është mbajtur parasysh ky kriter, duke përfaqësuar një raport të pranueshëm nga 300 të anketuarit, me pjesmarrje 53% meshkuj dhe 47% femra.

Edhe pse ky nuk është një detyrim ligjor, prania e tyre pothuajse në nivel të barabartë është një detyrim shoqëror, etik, kulturor, një mënyrë e respektit që meriton gjinia femërore për t'u përfshirë masivisht në politikbërjen e shtetit dhe të shoqërisë. Çështjet e barazisë gjinore janë një kërkesë standardive e kushteve të parashtruara të intergrimit të vendin në BE. Realizimi praktik i parametrave të intervistës në këtë çështje, rrit vlerat përgjithësuese të materialit studimor.

Një element tjetër i rëndësishëm në realizimin e intervistave ka të bëjë me nivelin arsimor e profesional të të intervistuarve (fig. nr. 3). Ky tregues vlerësohet i më i rëndësishmi në thelbin e intervistës, sepse niveli arsimor dhe përvoja institucionale janë dy element që ndikojnë fuqimisht në mendimin kualitativ, në interes të problemit të shtruar. Janë këta individë të arsimuar, të cilët janë përfshirë në administratën shtetërore dhe atë politike.

Sipas të dhënave të diagramës së mëposhtme, rreth 61% e të anketuarve janë me arsim të lartë universitar, rreth 24% të përfshirë në nivelin “master”, vetëm 12% me arsim të mesëm, dhe 3% të kualifikuar në nivelin shkencor akademik. Në vështrimin e përgjithshëm shfaqet raporti 1:2 midis arsimit universitar (61%) dhe individëve të kualifikimit shkencor “master – doktoraturë” (24%+3%). Këto të dhëna janë një tregues shumë cilësor i nivelit arsimor të intervistës së realizuar.

Figura 3: Niveli arsimor i të intervistuarve.



Për sa i takon përkatësisë etnike, (fig. nr. 4) intervista është përballur me vështirësinë e pjesëmarrjes etnike, duke mundur dominimin e mendimit në shumicë të shqiptarëve të përfshirë në të.

Në logaritmin numerik, 66% e të intervistuarve janë me përkatësi etnike shqiptare, të punësuar në sektorin publik, kryesisht në ministri apo drejtori të strukturës qeveritare. Kategori e dytë me 16% janë të etnisë maqedonase, dhe kategoria e tretë me 12% janë të etnisë turke, vllehe, serbe dhe rome. Vetëm 6% janë të ndryshëm.

Raporti 3:1 në favor të të intervistuarve me etni shqiptare, sigurisht mund të shpreh mendimin dominat të palës shqiptare, por në fakt, nisur nga problemi që parashton hipoteza kryesore e

studimit, është pikërisht popullsia me etni shqiptare ajo që, në RMV ndihet më e diskriminuara në të gjitha aspektet.

Në analizën e problemit mendimi shqiptar ka shumë rëndësi, për të sjell gjithë problematikën që shfaqin kushtet social - politike dhe ekonomike dhe pasojat që shkarkon mbi këtë popullsi politikbërja shtetërore në RMV.

Intervista për këtë shkak, ka hasur vështirësi dhe në ndonjë rast është paragjykuar politikisht. Shpjegimi me durim i qëllimit të intervistës dhe serioziteti i kërkesave për realizimin e saj, paanshmëria, ka mundur të përfshijë individë me etni të tjera, por në numër të kufizuar. Kur flasim për raportet etnike të 300 të anketuarve, sigurisht në krahasueshmërinë e përgjigjeve, nën përgjegjësinë e disiplinës shkencore, është shmangur anshmëria, duke vlerësuar mendimet reale mbi politikbërjen.

Figura nr. 4: Përkatësia etnike e të intervistuarve.



Pyetja e mëposhtëme merr karakter të veçantë, (fig. nr. 5) për shkak se brenda anës numerike të saj, shfaqen interesat vetjake të individëve, të cilët gjithësesi, pranojnë të japin përgjigje pyetsorit. Pozicioni i tyre ka lidhje dhe raporte shkakësore jo vetëm me politikbërjen, por në një përqindje të konsiderueshme edhe me vendimmarrjen politike, qoftë brenda subjektit politik, po ashtu dhe me pjesëmarrjen në administratën shtetërore, deri në nivele të larta përfaqësimi. Konkretisht, nga të intervistuarit rreth 40% e të anketuarve rezultojnë pjesë e sektorit qeveritar, rreth 35% janë të përfshirë në sektorin publik, rreth 13% përfaqësues të sistemit gjyqësor, 9% të sektorit privat dhe vetëm 3% të punësuar në pushtetin lokal.


Kjo shpërndarje shifrash ka sjell përgjigje interesante, duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e të intervistuarve janë individë të sektorit qeveritar, të cilët kanë role kyçe në politikbërjen shtetërore të RMV. Në vështirimin e përgjithshëm, 97% e të intervistuarve janë rrogëtar shteti.

Pjesmarrja e vogël e të intervistuarve në sektorin privat shfaqet si hapësirë e ngushtë interpretimi, sepse njerëzit që drejtojnë bizneset si në çdo shoqëri demokratike, janë ata që sjellin mendimet më të arrira dhe kurajoze për raportet midis politikbërjes dhe interesave, kur gjykojmë se kjo ka të bëjë me anën ekonomike të trajtimit të shoqërisë.

Në intervistë sektori gjyqësor dhe pushteti lokal nuk kapin më shumë se 16% të individëve. Kjo shifër mund të vlerësohet si një pikë e dobët e intervistës, pasi veçanërisht pushteti lokal ka një peshë të madhe të politikbërjes konkrete me interesa qytetare të sektorit publik, ku më së shumti përplasen pasojat e kësaj politike.

Ndoshta pjesmarrja më e madhe në këtë sektor do të sillte një gamë më të gjerë problemesh, edhe pse mjaft mendime e opinione janë të konsoliduara tek punonjësit dhe qytetarët shqiptarë. Distancimi i numrit të punonjësve të sektorit privat të biznesit dhe të pushtetit lokal, mund të konsiderohet një mangësi teknike e intervistës.

Figura nr. 5: Punësimi i të intervistuarve në organet vendimmarrëse të politikës.



Diskriminimi, si një faktor i devijimit të procesit të politikbërjes

Për shkak të marrëdhënieve të ndera mes etnive në RMV, rëndësi në pyetsorin e intervistës i është kushtuar mendimit mbi ushtrimin e presionit dhe diskriminimit të punonjësve dhe shtetarëve shqiptarë në vendin e punës. (*fig. nr. 6*).

Vendosja e kësaj pyetje dhe përgjigjet për këtë çështje, janë një tregues real i ushtrimit të presionit dhe kërcënimit me humbjen e vendit të punës, që sjell si pasojë nënshtrimin dhe servilizmin politik, duke shkatuar dëme në politikbërjen shtetërore, ku kontributi i të gjithë individëve duhet të jetë standard brenda përgjegjësisë shtetërore, pavarësisht përkatësisë etnike.

Përgjigjet e kësaj pyetje marrin vlerë të dyfishtë, sepse ato janë pasqyrë e gjendjes reale të asaj që vepron në fakt brenda strukturës shtetërore, pavarësisht demagogjisë apo shfaqjes formale të respektimit të standardeve mbi përgjegjësitë shtetërore.

Sipas renditjes shifrore, 55% e të anketuarve e kanë pasur këtë përvojë të hidhur disa herë, dhe janë të vetëdijshëm se çfarë do të thotë diskriminim etnik, kur të vënë nën presion psikologjik duke llogaritur vendin e punës apo bukën e gojës.

Vetëm 29% e pranojnë sfidën dhe kërcënimin që u është bërë, duke dhënë përgjigje pohuese. Në pjesën më të vogël numerike, vetëm 5% pranojnë se ky kërcënim u është bërë shpesh herë, 10% shprehen shkurt në mënyrë mohuese dhe vetëm 1% nuk është përballur asnjëherë me këtë fenomen.

Nga kjo paraqitje numerike, mund të evidentohet lehtë një dukuri e ndërthurur, që ka të bëjë me kërkesat e plotësimit të administratës në hierarkinë e saj dhe në karrierën e individëve, po ashtu të përballjes së individëve me anën ligjore të mbajtjes apo përfitimit të vendit të punës, prapa të cilës fshihet presioni psikologjik shtetëror që nxit dhe ushqen diskriminimin etnik.

Përballja me korrnizën ligjore, fsheh qëndrimin diskriminues, kur kjo nuk ndodh në shtetarët me përkatësi etnike maqedone. Njerëzit e paprekur nga ky fenomen përbëjnë vetëm 1/10 e individëve të anketuar. Sigurisht, këta përfaqësojnë nivele të larta qeverisëse, ku interesat vetjake janë të përfshira brenda dëshirës, vullnetit dhe detyrimit institucional, për të zbatuar kërkesat e platformës qeverisëse në koalicion.

Ngushtimi i përgjigjeve drejt vlerave minimale, shkon në raport me vendin e punës dhe përfshirjen e individit në hierarkinë shtetërore. Është një arsye më shumë për të gjykuar qëndrimin që mban opinioni i gjerë ndaj disa figurave të larta shtetare në qeverisjen në RMV, të cilët edhe pse duhet të mbrojnë interesat e qytetarëve shqiptarë si dhe të tjerëve, shpesh bëhen

palë dhe pjesë e dhunës ligjore shtetërore me doza diskretitimi dhe veçimi për popullsinë shqiptare.

Figura nr. 6: Të dhënat e diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike.



Për shkak të rritjes cilësore dhe të dimensionit të anës vlerore të pyetjeve, është menduar që të trajtohet edhe një çështje tjetër, e cila ka natyrën e saj delikate, sepse ka të bëjë me respektimin e të drejtave njerëzore, nëpërmjet respektimit të detyrimeve prej Konventave Ndërkombëtare në trajtimin e popullsisë me etni më të vogla brenda shtetit. (fig. nr. 7).

Ky kapitull merr vlera dhe rëndësi të veçantë, sepse ai është një parakusht i plotësimit të standardeve të politikbërjes, si pjesë e rëndësishme e standardeve të pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin European.

Aspekti i përmbushjes së këtyre normave është një moment delikat, ku vlerat e përgjigjeve të opinionit e kapërcejnë koeficientin e zakonshëm të raportimeve rutinë mbi jetën politike në vend. Rëndësi këtu merr zbatimi në praktikë i normave dhe standardeve ndërkombëtare brenda kornizave të mirëfunksionimit të shtetit. Disiplina mbi analizën shkencore të këtyre shifrave, përveç anës subjektive, merr karakter praktik. Ajo mundëson edhe rekomandime të thekëshme në përmirësimin e gjendjes.

Nga vështrimi numerik, rezulton se shumica e të intervistuarve, 32% mendojnë se këto norma ndërkombëtare nuk respektohen nga shteti dhe pushteti. Kjo nxjerr në dukje formalizmin institucional dhe ligjor në raport me realitetin. Kjo evidencon gjithashtu, rumbullakosjen,


zbutjen dhe më keq akoma, fshehjen e gjendjes që bën shteti në raportet periodike që delegon në institucionet ndërkombëtare.

Po kështu, 28% e të anketuarve kanë mendim se këto norma nuk zbatohen mjaftueshëm. Ky opinion shton vlerën negative të përgjigjes së përqindjes së parë. Pra, në thelb rreth 60% (32%+28%) rreshtohen në krahun e përgjigjeve negative për këtë çështje. Ky tregues nuk është pak, nëse vlerësojmë shifrat më poshtë, ku 19% kanë mendimin “*mjaftueshëm*”, 3% nuk pranojnë të përgjigjen dhe vetëm 18% mendojnë se këto akte normative respektohen në RMV.

E thënë në mënyrë të përmbledhur, në këtë shtet vetëm një e pesta e të intervistuarve mendojnë pozitivisht për politikbërjen shtetërore në fushën e respektimit të të drejtave njerëzore dhe etnike. Më shumë sesa për shtetarët maqedonas, kjo e dhënë ka vlerë për politikanët dhe shtetarët shqiptarë, të cilët nuk mund dhe nuk duhet të tolerojnë kur është fjala që, shteti dhe pushtetit të vihen në mbrojtje të të drejtave njerëzore mbi bazën e normave ndërkombëtare.

Në fund të fundit ky është treguesi më i ndjeshëm i përgjegjesive të tyre politike, partiake e shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe etnive të tjera.

Figura nr. 7: Të dhënat mbi respektimin e konventave dhe ligjeve ndërkombëtare.



Vlerësimi dhe respektimi i raporteve ndëretnike në RMV, është një çështje e rëndësishme e politikbërjes së mirë shtetërore. (fig. nr. 8). Opinioni shqiptar por dhe pjesa akademike e tij, janë të interesuar për vlerat e tij, sepse kjo është një nga pikëkthesat në përgjegjësitë e institucioneve dhe individëve me pushtet, për të ndërtuar ura lidhje dhe bashkëpunimi në bashkëjetesë, në interes të stabilitetit të brendshëm dhe të plotësimit të interesave gjeopolitike të shtetit.


Mënyra grafike dhe vlerore e përdorur për të testuar të intervistuarit, sjell një qasje interesante me sensin pozitiv, çfarë jep të kuptohet se, në stadin aktual këto raporte kanë ç'tensionuar deri në një farë mase situatën e mëparshme kontradiktore me doza armiqësie, veçanërisht mes popullsisë maqedonase dhe asaj shqiptare.

Duke arritur në nivelin e pikave më të larta, 6 dhe 8 në raport me kornizën numerike 1 – 10, ulja e kurbës tregon se shumica e të intervistuarve mendojnë se këto raporte janë zbutur, pas largimit nga pushteti i VMRO-DPMNE, e cila për më shumë sesa një dekadë i acaroi këto marrëdhënie dhe i dëmtoi raportet ndëretnike në nivelin më të lartë.

Zgjedhja e Kreut të Parlamentit nga politika shqiptare, kalimi i ligjit për gjuhën shqipe, nxjerrja para përgjegjësisë dhe drejtësisë e disa ish-funksionarëve të lartë shtetëror, vullneti politik për të thelluar reformat institucionale dhe së fundi, miratimi i Marrëveshjes së Prespës duke normalizuar marrëdhëniet me Greqinë, kanë krijuar një klimë më të favorëshme besimi ndaj politikës dhe vlerave të politikbërjes në RMV.

Shpresa për të nxjerrë para përgjegjësisë ligjore dhe drejtësisë e njerzve që janë të implikuar në ngjarje të rënda që kanë shoqëruar jetën politike në këtë shtet, rregullimet ligjore kundër diskriminimit etnik, përpjekjet për rregjistrimin real të popullsisë dhe disa drejtime të tjera që kanë të bëjnë me Kodin Zgjedhor, kanë filluar të lëvizin në një konotacion më pozitiv, duke ulur nivelin e urrejtjes ndëretnike.

Grafiku nr. 4: Shkalla e raporteve sociale në shoqëri multi-etnike në RMV.



Sot diversiteti pasqyron një nga vlerat e kulturës në shoqëritë multi-etnike. Ai ndikon në emancipimin shoqëror në përmirësimin e komunikimit ndërkulturor dhe sjell qasje të reja me

ndikime pozitive mbi situatën sociale, për gjetjen e rrugëve drejt diversitetit në bashkëjetesë. (grafiku nr. 4).

Sipas analizës numerike, 30% e të intervistuarve mendojnë se diversiteti ka vlera pozitive, 41% përqind janë skeptik dhe mendojnë “*deri diku*”, 15% mendojnë negativisht dhe po 15% janë kategorik kundër këtij mendimi.

Raporti numerik paraqitet 2:1 në vlera pozitive. Duke bërë krahasimin e qëndrimeve dhe përgjigjeve, në këtë çështje delikate nxjerrim disa përfundime interesante, të cilat i vlejné realitetit, pasi kjo është një fushë ndërveprimi, e cila po të funksionjë mirë dhe të ushqehet sipas standardeve të kohës, krijon raporte të mira ndërtnike.

Pozitiviteti në qëndrim dhe pranimi i diversitetit sjell një shkallë më të lartë të nivelit të emancipimit shoqëror, duke e bërë më të lehtë punën e politikbërjes për të kapërcyer barrierat frenuese në komunikimin mes etnive me kultura të ndryshme.

Pozitiviteti i përgjigjeve arrin të shpreh dhe të pranojë disa nga kriteret që duhen respektuar për vetëpërcaktimin identitar dhe kulturor, duke i kushtuar rëndësi komunikimit ndëretnik, si faktor kryesor në marrëdhëniet ndërkulturore.

Kjo mënyrë të menduari sjell qasje të reja sociologjike qytetare, kundër antagonizmave ndërkulturore. Ajo vendoset në bazën e bashkëjetesës dhe komunikimit ndërkulturor të popujve. Statistika e intervistës sjell qasje të re edhe për shkencat politiko – sociale, pasi nga përvojat e vendeve të tjera, ka raste që etni të ndryshme janë integruar në ndërgjegjen kombëtare të vendit ku jetojnë. Duhet pranuar se ekziston një lloj ndërgjegje kombëtare e karakterit politik.

Ky është një element i ri politik sot në botë, që nuk është bërë ende objekt i politologëve, të cilët më shumë sesa të orientuar drejt “*diversitetit për diversitet*”, mund të hedhin bazat e bashkëjetesës, e cila nuk ka të njëjtën natyrë me teorinë e integritit që kërkon të realizojë qytetërimi europian. Mbi bazën e ruajtjes së prejardhjes etnike, mund të krijohet një ndërgjegje kombëtare e re, tek e cila padyshim ndikojnë rrethanat favorizuese ekonomike, politike, kulturore dhe ekonomike.


Nga përgjigjet e pyetjeve nënkuptojmë se, identiteti kulturor është i ndërtuar në harmoni me kushtet specifike të proceseve kohore dhe ndikohet nga koha dhe hapësira. Si koncept, paraqitet me nocionin e vazhdimësisë dhe në nocionin e ndryshimit pa pasur kontradikta. Këtij identiteti i

afrohet autenticiteti, i cili nuk është natyror dhe i lindur, por i ndërtuar në kontekstin historik dhe social, në vetë kuptimin e prurjes së historisë në krijimin e këtij identiteti.

Në këto kushte, identiteti kulturor dhe fetar tentojnë të sjellin ndikime mbi identitetin kombëtar, duke e bërë atë të ndryshueshëm në kohën historike dhe në hapësira gjeografike. Tendenca të tilla janë shfaqur në politikbërjen e shtetit në RMV.

Nga pozitiviteti i përgjigjeve, në një kuptim më të ngushtë, trajtimi në diversitetet e kushteve dhe marrëdhënieve të ndërvarësisë kulturore në hapësira të vogla, brenda popullsisë dhe komuniteteve, nuk sjellin ndikime mbi identitetin autentik të popullit. Rasti në Rekën e Epërme tregon se kultura e popullsisë shqiptare në shtetin maqedon ka shfaqur tendenca të rikthimit, edhe atje ku koha historike ka lënë pasojë për shkak të diskriminimit etnokulturor.

Figura nr. 8: Të dhënat mbi diversitetin politik si pjesë e kulturës shoqërore.




Diversiteti do të mbetet një nga vlerat pozitive të ushtrimit të normave morale e politike, të respektimit të vlerave kulturore dhe si një tregues i nivelit të lartë të emancipimit shoqëror. Mbrojtja e shtetit multietnik është detyrim dhe përgjegjësi kombëtare dhe shtetërore e popujve dhe kombeve që jetojnë brenda tij.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një fakt dhe stereotip i shtetit multietnik. Jo pa qëllim intervista e realizuar për këtë çështje sjell një mendim dhe gjykim shumë interesant. (fig. nr. 8). E ballafaquar me realitetin, njerëzit njëkohësisht mendojnë seriozisht se si mund të jetë më mirë në të ardhmen, ku jeta dhe prona të jenë më të sigurta, dhe politikbërja të gjenerojë siguri dhe zhvillim dhe jo të jetë konsumatore e tyre.

Kështu, 37% e të anketuarve kërkojnë një sistem të mirëfilltë juridik në RMV. Me sa kuptohet, ajo që ka munguar deri tani. Rreth 21% janë për një qeverisje të hapur dhe demokratike. Me sa duket, ky është një element i munguar deri tani. Rreth 22% përqind kërkojnë një trajtim të barabartë brenda shtetit. Nëse dy kërkesat e para janë të natyrës demokratike, kërkesa e tretë ka motive multietnike të bashkëjetesës dhe të sigurisë.

Këto janë tre përfundime interesante, ku brenda të intervistuarve rreth 20% nuk japin përgjigje. Pra, intervista në vertikalen e saj çon në disa prurje dhe qasje mendimi dhe gjykimi shumë pozitive, të cilat kanë të bëjnë me vetë të ardhmen e shtetit të RMV. Shkurt, populli kërkon një qeverisje të mirë, ku të kenë besim në sistemin e drejtësisë dhe të sigurisë publike. Tre elementët thelbësor të politikbërjes së mirë dhe të funksionimit të shtetit demokratik me standarde bashkëkohore.

Figura nr. 9: Të dhënat mbi mbrojtjen e vlerave të shtetit multietnik në RMV.



Angazhimi i qytetarëve në jetën politike të vendit, është treguesi i emancipimit shoqëror dhe vetëpërgjegjësisë për jetën e tyre. (fig. nr. 9). Intervista në këtë aspekt thellon mendimin mbi politikbërjen në vertikalen e saj. Rreth 47% e të intervistuarve rezultojnë pjesmarrës në protesta masive me karakter politik. Rreth 25% e tyre janë aktivistë të angazhuar me OJQ, 14% e tyre përfshihen në iniciativa qytetare dhe 13% merren me veprimtari politike të mirëfilltë. Vetëm 1% e tyre nuk shprehin interes ndaj politikbërjes.


Përfshirja e gati gjysmës së të intervistuarve në protesta masive me karakter politik, është një shprehje direkte e natyrës së vetë pushtetit politik, në kontradiktë dhe në krizë besimi ndaj qytetarëve.

Një prej nxitjeve me motive demokratike prej faktorit ndërkombëtar, është pikërisht ndërgjegjësimi i qytetarëve, që ata të bëhen pjesë e proceseve dhe zhvillimeve politike në vend. Funksionimi i shumë OJQ ka pikërisht këtë qëllim. Angazhimi i ¼ të të intervistuarve në këto organizata, është shprehje e këtij investimi me ndërkombëtar në funksion të rritjes së vlerave demokratike, drejt një shoqërizimi social në shërbim të politikbërjes.

Nëse ka një shpjegim në këtë çështje, motivet në çdo rast të popullsisë shqiptare për reagimin ndaj pushtetit dhe shtetit janë politike, me përmbajtje kundër diskriminimit racor dhe etnik. Kërkesat e vazhdueshme, pavarësisht zbutjes që i bën problemit subjekti politik shqiptar, orientohen drejt konceptit të federalizimit të shtetit, apo të ndarjes së tij.

Ky motivim mbështet edhe këtë statistikë të anketimit, ku pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk do të ngurrojnë as në të ardhmen të bëhen pjesë e protestave masive kundër diskriminimit etnik.

Figura nr. 10: Të dhënat mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset politike të ndryshimit.




Pyetja e shtruar në figurën nr. 10, në thelb sjell një tregues interesant, por jo të papritshëm për mendimin që mbizotëron sot në RMV. Në anketim, 49% mendojnë për përmirësimin e legjislacionit dhe ndërtimin e shtetit ligjor. Shumëkush shqiptar në këtë shtet ka ndjer mbi shpinë trysninë e ligjeve, përballë revoltës së brendshme kundër tyre.

Legjislacionin e deformuar pushteti politik në RMV e ka përdorur si morsë shtrënguese, jo vetëm për të goditur dhe kontrolluar veprimtarinë me karakter etnik, por duke krijuar vështirësi në aspektin ekonomik, për të mos i krijuar hapësira veprimi tendencave të para.

Ky mekanizëm shtrëngues, me ose pa dashje, është kthyer në gjenerues i pasigurisë dhe përplasjeve politike. Nuk është rastësi që, rreth 36% e të intervistuarve mendojnë për përmirësimin e situatës ekonomike. Vetëm 9% e të intervistuarve mendojnë se shtetit i duhet kultura politike, ndërsa 6% shfaqin mendime që s'kanë peshë në ndryshime të rëndësishme në jetën e vendit. Kur 85% e opinionit publik (49%+36%) vendosin gishtin në plagë, do të thotë që kriza është e pranishme dhe çështja e aspiratave qytetare drejt integritimeve do të mbetet vetëm një ëndërr e parealizuar.

Duke i parë me kujdes të dhënat, binomi jetik *politika dhe ekonomia*, mbeten dy problemet shqetësuese, pa zgjidhjen e të cilave RMV do të konsiderohet dhe mbetet për shumë kohë, “*e sëmura e Ballkanit*”.

Figura nr. 11: Të dhënat mbi prioritetin strategjik të orientimit të RMV në të ardhmen.




Hap pas hapi, vlerat e pyetjeve të intervistës plotësojnë tërë pamjen dhe thelbin e pushtetit politik në RMV. Çështja e pranisë së mosbesimit të qytetarëve në funksionimin e shtetit dhe të drejtësisë, edhe pas ngritjes së Prokurorisë Speciale, (figura nr. 11), përbën një problem shumë shqetësues në jetën politike të vendit. Në mendimin e përgjithshëm rezulton që, pavarësisht diferencave të vogla në thelbin e pyetjeve, ato kanë të njëjtin orientim, të vërtetojnë besimin apo mosbesimin e qytetarëve tek shteti i tyre.

Në shumatorën numerike të përgjigjeve, 44% besojnë pjesërisht tek funksionimi i shtetit ligjor, 30% nuk besojnë, 16% mendojnë se prokuroria është e kapur nga politika dhe vetëm 10% kanë besim në këtë çështje. Pra, 90% e të anketuarve nuk kanë besim në shtetin ligjor, që do të thotë që, pavarësisht lëvizjeve propagandistike, formale, sipërfaqësore, demagogjike, RMV sot mbetet ende një shtet jashtë standardeve të funksionimit të shtetit të së drejtës.

Kjo e dhënë në këtë studim duhet të sjell në rend të ditës një problem shumë të mprehtë. Ende në këtë shtet, pavarësisht ndryshimeve të filluara pas largimit nga pushtetit të VMRO-DPMNE, ende individët dhe strukturat e kriminalizuara flenë brenda shtetit, duke ruajtur trashëgiminë kriminale të mbartur nga koha.

Vështirësia e nxjerrjes para drejtësisë të mjaft individëve të kriminalizuar, është një tregues i reagimit dhe stadit të rezistencës që bëjnë sot strukturat e krimit të organizuar brenda RMV, në ndërveprim me struktura të tilla rajonale e më gjerë. Dorëheqja e paralajmëruar e Prokurorës Speciale Katica Janeva, (www.oranewstv: 15.07.2019) e emëruar në këtë detyrë më 15 shtator të vitit 2015 (*arrestimi i saj kohët e fundit*), skandalet që shoqërojnë hera herës jetën politike, nxisin qëndrimin kritik të qytetarëve ndaj shtetit të tyre dhe drejtësisë.

Figura nr. 12: Të dhënat mbi raportet e shtetit ligjor dhe Prokurorisë Speciale.



Ky është një tjetër tregues i studimit, që orienton opinionin e intervistuar drejt nivelit të besimit tek politika dhe institucionet e shtetit. (Figura nr. 12). Sipas rezultateve, institucionet relevante në vend kanë bërë shumë pak në drejtim të rikthimit të besimit dhe bindjes tek qytetarët se, institucionet vendimmarrëse janë të besueshme në marrjen e vendimeve me karakter dhe interesa publike. Kurba në nivelin 4, shënon pikën më të nxehtë në këtë çështje, e cila e shtrirë në kohë po ndikon relativisht në ndryshimin e mendimit të përgjithshëm.

Rasti i ndjekjes penale të ish kryeministrit Gruevski dhe të disa ish ministrave dhe funksionarëve të lartë shtetëror, është një mundësi më shumë që shteti në politikbërjen e tij t'u rikthej besimin qytetarëve.

Grafiku nr. 5: Niveli i besimit në organet politike vendimmarrëse në RMV.



Mbështetur në të dhënat e mëparëshme të tabelave sqaruese në brendimë e studimit, përfaqësimi i etniteteve të tjera në administratën shtetërore dhe në nivelet e larta të politikbërjes në RMV, rezulton me probleme, duke favorizuar individët me etni maqedonase dhe duke diskriminuar etnitë e tjera. Një trasmetim tradicional me doza nacionaliste, e trashëguar nga sistemi komunist, tashmë kanë krijuar bindjen në opinion për pabarazinë e përfaqësimit. Edhe trajektorja në këtë variabël, (grafiku nr. 5), e cila arrin në nivelin e pikës 4 në maksimum në vertikale, në raport me shtrirjen e opinionit në planin hirizontal në vlerën 12. Niveli nuk është i mjaftueshëm për të krijuar bindjen e plotë, që nga politika e shtetit ka vullnet dhe gatishmëri për të respektuar nivelin e përfaqësimit sipas fuqisë elektorale të subjekteve politike dhe raporteve të numrit të popullsisë. Këto tregues vërtetojnë që vendimmarrja politike dhe vetë politikbërja, kanë karakter të njëanshëm, duke reflektuar pasojë në jetën politike të vendit.


Grafiku nr. 6: Raportet e përfaqësimit etnik në trupën vendimmarrëse të shtetit të MV.



Çdo ndryshimi i viteve të fundit, edhe pse u bë me shumë rezervë dhe me tendenca për zbutjen e krizave politike që gjeneruan në mënyrë të njëpasnjëshme në jetën politike të shtetit, tek qytetarët, përkohësisht janë shfaqur doza optimizmi dhe gatishmërie, me mendimin se gjërat në të ardhmen do të lëvizin në kahje pozitive. Të paktën shënimi i pyetësorit gjatë anketimit (grafiku nr. 6), nga pika maksimale në planin horizontal në vlerën njësi 6, arrin të shënojë vlerat mbi mesataren në nivelin vertikal 4.

Sipas analizaës së opinionëve, ky optimizëm është i luhatshtëm për faktin se, në politikbërje shprehet një formalizëm që shpesh institucionet vendimmarrëse i nxjerr zbuluar. Luhatja ka të bëjë me mungesën e stabilitetit të jetës politike e sociale në vend, që shpesh sistemin politik e çon në nivelin e krizave politike. Në koalicionin qeverisës VMRO-DPMNE-BDI këto luhajtje kanë qenë më të shpeshta.

Grafiku nr. 7: Niveli i optimizmit për suksesin e reformave demokratike në RMV.




Ngjarjet në jetën politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për dekadën që trajtohet në studim, janë shoqëruar me ngjarje të rënda, të cilat kanë tërhequr vëmendjen e opinionit të gjerë nga problemet thelbësore që ka mbartur mbi vete politikbërja, për shkak të tendencave nacionale dhe të ndikimit rus mbi shtetin dhe politikën maqedone. Periudha e drejtimit të shtetit nga VMRO-DPMNE-BDI në këtë dekadë ka qenë periudha më e diskutuar, duke krijuar lehtësi për depërtimin ekonomik e financiar rus, duke mbyllur portat drejt BE-së.

Në vizionin strategjik të kësaj partie me Nikola Gruevskin kryeministër, krijimi dhe inskenimi i ngjarjeve të shpeshta tragjike me ndikime të forta, e orientuan vëmendjen e opinionit nga politikat ditore, duke shkaktuar përplasje politike me debate shterpë. Nga paraqitja grafike e

përgjigjeve të intervistave, (grafiku nr. 7), 80% e opinionit janë kategorik në mbështetje të këtij mendimi, 14% mendojnë të kundërtën dhe vetëm 6% qëndrojnë neutral pa përgjigje. Është specifike që në shumatorën e pyetjeve të shtruar në intervistë, njerëzit të kthejnë përgjigje pohuese në nivle kaq të lartë.

Për këtë shkak jeta parlamentare, debatet mediatike, deklaratat e shpeshta për shtyp, izolimi i lëvizjes së politikbërësve kryesor drejt BE-së dhe SHBA-ve, dështimet në sistemin ekonomik, problemet në sigurinë e brendshme, hapja e dyerve të “islamit politik” për të kompromentuar faktorin shqiptar, nxitja dhe inskenimi i akteve terroriste, lënia e hapësirave për rrjetet e trafikëve dhe të krimit të organizuar, rënduan situatën politike, duke e shmangur analizën politike nga problemet strategjike dhe gjeopolitike të vendit.

Figura nr. 13: Të dhënat mbi veprimin e politikave ditore në jetën politiko - sociale në RMV.



Në kronologjinë e ndërtimit të pyetsorit të kësaj intervistë, rritja graduale e ngarkesës politike të pyetjeve, ka parashikuar si qëllim arritjen e përfundimit në problemin më kyç të së ardhmes të politikbërjes në RMV. (fig. Nr. 13). Të 300 të intervistuarit së fundi janë ballafaquar me pyetjen më kryesore: Ku e shikojnë ata të ardhmen e vendit?

Padyshim rezultatet e përgjigjeve të kësaj pyetje meritojnë në studim një trajtim disi më të zgjeruar, duke u mbështetur në mendimin vizionar të njerëzve, pavarësisht urrejtjes apo kundërshtive që ata kanë ndaj politikbërjes, për shkak të diskrimnimit etnik.

Krejt ndryshe nga politika, qytetarët janë më të hapur, më tolerantë, më mendjehapur dhe zemërgjerë, duke shprehur edhe në kushte të vështira mbështetjen për shtetin e tyre. Ata nuk ngurrojnë të shprehen pozitivisht, duke u deklaruar në masën 59% për sigurinë e rrugës së vendit drejt intergimeve euroatlantike, në NATO dhe në BE. Edhe pjesa tjetër prej 14%, janë në nivelin


pohues për këtë rrugë, duke shfaqur mendimin se, rruga do të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë.

Edhe pse në përqindje të pakët, të intervistuarit i shtohen dëshirës së integritimeve, por për shkak të rezervave që kanë në politikbërjen e shtetit, parashikojnë vështirësi të mëdha në rrugën e integritimit. Sigurisht janë vetëm 21%, ata që mendojnë se RMV e ka rrugën e saj nën ndikimin dhe përkrahjen ruse.

